Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

2015-2019

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

Udhëheqës: m-r Mirjana Lozanoska

Redaktor: Stojan Saveski

Përktheu: Arbëresha Vlashi, Valon Kaba

Strugë, prill 2015

Programi u përgatit nga një ekip më i gjerë ekspertësh nën udhëheqjen e prof. D-r Strahinja Tërpevski, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues nga ministritë lineare të Qeverisë së RM, nëntë komunat që bëjnë pjesë në përbërjen e Rajonit, të punësuarit në Qendrën për zhvillim dhe anëtarët e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Ky dokument programor është miratuar nga Këshilli për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor me pëlqim paraprak nga Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal në RM.

Ky publikim është përgatitur me mbështetje nga Unioni Evropian, Agjencioni zviceran për zhvillim dhe Shoqërinë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar. Përmbajtja e këtij publikimi nuk i paraqet pikëpamjet dhe qëndrimet e institucioneve të lartëpërmendura.

Përmbajtja

Hyrje 5
Karakteristikat e zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor 7
Demografia 7
Karakteristikat ekonomike 9
Zhvillimi social 17
Bujqësia 20
Turizmi 36
Konsumi turistik 36
Infrastruktura 36
Infrastruktura e transportit 36
Infrastruktura rrugore 36
Infrastruktura hekurudhore 40
Komunikacioni ajror 42
Infrastruktura energjetike 42
Ambienti jetësor 44
Mbeturinat inerte 44
Uji 46
Furnizimi me ujë 52
Ujërat e zeza 54
Kualiteti i ujërave 55
Toka 58
Ndotja industriale 58
Erozioni 59
Ajri 60
Natyra 61
Kultura 36
Planifikimi i zhvillimit rajonal 71
Vizioni 71
Qëllimet afatmesme 71
Qëllimi afatmesëm 1 89
Qëllimi afatmesëm 2 89
Qëllimi afatmesëm 3 111
Qëllimi afatmesëm 4 118
Financimi dhe zbatimi i Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 126

Hyrje

Programi për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor është një dokument bazik strategjik afatmesëm për realizimin e rritjes së qëndrueshme, në të cilin janë përcaktuar qëllimet afatmesme që janë planifikuar për t'u arritur deri në vitin 2019. Programi është dokument planor-programor për drejtim më efikas dhe më të suksesshëm me zhvillimin e Rajonit dhe si i tillë zakonisht shërben për të nxitur zhvillimin rajonal. Zhvillimi i njohurive, arsimit, turizmit, infrastrukturës, teknologjisë informative, kohezionit social, ekonomisë, si dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, janë shumë më efektive kur ato ndodhin në nivel rajonal. Rëndësia e programit qëndron në vizionin e përbashkët të zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor, në qëllimet e përcaktuara afatmesme të zhvillimit, prioriteteve dhe masave për tërë Rajonin. Me përgatitjen e Programit dhe miratimin e tij është vendosur bazë orientuese për projektet zhvillimore të komunave dhe janë krijuar parakushtet për të aplikuar me projekte për mjete për financimin e tyre. Me realizimin e Programit do të kontribuohet edhe në përforcimin e bashkëpunimit ndër rajonal dhe ndërkufitar në realizimin e projekteve të përbashkëta zhvillimore.

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2015 - 2019 është punuar në përputhje me Strategjinë për zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë, dhe në përgatitjen e programit janë marrë parasysh edhe dokumente tjera strategjike nacionale. Programi është punuar sipas Metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren e metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve planore për zhvillim rajonal. Janë shfrytëzuar edhe përvojat nga zbatimi i dokumentit të parë planor-programor, si dhe rezultatet e vlerësimit të ndikimit nga zbatimi i Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2009-2014.

Programi përbëhet nga një përshkrim i karakteristikave zhvillimore të Rajonit, si dhe aktiviteteve të planifikimit dhe financimit të zhvillimit rajonal.

Karakteristikat zhvillimore të Rajonit janë paraqitur me hollësi, me çka janë përfshirë të gjithë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin rajonal. Të dhënat e paraqitura janë të dhënat më të fundit që janë në dispozicion dhe ato janë marrë kryesisht nga Enti shtetëror i statistikave i Republikës së Maqedonisë.

Pjesa planore e programit tregon Vizionin për zhvillimin e Rajonit, qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat në çdo prioritet. Në këtë pjesë janë pasqyruar edhe standarde për vlerësimin e suksesit të realizimit të prioriteteve si dhe standarde për suksesin e realizimit të qëllimeve afatmesme, si dhe standardet me të cilat do të vlerësohet ndikimi i arritur nga zbatimi i Programit.

Realizimi i programit është pasqyruar edhe nga aspekti i financimit të tij, me çka janë treguar edhe burimet e mundshme financiare për realizimin e tij.

Karakteristikat e zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor

Në pajtim me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal (neni 5) për nevojat e planifikimit të zhvillimit janë përcaktuar tetë rajone planore sipas NNTS 3 nomenklaturës së njësive territoriale për statistikë:

- Rajoni planor i Vardarit;
- Rajoni planor Lindor;
- Rajoni planor Jugperëndimor;
- Rajoni planor Juglindor;
- Rajoni planor i Pellagonisë;
- Rajoni planor i Pollogut;
- Rajoni planor Verilindor dhe
- Rajoni planor i Shkupit.

Demografia

Pasqyra demografike e rajonit planor Jugperëndimor është me karakteristika dhe trende të ngjashme si e gjithë Republika e Maqedonisë. Në pajtim me të dhënat e prezantuara në tabelën vijuese, mund të thuhet se paraqitet shpopullim dhe zvogëlim të numrit të popullsisë.

Popullsia gjatë viteve	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Maqedonisë	2.052.722	2.057.284	2.059.794	2.062.294	2.065.769
Rajoni planor Jugperëndimor	221.899	221.811	221.517	220.840	220.325

Indeksi i numrit të popullsisë në vitin 2013, krahasuar me vitin 2009 si bazë tregon një rënie të vazhdueshme.

Indeksi i popullsisë	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Maqedonisë	100	100.22	100.34	100.47	100.64
Rajoni planor Jugperëndimor	100	99.96	99.82	99.52	99.29

Pjesëmarrja e popullsisë nga rajoni planor Jugperëndimor në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Maqedonisë është zvogëluar nga 10.80% në vitin 2009 në 10.66%, në vitin 2013, me trend të zvogëlimit të vazhdueshëm.

Pjesëmarrja e Rajonit në popullsinë e përgjithshme në shtet	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Maqedonisë	100	100	100	100	100
Rajoni planor Jugperëndimor	10.80%	10.78%	10.75%	10.70%	10.66%

Dendësia e popullsisë në rajonin planor Jugperëndimor është 66.0 banorë për kilometër katror. Sipas regjistrimit të vitit 2002 popullata nga rajoni Jugperëndimor ka jetuar në 84.627 objekte banimi me një madhësi mesatare të familjes prej 3.8 anëtarë.

Brenda një viti (2013) ka pasur 2118 lindje, në të njëjtën periudhë numri i vdekjeve ishte 1944 çka kemi një rritje pozitive natyrore prej 174 personave. Në vitin 2013 në rajonin planor Jugperëndimor u vendosën 340 njerëz, ndërsa janë zhvendosur 596 njerëz, çka tregon një trend të vazhdueshëm të zbrazjes së Rajonit. Shkalla e shkrim-leximit të popullsisë me moshë mbi 10 vjeçare sipas regjistrimit të vitit 2002 është 96,5%. Për fat të keq, për shkak të mos realizimit të regjistrimit një numër i madh i të dhënave nga statistikat demografike janë vjetruar dhe sot pamja demografike me siguri është shumë e ndryshuar.

Edhe pse të dhënat në fusha të caktuara janë mjaft të vjetra, veçanërisht ato që lidhen me regjistrimin, gjithsesi metodologjikisht janë të sakta dhe nga ato mund të nxirren konkluzione të sakta, të cilat mund të shfrytëzohen. Nga të dhënat e paraqitura më lart qartë mund të shohim se, numri i popullsisë parë në tërësi ngadalë por me siguri shkon duke u zvogëluar, qoftë si një përqindje me të cilin merr pjesë në popullsinë e përgjithshme në vend, qoftë si popullsi e përgjithshme në nivel të Rajonit. Pozitive është që ende ka një rritje pozitive natyrore prej 174 njerëz, por brengosin të dhënat për migrimin përkatësisht, raporti i atyre që vijnë nga jashtë dhe ato që largohen, që ka dallim prej 256 njerëz, çka tregon qartë se emigrimi është shumë i theksuar. Për të ndaluar këtë proces duhet marr masat e nevojshme për të përmirësuar kushtet e jetës dhe të punësimit veçanërisht për rininë dhe për kuadrot e kualifikuara, me qëllim që të ngelin në këtë vend dhe të parandalojë, përkatësisht zvogëlojë fenomenin e largimit të trurit.

Karakteristikat ekonomike

Rajoni planor Jugperëndimor është një nga rajonet më pak të zhvilluara në shtet në pajtim me kontributin në prodhimin e brendshëm bruto në nivel kombëtar, shuma e PBB-së për banorë dhe vet vendimit për klasifikimin e rajoneve planore sipas nivelit të zhvillimit për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017. Gjegjësisht, sipas të dhënave nga Enti shtetëror i statistikave për vitin 2011, rajoni planor Jugperëndimor merr pjesë në strukturën e PBB-së kombëtare me 7,8%, ose me shumë prej 35.942,00 milion denarë.

Tabela 1. PBB në nivel të rajonit planor Jugperëndimor, 2008-2011

viti	**Prodhimi i brendshëm bruto në milion denarë**	**Pjesëmarrja e PBB në nivel të Republikës së Maqedonisë (%)**
2008	33492	8.1
2009	31136	7.6
2010	34514	8
2011	35942	7.8

Burimi: Enti shtetëror i statistikave të Republikës së Maqedonisë

Indeksi i PBB-së për banorë në vitin 2011 ishte 72.6, dhe në krahasim me vitet e kaluara ajo nuk ka ndryshime të mëdha. Një trend shqetësues që është i dukshëm është stagnimi i produktit të brendshëm bruto (i përgjithshëm dhe për banorë), përkatësisht ky rajon është një nga rajonet e pakta (së bashku me Pellagoninë dhe Pollogun) që tregojnë oscilime të vogla në lëvizjen e PBB-së për banor (pa trend rritës) gjatë periudhës 2008-2012.

Grafikoni 1. Produkti i brendshëm bruto për banor, 2008/2012



Rajoni planor Jugperëndimor ka pjesëmarrje të lartë në shpërndarjen e mjeteve financiare për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, në pajtim me Vendimin për klasifikim të rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017 (Gazeta Zyrtare. 88/2013). Gjegjësisht, rajonit planor Jugperëndimor i takojnë 13,3% nga mjetet e përgjithshme, që si përqindje është më e ulët vetëm nga rajoni i Vardarit dhe ai Verilindor. Në Vendim, është përcaktuar se indeksi i zhvillimit është 81.4, ndërsa indeksi social-ekonomik është 97.7.

Bruto vlera e shtuar në rajonin planor Jugperëndimor në vitin 2012 ishte 30.002,00 milion denarë, që përfaqëson pjesëmarrje prej rreth 7.6% në shumën totale të vlerës së shtuar bruto në nivel të Republikës së Maqedonisë. Lëvizja e këtij treguesi paraqet edhe një fakt për stagnimin e ekonomisë në këtë Rajon. Pjesëmarrja në vlerën totale të shtuar bruto të sektorit të "Informacionit dhe komunikimeve" është në nivel jashtëzakonisht të ulët dhe nuk ka trend të rritjes, pavarësisht faktit që ky Rajon disponon me sistem arsimor adekuat që mbulon këtë sferë. Përmirësimi është i nevojshme edhe në sektorët që veprojnë në fushën e turizmit. Duke e marrë parasysh përparësitë krahasuese të këtij Rajoni, atëherë është evidente pjesëmarrja e ulët e sektorëve “Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Objekte për akomodim dhe shërbim të ushqimit" në vlerën totale bruto të shtuar në nivel të Republikës së Maqedonisë.

Tabela e pasqyruar më poshtë tregon kontributin e sektorëve të ndryshëm në vlerën e shtuar bruto në rajonin planor Jugperëndimor.

Tabela 2. Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve të veprimtarisë në rajonin planor Jugperëndimor, 2010-2012

	Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve në rajonin planor Jugperëndimor, në milion denarë			Pjesëmarrja në vlerën e shtuar bruto në nivel të Republikës së Maqedonisë (%)		
Sektori i veprimtarisë	**2010**	**2011**	**2012**	**2010**	**2011**	**2012**
Vlera e shtuar bruto e përgjithshme	30303	31455	30002	7.95	7.82	7. 95
Bujqësia, pylltaria; peshkimi	2199	2498	2576	5.03	5.69	6.33
Miniera dhe gurore; Industria përpunuese; Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim, furnizimi me ujë, menaxhimi me mbeturina, rehabilitimi i mjedisit	6555	6794	5022	8.01	7.80	7.15
Ndërtimtari	2075	2804	2622	8.68	9.37	8.41
Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Transport dhe magazinim; Objekte për akomodim dhe shërbim të ushqimit	6747	7518	7480	8.74	9.02	8.77
Informatikë dhe komunikim	110	275	116	0.60	1.45	0.74
Veprimtari financiare dhe veprimtari sigurimi	562	604	666	5.71	5.30	4.89
Veprimtari në lidhje me patundshmëritë; rentat	3527	3729	5313	11.57	11.95	11.22
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike; Veprimtari shërbyese administrative dhe ndihmëse	2388	932	495	15.16	6.17	3.37
Administrimi publik dhe mbrojtja, sigurim i detyrueshëm social; Arsimi; Veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	5260	5411	5205	7.88	8.00	7.86
Art, argëtim dhe rekreacion, Veprimtari tjera shërbyese	880	891	509	6.64	6.43	4.87

Burimi: Të dhënat janë marrë dhe përpunuar nga baza e të dhënave nga Enti shtetëror i statistikave

Sipas të dhënave nga Entit shtetëror i statistikave për tremujorin e dytë të vitit 2014, rajoni planor Jugperëndimor ka numër më të vogël të vendeve të punës të plotësuara krahasuar me çdo rajon tjetër në Republikën e Maqedonisë. Shkalla e vendeve të lira të punës e tejkalon mesataren e Maqedonisë nga 1.38 dhe është 1.73.

Në lidhje me numrin e bizneseve aktive, në rajonin planor Jugperëndimor veprojnë më shumë se 10% e të gjitha bizneseve në shtet. Duke analizuar periudhën 2011-2013 nuk ka shkëputje të mëdha në numrin e ndërmarrjeve, pavarësisht nga madhësia e tyre. Në grafikun e mëposhtëm, është pasqyruar numri i bizneseve aktive në vitin 2013, sipas madhësisë së tyre.

Grafiku 2. Numri i subjekteve afariste aktive sipas numrit të punësuarve



	Gjithsej	0	1-9	10-19	20-49	50-249	250+
Rajoni Jugperëndimor	7219	284	6433	241	151	103	7
Republika e Maqedonisë	71290	4415	60599	2989	1787	1291	209

Është interesante të theksohet se rajoni planor Jugperëndimor përjeton ndryshime të mëdha në numrin e ndërmarrjeve, përkatësisht është një nga rajonet me një numër më të madh të ndërmarrjeve të reja (10,63% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të reja), por edhe me mbyllje të ndërmarrjeve (10,86% e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të mbyllura).

Rajoni planor Jugperëndimor merr pjesë me 4,69% të investimeve totale në mjetet themelore në shtet. Krahasuar me rajonet e tjera, ky nivel i investimeve korrespondon me nivelin e caktuar të zhvillimit dhe dinamikën e rritjes ekonomike.

Grafikoni 3. Investime në mjete themelore, sipas sektorit të veprimtarisë në rajonin jugperëndimor, 2010-2012



Duhet theksuar trendin rritës të investimeve në mjete themelore, çka në pjesë më të madhe i kushtohet rritjes së investimeve në ndërtimtari. Në këtë drejtim, numri i objekteve ndërtimore të përfunduara dhe të papërfunduara, të ndërtuara nga bizneset, analizuar në periudhën 2011-2013, u rrit me 218%.

Prodhimi bujqësor në rajonin planor Jugperëndimor është në nivel të mjerë. Ky Rajon ka pjesëmarrje më të vogël në vlerën e shtuar bruto në bujqësi në vitin 2011, dhe është 3,53%. Krahasuar me rajonin planor Juglindor që ka performancën më të mirë në këtë segment, është pothuajse 10 herë më i vogël kontributi në prodhimtarinë bujqësore në nivel shtetëror.

Në tabelën 3 është treguar pjesëmarrja në përqindje në rajonin planor Jugperëndimor, sipas prodhimeve, në vlerën totale bruto të shtuar të prodhimtarisë bujqësore në Republikën e Maqedonisë.

Tabela 3. Pjesëmarrja e rajonit planor Jugperëndimor në vlerën totale bruto të shtuar të prodhimtarisë bujqësore në Republikën e Maqedonisë, e shprehur në përqindje (%)

	2009	2010	2011
Drithëra	5.45	5.39	5.31
Bimë industriale	0.50	0.29	0.24
Bimë foragjere	6.80	3.50	6.74
Prodhime kopshti	1.04	0.86	0.96
Patate	8.44	8.41	9.42
Fruta	9.84	9.51	10.80
Verë	1.34	0.81	1.18
Prodhimtari vegjetative (01 deri 07)	3.73	2.95	3.88
Bagëti	7.71	8.53	8.95
Prodhime blegtorale	8.52	9.06	8.35
Prodhime blegtorale (11+12)	8.17	8.81	8.64
Prodhimtaria e produkteve bujqësore (10+13)	4.95	4.45	5.06
Shërbime në bujqësi	9.73	9.81	9.75
Prodhimtari bujqësore (14+15)	4.97	4.47	5.08
Veprimtari sekondare jobujqësore (të pandashme)	2.58	3.33	3.13
Prodhimtari e "degës afariste" bujqësore (16+17)[1)]	4.93	4.45	5.04
Shpenzimet e përgjithshme ndër-fazore	7.82	6.23	6.63
Vlera e shtuar bruto (19-20)[1)]	2.19	2.77	3.53
Amortizimi i mjeteve themelore	11.12	11.12	11.12
Vlera e shtuar neto (21-22)[1)]	1.27	1.88	2.75

1) Në pjesën Prodhimtari e "degës afariste" bujqësore, si dhe në Vlerën e shtuar bruto dhe neto, nuk janë përfshirë subvencionet e prodhimit.
Burimi: Të dhënat janë marrë dhe përpunuar nga Enti shtetëror i statistikave.

Tregu i punës

Sipas të dhënave nga viti 2013, në rajonin planor Jugperëndimor ka 182 000 njerëz të aftë për punë, çka e krahasuar me rajonet e tjera ndodhet në vendin e katërt. Duke analizuar periudhën 2008-2013, numri i popullsisë të aftë për punë ka trend rritje të përgjithshme prej mbi 3% (krahasuar me 2008 dhe 2013). Në 6 vitet e fundit, tek shkalla e papunësisë kishte lëkundje më të dukshme, por gjithsesi në vitet e fundit trendet janë të favorshme.

Tabela 4. Shkalla e popullsisë aktive në rajonin planor Jugperëndimor nga mosha 15 vjeçare e lartë

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia e aftë për punë (persona)	176191	176580	178136	179157	181650	182000
Niveli i aktivitetit	55.5	55.8	55.5	56.7	56.2	56.2
Niveli i punësimit	33.7	37.5	36.5	32.4	32.4	35.6
Niveli i papunësisë	39.3	32.7	34.3	42.8	42.3	36.7

Burimi: Enti shtetëror i statistikave të Republikës së Maqedonisë

Sipas shkallës së papunësisë, rajoni planor Jugperëndimor gjendet në pozitën e para fundit (vetëm në rajonin planor Verilindor shkalla e papunësisë është më e lartë). Në raport me strukturën gjinore, shkalla e papunësisë është më e lartë tek femrat se sa tek meshkujt. Përveç kësaj, edhe në pjesën urbane dhe rurale të Rajonit, sipas të dhënave nga viti 2013, nuk ka dallime të rëndësishme në shkallën e papunësisë. Ky është në fakt viti i parë ku dallimet midis këtyre dy pjesëve të rajonit janë minimale, në dy vitet e kaluara papunësia ishte dukshëm më e lartë në zonat rurale, sesa në ato urbane.

Më poshtë është pasqyruar tabela me të dhëna për strukturën gjinore dhe shpërndarjen hapësinore në aspektin e shkallës së papunësisë. Është e qartë se në secilin nga treguesit, shkalla e papunësisë në rajonin planor Jugperëndimor është larg mbi mesataren në nivel shtetëror.

Tabela 5. Shkalla e papunësisë në nivel të rajonit planor Jugperëndimor dhe Republikën e Maqedonisë (%)

	Republika e Maqedonisë	Rajoni planor Jugperëndimor
Gjithsej	29	36.7
meshkuj	29	34.2
femra	29	40.5
Pjesa urbane	30.6	37.1
meshkuj	30.8	35.1
femra	30.4	39.8
Pjesa rurale	26.7	36.3
meshkuj	26.7	33.4
femra	26.6	41.3

Produktiviteti i punës në rajonin planor Jugperëndimor ka prirje rritëse në vitet e fundit. Gjegjësisht, në periudhën 2009-2011, e njëjta është rritur me mbi 30%. Vetëm si krahasim, në nivel të Republikës së Maqedonisë, në të njëjtën periudhë, produktiviteti i punës është rritur me gati 10%. Edhe pse rajoni planor Jugperëndimor po i afrohet mesatares shtetërore, ka ende vend për përmirësim. Më poshtë në grafikon është pasqyruar dinamika e lëvizjes së produktivitetit të punës, si dhe ngecjet në raport me mesataren nacionale.

Grafikoni 4. Produktiviteti i punës, 2008-2011



- Produktiviteti i punës në rajonin Jugperëndimor (PBB për orë të punuar)
- Produktiviteti i punës në Republikën e Maqedonisë (PBB për orë të punuar)

Zhvillimi social

Rroga mesatare e popullatës e cila merr rrogë në rajonit planor Jugperëndimor, është nën pagën mesatare shtetërore neto e cila për vitin 2013 është 21.145 denarë, ndërsa në rajonit planor Jugperëndimor paga mesatare është 19.329 denarë. Zonat urbane kanë në dispozicion infrastrukturë relativisht më të mirë, ndërsa mbrojta shëndetësore dhe sociale janë vlerësuar si relativisht të mira.

Mbulimi i popullatës me sigurimet shëndetësore në rajonit planor Jugperëndimor, sipas të dhënave statistikore, ka një rënie të vazhdueshme edhe atë nga 82,3% që ka qenë në vitin 2010 në 74,5% në vitin 2012.

Qasje deri tek shërbimet shëndetësore nga mbrojta shëndetësore primare dhe sekondare është më e ulët nga mesatarja e nivelit nacional, ndërsa shkallët më të larta të mbrojtës shëndetësore nuk janë të arritshme. Kujdesi spitalor është i organizuar përmes rrjetit të spitaleve të përgjithshme dhe të specializuara në qendrat urbane.

Në Rajon ekzistojnë disa institucione publike për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, të vendosura në 12 objekte dhe të organizuara në grupe. Çerdhet janë të vendosura në qendrat urbane, ndërsa në zonat rurale ka grupe të shpërndara. Përfshirja e fëmijëve

deri në moshën 5 vjeçare në nivel të Republikës së Maqedonisë, në vitin 2013 ka qenë 21%, ndërsa në rajonin planor Jugperëndimor vetëm 12,9%, që do të thotë se është shumë më poshtë mesatares nacionale.

Diçka më mirë është mesatarja në pjesën e shfrytëzimit të shtesave fëmijërore nga niveli nacional, në vitin 2013 ishte 3,8%, ndërsa në rajonin planor Jugperëndimor kjo përqindje është 4,9%. Në të gjithë rajonin planor Jugperëndimor, pjesëmarrja e amvisërive për shfrytëzimin e ndihmës sociale në vitin 2013 është 17,8% e cila është më pak nga mesatarja e nivelit nacional – 21,1%. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat të cilat e pasqyrojnë gjendjen në sferën sociale në rajonin planor Jugperëndimor.

Gjendja sociale	Rajoni planor Jugperëndimor	Republika e Maqedonisë
Fëmijë nga mosha 0 deri 5 vjet në çerdhe (%)	12.9	21.0
Shfrytëzimi i shtesave fëmijërore, deri në moshën 18vjeçare (%)	4.9	3.8
Shfrytëzues të shtesave të veçanta, deri në moshën 26 - vjeçare (%)	0,9	1
Amvisëri – shfrytëzues të ndihmës sociale në 000 banorë	17.8	21.1

Përfshirja e të rinjve në sistemin e arsimit fillorë dhe të mesëm është paraqitur në tabelën e më poshtme. Në kuadër të rajonit ka 124 shkolla fillore me 19.334 nxënës. Ka 13 shkollat të mesme në të cilat mësojnë 9.319 nxënës. Kjo tregon një përfshirje të mirë të fëmijëve në arsimin fillor dhe të mesëm, a numri i shkollave fillore tregon shpërndarjen e madhe të tyre nëpër Rajon.

Nxënës në shkollat fillore	2009/10	2010/11	2011/12	2012/13
Republika e Maqedonisë	210.381	204.439	198.856	195.311
Rajoni planor Jugperëndimor	21 639	20 758	19 979	19 334
Nxënës në shkollat e mesme	**2009/10**	**2010/11**	**2011/12**	**2012/13**
Republika e Maqedonisë	95,343	94,155	93,064	89,884
Rajoni planor Jugperëndimor	9 934	9 918	9 745	9 319

Numri i studentëve të regjistruar në studime universitare në rajonin planor Jugperëndimor janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Nga të dhënat qartazi shihet se si në nivel nacional, por edhe në nivel të Rajonit ka tendencë rënie të numrit të studentëve të regjistruar në studimet universitare, edhe pse ka numër të madh të studimeve të shpërndara nga fakultetet shtetërore, por edhe nga institucione private të arsimit të lartë nëpër qytetet nga ky Rajon.

Student të regjistrua në universitete	2007	2008	2009	2010
Republika e Maqedonisë	210.381	204.439	198.856	195.311
Rajoni Jugperëndimor	5 995	5 652	5 062	5 468

Numri i studentëve të diplomuar nëpër vite në Rajon, duke e krahasuar me mesataren e gjithë Maqedonisë është pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Edhe numri i studentëve të diplomuar ka tendencë rënie pavarësisht përparësive të përmendura më lartë të cilat i mundësojnë studimet e shpërndara.

Numri i studentëve të diplomuar	**2010**	**2011**	**2012**
Republika e Maqedonisë	9.807	9.707	10.210
Rajoni Jugperëndimor	1029	950	844

Bujqësia

Rajoni planor Jugperëndimor disponon me 134.541 hektar tokë bujqësore, nga e cila 37,1% ose 49.999 hektar janë sipërfaqe punuese dhe 62,8% ose 84.537 hektarë janë kullosa.

Nga sipërfaqja punuese në këtë rajon më dominuese janë fushat dhe kopshtet me 39.782 hektarë, pemëtaria ka 2.175 hektarë, vreshtat 618 hektarë dhe livadhet me 7.424 hektarë. Përfaqësimi proporcional i tokës bujqësore është paraqitur në diagramin e mëposhtme.



Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Gjatë viteve të fundit prodhimet bujqësore në rajonin planor Jugperëndimor janë në rënie. Në diagramin e më poshtëm është paraqitur prodhimi bujqësor vjetor në tonelata dhe trendi në prodhimet bujqësore.



Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në rajonin planor Jugperëndimor (duke u bazuar në kulturat në veçanti) ndryshon, prej 5,78% në vitin 2008, gjegjësisht 5,83 në vitin 2012.

Nga gjithsej 12 ndërmarrje bujqësore përpunohen 4.100 ha, ndërsa 18.763 prodhues bujqësor individual përpunojnë 24.209 hektar. Sipas kësaj, madhësia mesatare e sipërfaqes punuese nga ndërmarrjet bujqësore është rreth 341 hektar. Prodhuesit individual bujqësor mesatarisht përpunojnë 1,3 hektar, çka na tregon, në madhësi të vogla të tokës punuese e cila është nën mesataren nacionale -1,84 hektar. Në këtë rajon, me pronësi kaq të vogla nuk mund të ketë sektor të fortë bujqësor individual. Bujqit nuk janë mirë të organizuar dhe nuk kanë prodhimtari të uniformuar të produkteve.

Shumica e komunave të rajonit planor Jugperëndimor janë rurale dhe pjesa më e madhe e popullësis (mbi 70%) jeton në tre qendrat urbane – Strugë, Ohër dhe Kërçovë.

Prodhimi i disa kulturave dhe perimeve (e shprehur në tonelata)

	2011							
	Grurë	**Misër**	**Duhan**	**Patate**	**Qepë**	**Domate**	**Speca**	**Kastravecë**
R. e Maqedonisë	256103	126096	26537	192675	44540	165642	153842	49879
Rajoni Jugperëndimor	15 240	12 514	67	17 470	575	998	1 070	105
% të R. së Maqedonisë	**5,95%**	**9,92%**	**0,25%**	**9,06%**	**1,29%**	**0,6%**	**0,7%**	**0,2%**
	2012							

	Grurë	Misër	Duhan	Patate	Qepë	Domate	Speca	Kastravecë
R. e Maqedonisë	214963	115928	27333	168859	43732	145818	166247	50093
Rajoni Jugperëndimor	14 632	11 510	129	17 371	458	984	969	71
% të R. së Maqedonisë	**6,8%**	**9,92%**	**0,47%**	**10,2%**	**1,04%**	**0,67%**	**0,58%**	**0,14%**
				2013				
	Grurë	**Misër**	**Duhan**	**Patate**	**Qepë**	**Domate**	**Speca**	**Kastravecë**
R. e Maqedonisë	258960	131043	27859	189590	50787	130960	152153	36834
Rajoni Jugperëndimor	15 016	11 966	124	17 944	450	940	1 006	73
% të R. së Maqedonisë	**5,79%**	**9,13%**	**0,44%**	**9,46%**	**0,88%**	**0,71%**	**0,66%**	**0,2%**

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Prodhimi i të gjitha kulturave të përmendura më lartë është i qëndrueshëm në këto tre vitet e fundit, përveç duhanit i cili gjatë vitit 2011 është dyfishuar. Megjithatë, të gjitha kulturat kanë një pjesëmarrje të ulët në prodhimin e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë.

Rajoni planor Jugperëndimor ka më shumë male të larta dhe pyje të llojllojshme e cila i jep mundësi për zhvillim dhe shfrytëzimin e lëndës së drurit.

Prodhimi i frutave dhe rrushit (e shprehur në tonelata)

				2011					
	Qershi	**Vishnje**	**Kajsi**	**Mollë**	**Dardha**	**Kumbull**	**Pjeshka**	**Arra**	**Rrush**
R. e Maqedonisë	6019	6514	3747	124552	7460	35448	9039	5480	235104
Rajoni Jugperëndimor	1 441	756	116	21 894	870	7 603	526	827	3 361
% të R. së Maqedonisë	23,9%	11,6%	3,09%	17,5%	11,66%	21,4%	5,8%	15,09%	1,42%
				2012					
	Qershi	**Vishnje**	**Kajsi**	**Mollë**	**Dardha**	**Kumbull**	**Pjeshka**	**Arra**	**Rrush**
R. e Maqedonisë	5539	8127	4503	127171	6937	35444	8987	4952	240461
Rajoni Jugperëndimor	1 614	1 032	166	18 824	887	6 928	605	729	3 384
% të R. së Maqedonisë	29,13%	12,6%	3,68%	14,8%	12,7%	19,54%	6,73%	14,72%	1,4%
				2013					

	Qershi	Vishnje	Kajsi	Mollë	Dardha	Kumbull	Pjeshka	Arra	Rrush
R. e Maqedonisë	6037	8867	3968	112929	7265	38902	11034	5467	292075
Rajoni Jugperëndimor	1 557	983	144	18 139	1 052	6 727	573	753	6 113
% të R. së Maqedonisë	25,7%	11,08%	3,62%	16,06%	14,48%	17,3%	5,2%	13,77%	2,09%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Në dallim nga të lashtat dhe kopshtaria, frutat në rajonin planor Jugperëndimor janë më shumë të pranishme dhe njëkohësisht marrin pjesë me përqindje më të lartë në prodhimin e përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë. Të gjitha frutat e përmendura kanë përafërsisht prodhim të qëndrueshëm në tre vitet e fundit, përveç rrushit prodhimi i të cilit është dyfishuar. Kjo është për shkak të masave qeveritare për mbjelljet e reja dhe me lidhshmërinë e prodhimit të verës me turizmin liqenor të zhvilluar në këtë rajon. Konsumimi i rrushit në përditshmëri akoma është në sasi të papërfillshme.

Sipërfaqe nën fusha dhe bahçe										
Hektar/ ha	Fusha dhe bahçe	Drithëra	Kultura industriale	Të lashtat	Bathë	Perime në total	Patate	Lule dhe bimë zbukuruese	Fara dhe fidanë	Ugar
Republika e Maqedonisë	**236.291**	**158.314**	**24.717**	**23.561**	**2.283**	**12.722**	**5.053**	**34**	**26**	**9.581**
Rajoni planor Jugperëndimor	12.961	8.339	63	2.946	608	324	389	3	4	284
% prej R. së Maqedonisë	5,48%	5,26%	0,25%	12,5%	26,63%	2,54%	7,7%	8,82%	15,3%	2,96%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Nga analiza për pjesëmarrjen e kulturave, si në zonën kufitare të pollogut ashtu edhe në rajonin planor Jugperëndimor mund të përkufizohet se ka kushte të përshtatshme për prodhimin e furazheve dhe bathëve dhe blegtoria ka një rëndësi të veçantë në ekonominë e Rajonit.

Numri i përgjithshëm i gjedhëve, shpendëve dhe zgjoje 2013							
Numri	**Kuaj**	**Lopë**	**Derr**	**Dele**	**Dhi**	**Shpezë**	**Zgjojë**
R. e Maqedonisë	20 682	238 333	167 492	731 828	75 028	2 201 550	68 294
Rajoni Jugperëndimor	4 228	18 995	14 449	108 013	14 858	185 712	31 480

% të R. së Maqedonisë	**20,44 %**	**7,96%**	**8,62%**	**14,75%**	**19,8 %**	**8,43%**	**46,09%**

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Në këtë rajon ka prezencë të madhe të kuajve, deleve dhe dhive të cilat kanë një ndikim të madhe në numrin e përgjithshëm të gjendjes në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë numri i koshereve të bletëve përbën 46,09%, në prodhimin e përgjithshëm në vend, ky rajon është rekorder në prodhimin e mjaltit dhe kjo degë është në lulëzim. Nga regjistrimi i fundit në bujqësi në 2007 janë regjistruar 16.376 koshere bletës, në 2013 ky numër përafërsisht është dyfishuar dhe është 31.480. Prodhimi dhe marketingu i mjaltit si dhe i verës kanë lidhje direkte me turizmin.

Turizmi

Trendet e zhvillimeve turistike janë të ndryshme nëpër rajonet e ndryshme. Përcaktimi i tyre është një domosdoshmëri gjatë përgatitjes së planeve zhvillimore turistike, programeve dhe strategjive në çdo hapësirë ku zhvillohet turizëm. Në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor, i cili është i pari në Republikën e Maqedonisë në zhvillimin e turizmit dhe atë duke i marrë parasysh të gjitha parametrat sipas të cilit përcaktohet, trendet turistike mund të përcaktohen përmes përcaktimit dhe analizës së vëllimit, dinamikës dhe struktura e turistëve, si dhe netëve të bujtjeve gjatë periudhës 5 vjeçare. Në veçanti kategori e rëndësishme për të cilën duhet të bëhen hulumtime gjatë përcaktimit të zhvillimit turistik në rajonin planor Jugperëndimor është përcaktimi i përqindjes pjesëmarrëse të numrit të turistëve dhe fjetjeve të realizuara në numrin e përgjithshëm në nivel nacional, si dhe karakteristikat dinamike të tyre në periudhën 5 vjeçare e cila është objekt analize (2009 -2013). Pasqyrat tabelare të cilat i përmbajnë këto parametra zhvillimore janë të paraqitura në vijim.

Vëllimi, dinamika dhe struktura e vizitave turistike

Viti	Numri i turistëve nga vendi	Baza e indeksit 2009	Numri i turistëve të huaj	Baza e indeksit 2009	Numri total i turistëve në rajon	Baza e indeksit 2009	Numri total i turistëve në RM	Pjesëmarrja në përqindje e turistëve nga rajoni në numrin e përgjithshëm të turistëve në RM
2009	170127	100	87353	100	257480	100	587770	43,8%
2010	154731	91,0	79934	91,5	234665	91,1	586241	40,03%

2011	147877	86,9	101869	116,6	249746	97,0	647568	38,57%
2012	140993	82,9	110469	126,5	251462	97,7	663633	37,89%
2013	130020	76,4	134806	154,3	264826	102,9	701794	37,74%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Sipas kësaj, mund të vërehet se ekziston një rënie konstante e numrit të turistëve vendas, ashtu që numri i tyre në vitin bazë kanë qenë 170.127, ndërsa në vitin e fundit 2013 është 130.020. Gjatë rishikimit të numrit të përgjithshëm të turistëve mund të vërehet se (edhe pse gjatë vitit 2010 kemi rënie në raport me vitin e mëparshëm, që është si pasojë e zvogëlimit të numrit të turistëve venda) në vitet pasardhëse pason një rritje e vazhdueshme, por me theks të ulët. Ashtu, që në vitin 2013 mund të vërehet një rritje e vogël në krahasim me vitin bazë 2009 me 2,9%, gjegjësisht me indeks 102,9.

Tek turistët e huaj, në vitin 2010 paraqitet zvogëlim i ashpër dhe indeksi është 91,5. Megjithatë në vitin e ardhshëm 2011 dhe deri në vitin 2013 është 154,3. Duhet të theksohet se kjo paraqet një gjendje shumë të favorshme. Si për të gjithë rajonin planor Jugperëndimor, mund lirisht të pretendohet se kjo rritje në masë më të madhe bazohet në masat e ndërmarra nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në fushën e subvencioneve për turistët e huaj, si dhe aktivitetet promovuese jashtë vendit.

Në drejtim të përqindjes në raport me numrin e turistëve që e kanë vizituar rajonin planor Jugperëndimor mund të vërehet pjesëmarrje e lartë në krahasim me rajonet e tjera në vend, që është 43,80%, në vitin bazë 2009, i cili është më i lartë dhe nuk do të mund të arrihet përsëri në periudhën e ardhshme të analizuar. Pavarësisht nga karakteristikat e favorshme të pjesëmarrjes së lartë është e dukshme dhe tendenca negative në pjesëmarrjen në përqindje të numrit të vizitorëve në Rajon në krahasim në totalin e realizimeve në nivel të Republikës së Maqedonisë në vitet e ardhshme të kësaj periudhe dhe në 2013 është 37,74%

Konkluzioni i përgjithshëm prej asaj se çfarë është thënë është se në periudhën e ardhshme duhet të eliminohen shkaqet që sollën në zvogëlimin e numrit të turistëve vendas, si dhe pjesëmarrja në përqindje në numrin e përgjithshëm, gjegjësisht të merren masa dhe aktivitete për avancimin dhe zhvillimin e turizmit në Rajon. Mund të vërtetohet se rajonet e tjera të cilët kanë pasur shumë më pak vizitor në vitet e kaluar në krahasim me rajonin planor Jugperëndimor, shënojnë rritje me pjesëmarrjen e tyre në përqindje.

Llogaritet se ajo i detyrohet zvogëlimit të pjesëmarrjes në përqindje të rajonit planor Jugperëndimor. Prandaj, duhet pasur kujdes në të ardhmen që të mos vihet deri në situatë të neglizhencës të rajoneve më të zhvilluara turistike në Republikën e Maqedonisë.

Vëllimi, dinamika, struktura dhe përqindje e bujtjeve të arritura

Viti	Numri i turistëve nga vendi	Baza e indeksit 2009	Numri i turistëve të huaj	Baza e indeksit 2009	Numri total i turistëve në rajon	Baza e indeksit 2009	Numri total i turistëve në RM	Pjesëmarrja në përqindje e numrit të përgjithshëm të bujtjeve në rajon në numrin e përgjithshëm të bujtjeve në Maqedoni
2009	1077229	100	248963	100	1326192	100	2101606	63,10%
2010	949524	88,1	219300	88,1	1168824	88,1	2020217	57,86%
2011	880469	81,7	328718	132,0	1209187	91,2	2173034	55,65%
2012	836097	77,6	362163	145,5	1198260	90,4	2151692	55,69%
2013	763788	70,9	388863	156,2	1152651	86,9	2157175	53,43%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet se numri i përgjithshëm i bujtjeve në Rajon zvogëlohet për shkak të zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të turistëve në atë rajon. Ashtu që, në vitin e fundit të analizuar janë realizuar 1.152.651 bujtje ose në vitin bazë 2009 janë realizuar 1.326.192 bujtje.

Si pasoj për zvogëlimin e numrit të turistëve vendas paraqitet dhe zvogëlimi i numrit të bujtjeve të realizuar në rajonin planor Jugperëndimor. Ky zvogëlim është në vazhdimësi, ndërsa vlera më e lartë ekziston në vitin e parë analizues. Shumë me rëndësi është të theksohet se në vitin 2009 janë realizuar 1.077.229 bujtje nga ana e turistëve vendas, ndërsa ky numër në vitin 2013 bie në mënyrë drastike dhe është 763.788 bujtje me indeks deri në 70,9 në raport me vitin bazë, gjegjësisht ka rënie të pothuajse 30%, çka paraqet një të dhënë shqetësuese.

Në dallim nga numri i bujtjeve nga turistët vendas, numri i bujtjeve nga turistët e jashtëm pothuajse në vazhdimësi rritet në përjashtim të vitit 2010 ku indeksi i bazuar në vitit bazë 2009 është 88,1. Ajo është e dukshme, por është një zvogëlim i përkohshëm. Në vitin e fundit të analizuar shënohet indeksi prej 156,2 gjegjësisht 388.863 bujtje të realizuara

çka tregon se më shumë turistë të jashtëm janë të interesuar që ta vizitojnë Rajonin në vitet e periudhës së analizuar.

Pjesëmarrja në përqindje e bujtjeve të realizuara të Rajonit në raport me numrin e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë, ndryshon nga viti në vit, por konkluzioni përfundimtar është se ka zvogëlim. Ashtu, që në vitin 2009 pjesëmarrja është 63,10% ndërsa në vitin 2013 është 53,43%. Kjo tregon për pjesëmarrje të madhe relative në raport me rajonet e tjera planore. Këto rezultate janë fituar si pasoj e faktit të vetëm se rajoni planor Jugperëndimor është më i zhvilluari në sferën e turizmit në Republikën e Maqedonisë.

Në periudhën e ardhshme duhet të eliminohet faktorët të cilat kanë sjell deri në zvogëlimin e vizitueshmërisë, bujtjet dhe pjesëmarrja e tyre në përqindje, gjegjësisht duhet të avancohen. Zhvillimi turistik në këtë rajon duhet ti marrë parasysh situatat edhe në territoret e tjera në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht të mundësohet zhvillim i barabartë të gjithë rajoneve.

Vizitorë dhe bujtje sipas rajoneve në Republikën e Maqedonisë, viti 2013

Vizitat e realizuara, sipas rajoneve statistikore në vitin 2013

Rajon	Numri i turistëve	Pjesëmarrja e rajonit
	Turistë	
Gjithsej	**701794**	100%
Rajoni I Vardarit	17196	2,45%
Rajoni Lindor	20747	2,96%
Rajoni Jugperëndimor	264826	37,74%
Rajoni Juglindor	109982	15,67%
Rajoni i Pellagonisë	70312	10,02%
Rajoni i Pollogut	30823	4,39%
Rajoni Verilindor	5584	0,80%
Rajoni I Shkupit	182324	25,98%
	Turistë nga vendi	
Gjithsej	**302114**	100%
Rajoni I Vardarit	4120	1,36%
Rajoni Lindor	13582	4,50%

Rajoni Jugperëndimor	130020	43,04%
Rajoni Juglindor	59977	19,85%
Rajoni i Pellagonisë	49635	16,43%
Rajoni i Pollogut	15491	5,13%
Rajoni Verilindor	1856	0,61%
Rajoni I Shkupit	27433	9,08%
Turistë të huaj		
Gjithsej	**399680**	100%
Rajoni I Vardarit	13076	3,27%
Rajoni Lindor	7165	1,79%
Rajoni Jugperëndimor	134806	33,73%
Rajoni Juglindor	50005	12,51%
Rajoni i Pellagonisë	20677	5,17%
Rajoni i Pollogut	15332	3,84%
Rajoni Verilindor	3728	0,93%
Rajoni I Shkupit	154891	38,75%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave



Raporti në përqindje i numrit të vizitorëve në rajone

Nga grafikoni vërehet se ekzistojnë dallime të mëdha relative mes rajoneve në këndvështrim të pjesëmarrjes së tyre në përqindje në numrin e përgjithshëm të vizitorëve. E rëndësishme për rajonin planor Jugperëndimor është se rajoni është i pari nga numri i vizitave në Republikën e Maqedonisë. Ashtu, që pjesëmarrja e Rajonit arrin deri në 37,74%, çka është një dukuri pozitive. Megjithatë, rajonet e tjera, në përjashtim të rajonit të Shkupit, kanë pjesëmarrje të ulët relative, çka sjell deri tel konkluzioni se në periudhën e ardhshme duhet ti përkushtojnë kujdes në rritjen e pjesëmarrjes së tyre, por jo në kurriz të turistëve nga rajonet planore më të zhvilluara.

Bujtjet e turistëve, sipas rajoneve statistikore në vitin 2013

Rajoni	Numri i turistëve	Pjesëmarrje e rajonit në %
Gjithsej	**2157175**	100%
Rajoni i Vardarit	30840	1,43%
Rajoni Lindor	42222	1,96%
Rajoni Jugperëndimor	1152651	53,43%

Rajoni Juglindor	327279	15,17%
Rajoni i Pellagonisë	162752	7,54%
Rajoni i Pollogut	61652	2,86%
Rajoni Verilindor	8244	0,38%
Rajoni I Shkupit	371535	17,22%
Gjithsej	**1275800**	100,00%
Rajoni I Vardarit	6194	0,49%
Rajoni Lindor	24987	1,96%
Rajoni Jugperëndimor	763788	59,87%
Rajoni Juglindor	231870	18,17%
Rajoni i Pellagonisë	112637	8,83%
Rajoni i Pollogut	30806	2,41%
Rajoni Verilindor	2553	0,20%
Rajoni I Shkupit	102965	8,07%
Gjithsej	**881375**	100,00%
Rajoni i Vardarit	24646	2,80%
Rajoni Lindor	17235	1,96%
Rajoni Jugperëndimor	388863	44,12%
Rajoni Juglindor	95409	10,83%
Rajoni i Pellagonisë	50115	5,69%
Rajoni i Pollogut	30846	3,50%
Rajoni Verilindor	5691	0,65%
Rajoni i Shkupit	268570	30,47%

Burimi: Enti shtetëror i statistikave



Raporti në përqindje të bujtjeve të vizitorëve nëpër rajone

Edhe në grafikonin e mëparshëm, njëjtë si edhe te vizitat, pjesëmarrja në përqindje e rajoneve në aspekt të bujtjeve të realizuara tregon në dallime relativisht të mëdha mes veti. Si më i zhvilluar përsëri paraqitet rajoni planor Jugperëndimor me përqindjen më të lartë që është edhe më i lartë se ½ e numrit të përgjithshëm të bujtjeve të realizuara në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht 53,43%. Gjithashtu, mund të vërehet një pjesëmarrje shumë të ulët e një pjesë të rajoneve çka paraqet gjendje negative që ka nevojë për ndryshime në periudhën e ardhshme.

Rekomandimi i përgjithshëm edhe këtu paraqet avancim të rajoneve më pak të zhvilluara përmes rritjes së bujtjeve, përkatësisht qëndrimit, çka nuk duhet të jetë në kurriz të stagnimit të rajoneve të zhvilluara turistike.

Nga treguesit e mëparshme të numrit të vizitorëve dhe bujtjeve në rajonet e ndryshme, mund të analizojmë numrin mesatar të bujtjeve të turistëve në rajonin planor Jugperëndimor. Kjo analizë i referohet periudhës së fundit 5-vjeçare, ndërsa rezultatet janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Mesatarja e qëndrimit të turistëve në ditë

Viti	Qëndrimi mesatar i turistëve vendas	Qëndrimi mesatar i turistëve të huaj	Gjithsej qëndrimi mesatar
2009	6,33	2,85	5,15
2010	6,14	2,74	4,98
2011	5,95	3,23	4,84
2012	5,93	3,23	4,77
2013	5,87	2,88	4,35

Burimi: Enti shtetëror për statistikë, Ilogari të përpunuara vetë

Në tabelën e mësipërme, nga analizat dhe përllogaritjet e kryera, për qëndrimin mesatar të turistëve, për ditë qëndrimi, mund të vërehen vlera dhe dallime të ndryshme.

Tek turistët vendas vërehet ulje e vazhdueshme e qëndrimit, ashtu që qëndrimi më i gjatë është regjistruar në vitin 2009 dhe atë 6,33 ditë mesatarisht, që nuk do të arrihet përsëri në vitet e ardhshme të periudhës së analizuar. Sipas asaj, qëndrimi më i shkurtër është regjistruar në vitin 2013 - 5,87 ditë.

Qëndrimi mesatar i turistëve të huaj në raport me ato vendas është më i ulët. Dallimi në qëndrimin e turistëve vendas dhe të huaj mund të shihet në atë se ka pasur një rritje në vite të caktuara, si dhe në shumën e vitit të kaluar të analizuar e cila është më e lartë se viti i parë i analizuar. Një përjashtim nga kjo rritje paraqet viti 2010 kur u paraqit një qëndrim më i shkurtër i turistëve të huaj (2,74 ditë), si dhe në vitin 2013 me një qëndrim mesatar prej 2,88 ditë.

Duke pasur parasysh se kemi një ulje drastike të turistëve vendas, si dhe zvogëlimin e numrit të bujtjeve të tyre, qëndrimi mesatar i numrit të përgjithshëm të turistëve gradualisht dhe në vazhdimësi është në rënie dhe në vitin 2009 kur qëndrimi mesatare ishte 5,15 ditë, ndërsa në vitin e fundit të analizuar ai është 4,35 ditë.

Pavarësisht tendencës së zvogëlimit të qëndrimit mesatar të turistëve vendas, si dhe numrit të përgjithshëm të turistëve në rajonin planor Jugperëndimor, vërehet fakti se në këtë Rajon ekziston qëndrimi më i gjatë mesatar i turistëve në krahasim me rajonet e tjera. Në përgjithësi mund të konkludohet se duhet të mënjanohen shkaqet e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit tek të gjithë turistët, përkatësisht vëmendje të veçantë në periudhën e ardhshme duhet t'i kushtohet avancimit të qëndrimit mesatar të turistëve të huaj, dhe gjithashtu të rritet numri i turistëve vendas dhe të vazhdohet qëndrimi i tyre mesatar. Kjo mund të realizohet përmes mënyrave të ndryshme të pasurimit së përmbajtjes së qëndrimit, avancimi dhe specializimi i ofertës turistike, si dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve turistike, dhe kuptohet edhe përmes aktiviteteve të karakterit të ndryshëm që kanë për qëllim zgjerimin e sezonit turistik.

Kapacitetet akomoduese në rajonin planor Jugperëndimor

Përveç dinamikës së vizitave turistike dhe qëndrimit të turistëve në hapësirën e rajonit planor Jugperëndimor, zhvillimi mund të monitorohet edhe sipas lëvizjeve të ndërtimit në sferën e kësaj veprimtarie. Megjithatë, kapacitetet duhet të krahasohen me rajonet e tjera, si dhe në afate kohore. Në tabelën vijuese është dhënë ajo pasqyrë për rajonet e ndryshme planore për periudhën e kaluar 5 vjeçare.

Kapacitetet akomoduese sipas rajoneve statistikore

	2009	2010	2011	2012	2013
	Numri i dhomave				
GJITHSEJ	**26390**	**26189**	**26448**	**26877**	**26887**
Rajoni planor i Vardarit	508	554	589	689	690
Rajoni planor Lindor	598	533	544	599	620
Rajoni planor Jugperëndimor	16369	16013	16033	16035	16050
Rajoni planor Juglindor	2152	2105	2277	2298	2346
Rajoni planor i Pellagonisë	3102	3390	3330	3497	3322
Rajoni planor i Pollogut	1080	1011	1018	1014	1072
Rajoni planor Verilindor	297	292	302	306	300
Rajoni planor i Shkupit	2284	2291	2355	2439	2487
	Numri i shtretërve				
GJITHSEJ	**69561**	**69102**	**69737**	**70287**	**70297**
Rajoni planor i Vardarit	1360	1496	1701	1829	1819
Rajoni planor Lindor	1718	1591	1606	1721	1826
Rajoni planor Jugperëndimor	42103	41458	41454	41458	41411
Rajoni planor Juglindor	5750	5724	6069	6088	6298
Rajoni planor i Pellagonisë	8999	10229	10165	10310	10001
Rajoni planor i Pollogut	3182	3057	3058	3059	3153
Rajoni planor Verilindor	805	633	645	653	647
Rajoni planor i Shkupit	5644	4914	5039	5169	5142



Dinamika e kapaciteteve akomoduese në rajonin planor Jugperëndimor

Nga tabela e mëparshme mund të konkludojmë se në rajonin planor Jugperëndimor ekziston ulje konstante si të numrit të dhomave, ashtu edhe në numrin e shtretërve. Gjegjësisht, rritje simbolike në numrin e shtretërve vërehet në vitin 2012 kur kemi një rritje prej 4 shtretër në raport me vitin e kaluar, çka është në të njëjtin nivel si në vitin 2010. Viti i kaluar 2013 fundit shënoi vlerën më të ulët, përkatësisht gjithsej 41.411 shtretër. Pothuajse e njëjta gjë vlen edhe për numrin e dhomave ku ka rënie të ndjeshme në vitin 2010, dhe në periudhën e ardhshme shënon një rritje simbolike. Por, edhe në vitin 2013 numri i përgjithshëm prej 16.050 është më i ulët se viti i parë i analizuar. Këto gjendje stagnimi duhet të tejkalohet në periudhën e ardhshme.

Kapacitetet e akomodimit sipas llojit për vitin 2010

Llojet e objekteve	*Numri i objekteve*	*Numri i apartamenteve*	*Numri i shtretërve*
Gjithsej	83	594	12052
Gjithsej hotele	45	203	5753
Hotele *****	1	5	250
Hotele ****	9	52	1944
Hotele ***	7	34	418
Hotele **	17	86	1934
Hotele *	11	26	1207
Motele	2	12	132
Banjat shëruese	2	6	426
Pushimore për punëtorë	8	2	903
Pushimore për fëmijë dhe të rinj	10	15	1832

Kapacitetet e përkohshme akomoduese	**1**	**/**	**256**
Objekte akomoduese të pa kategorizuara	**15**	**356**	**2750**

Nga tabela, ku janë treguar kapacitetet akomoduese në Rajon, shihet se pjesëmarrje më të madhe kanë hotelet (45) nga të cilat në numër më të madh janë ato të kategorisë më të ulët (me 1 ose 2 yje). Pas tyre pasojnë ndërtesa të pakategorizuara me 15 dhe në fund pushimoret për fëmijë dhe të rinj me gjithsej 10 njësi. Nga totali prej 594 apartamente në Rajon numri më i madh janë të paategorizuarave (356), pastaj vijnë apartamentet hotelierike me 203 njësi, ndërsa në kapacitetet e tjera kjo lloj e ofertës akomoduese është shumë e varfër.

Numri i shtretërve është më i lartë në krahasim me rajonet e tjera, dhe është e dukshme se pothuajse gjysma e tyre (5.753 shtretër) i përkasin hoteleve. Pastaj vijojnë objektet e pakategorizuara, dhe në fund pushimoret për fëmijë dhe të rinj.

Konkluzioni është se, në këtë drejtim, rajoni planor Jugperëndimor disponon numrin më të madh të objekteve dhe shtretërve nga kategoria më e lartë, por duhet të avancohen edhe llojet e tjera gjatë periudhës së ardhshme.

Konsumi turistik

Konsumi turistik është përfaqësuar përmes qarkullimit ditor në objektet hotelierike në Republikën e Maqedonisë dhe në rajonin planor Jugperëndimor, e treguar në tabelën vijuese.

Qarkullimi nga turizmi në objektet hotelierike në rajonin planor Jugperëndimor

	2011		2012		2013	
	Konsumi pansional	Konsumi jo pansional	Konsumi pansional	Konsumi jo pansional	Konsumi pansional	Konsumi jo pansional
Qarkullimi financiar i turizmit në objektet hotelierike në RM, në mijëra denarë	7428958	387385	7782534	383730	6389528	398687
Qarkullimi financiar i turizmit në objektet hotelierike në rajonin planor Jugperëndimor, në mijëra denarë	1314781	136859	1373516	147778	1378336	161525
Pjesëmarrja në përqindje e qarkullimit financiar në rajonin planor Jugperëndimor në qarkullimin e përgjithshëm në RM	17,70%	35,33%	17,65%	38,51%	21,57%	40,51%

Nga tabela shihet se konsumi pansional dhe jo pansional në Rajon rritet gjatë periudhës së analizuar. Kjo rritje është e vogël, por në vazhdimësi çka është e rëndësishme, sepse në nivel nacionale vërehet ulje. Përkatësisht, konsumi pansional është 1.378.336.000

denarë në vitin 2013, përkatësisht 21,57% nga vlera e përgjithshme, ndërsa ai jo pansional është 161.525.000 ose 40,51% në të njëjtin vit.
Me rëndësi është ajo se edhe pse ka zvogëlim të numrit të turistëve dhe bujtjet e tyre të realizuara, në Rajon vërehet rritje e konsumit të tyre. Këto trende duhet të mbahen dhe të avancohen në periudhën e ardhshme.

Infrastruktura

Infrastruktura e transportit

Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore në rajonin planor Jugperëndimor përbëhet nga rrjeti rrugor lokal, rajonal dhe rrjetit rrugor të A kategorisë. Përmes Rajonit kaloni koridori VIII evropian.

Rrjeti rrugor në rajonin planor Jugperëndimor

Infrastruktura rrugore ekzistuese në rajonin planor Jugperëndimor përbëhet nga 1.278 km rrugë lokale, 370 km rrugë rajonale dhe 99 km rrugë shtetërore të A kategorisë.



Rrugët kryesore, që lidhin këtë Rajon me rajonet e tjera janë rruga kryesore A2 Shkup - Gostivar - Kërçovë – Strugë - kufiri me Shqipërinë dhe rruga shtetërore A3 lidhja me A2 - Ohër – Resnjë.

Rrjeti rrugor në këtë Rajon është i pazhvilluar, veçanërisht rrjeti rrugor rajonal i kategorisë së 2-të. Dendësia e rrjetit rrugor në rajonin planor Jugperëndimor është 0,41 dhe më e ulët për 25% se dendësia e rrjetit rrugor në nivel të Republikës së Maqedonisë (0,55).

Gjendja aktuale e një pjese të rrugës A2 Gostivar - Kërçovë - Strugë - kufiri me Shqipërinë është në gjendje relativisht të keqe, para së gjithash, për shkak të sipërfaqeve të dëmtuara dhe elementeve të papërshtatshme teknike që ekzistojnë në këto pjesë. Në rrjedhë është ndërtimi i autostradës nga Kërçova deri në Ohër që në masë të madhe do të përmirëson udhëtimin në këtë rrugë.

Disa seksione të rrjetit rrugor rajonal në R1202 Hanet e Mavrovës – Dibër – kufiri me Shqipërinë, dhe pak më pak tek R1201 Dibër – Strugë, janë në një gjendje të keqe, para së gjithash, për shkak të elementeve teknike të rrugës dhe vende të caktuara të sipërfaqeve të dëmtuara. Në dy - tre vitet e fundit është kryer rehabilitim i këtyre rrugëve, por prapë elementet teknike edhe më tej nuk i plotësojnë standardet për këtë lloj të rrugëve. Për këtë qyteti i Dibrës nuk ka rrugë moderne me korridoret kryesore në Republikën e Maqedonisë. Është e nevojshme të përmendet edhe rruga rajonale R1301 Ohër - Peshtan - Ljubanisht - kufiri me Shqipërinë i cili, gjithashtu, ka pjesë të dëmtuara dhe elemente teknike joadekuate, çka paraqet problem për zhvillimin e trafikut normal, sidomos në stinën e verës kur fluksi i automjeteve është mjaft i madh. Rruga rajonale R1208 Ohër - Strugë (rruga e vjetër) - Radozhdë, si dhe R1303 Kërçovë - Makedonski

Brod dhe R1305 lidhja me A2 - Demir Hisar janë në gjendje të keqe në pjesë të caktuara. Rrjeti rrugor rajonal i kategorisë së dytë është i pazhvilluar dhe një pjesë e mirë e rrugëve janë të pa asfaltuara. Ato janë rrugët: R2232 (Lidhja me 1301 - Galiçicë – lidhje me 1307), R2246 (lidhje me R1202 - Osoj - Izvor – lidhje me A2), R2243 (Lidhja me R1202 - Sellcë - Lokov – Tatashi i Poshtëm - Strugë), R2240 (Lidhja me 1201 - Vevçan - Oktis - Ladorishtë – lidhja me A2) dhe R2241 (lidhje me R1201 - Llabunishtë - Jabllanicë - Lakavicë - kufiri me Shqipërinë).

Si çdo kund në Republikën e Maqedonisë, ashtu edhe rajonin planor Jugperëndimor, rrjeti rrugor lokal është kryesisht në gjendje të keqe, ndërsa në pjesë të caktuara kualiteti është në nivel aq të ulët çka paraqet rrezik potencial për zhvillim normal të trafikut. Në vitet e fundit duke përdorur fonde nga Banka Botërore, nga Ministria e transportit dhe lidhjeve, si dhe nga komunat një pjesë e rrugëve lokale janë rikonstruktuar dhe rindërtuar (3%).

Gjendja e rrjetit rrugor lokal sipas komunave

	Vevçan	Dibër	Debërc	Ohër	Strugë	Qendër Zhupë	Kërçovë	M. Brod	Pllasnicë
Asfalt	2	51	91	97	115	24	175	82	9
Pllaka bekatoni	4	25	-	-	2	-	14	-	-
Kalldërm	7	40	9	32	10	6	21	12	6
Të pa asfaltuara	5	40	5	16	111	11	33	91	5
Pa përfundurara	-	6	9	18	26	-	50	16	-
Gjithsej	18	162	114	163	264	41	293	201	20



Infrastruktura rrugore në rajonin planor Jugperëndimor në raport me infrastrukturën rrugore në Republikën e Maqedonisë

	Republika e Maqedonisë	Rajoni planor Jugperëndimor	%
Rrjeti rrugor A	1153	127	11,01%
Rrugë rajonale	3771	303	8,04%
Rrugë lokale	9258	1278	13,80%
Gjithsej	14182	1708	12,04%

Trafiku mesatar ditor në vjet i rrjetit rrugor shtetëror të kategorisë A në rajonin planor Jugperëndimor në vitin 2013 është i paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Rr. Nr.	Numri i vendit	Seksioni	TMDV						
			K1	K2	K33	K4	K5	K6	Gjithsej
A2	028	Novo Sellë - Kërçovë	3827	619	58	85	39	66	4694
A2	029	Kërçovë - Botun	3935	556	80	52	30	82	4735

A2	**025**	**Botun - Podmolje–**	**3993**	**534**	**73**	**34**	**23**	**100**	**4757**
A2	**032**	**Podmolje – Strugë**	**6639**	**633**	**93**	**88**	**56**	**142**	**7651**
A2	**033**	**Strugë - kufiri me Shqipërinë**	**2893**	**420**	**20**	**43**	**26**	**74**	**3476**
A3	**40**	**Podmolje – Ohër**	**8214**	**804**	**126**	**372**	**284**	**103**	**9903**
A3	**051**	**Ohër - Resnjë**	**1927**	**375**	**16**	**29**	**15**	**26**	**2388**

Trafiku mesatar ditor në vjet i rrjetit rrugor rajonal në rajonin planor Jugperëndimor në vitin 2013 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Rruga numër	**Numri i vendit**	**Seksioni**	**TMDV**						
			K1	**K2**	**K3**	**K4**	**K5**	**K6**	**Gjithsej**
R 1202	605	Hanet e Mavrovës - Dibër	1272	202	38	102	149	108	**1871**
R 1202	402	Dibër – kufiri me Shqipërinë	872	94	32	110	61	104	**1273**
R 1305	609	Drugovë – Demir Hisar	860	156	12	94	41	31	**1194**
R 1201	606	Dibër - Veleshtë	872	161	36	120	81	61	**1331**
R 1208	6420	Ohër - Radozhdë	2581	246	47	94	42	36	**3046**
R 1301	612	Ohër - Peshtan	7904	715	50	231	17	6	***8923***
R 1301	613	Peshtan – Shën Naum	766	65	15	8	2	0	***856***
R 1303	054	Kërçovë – Makedonski Brod	1921	448	5	79	25	18	**2496**

Infrastruktura hekurudhore

Në rajonin planor Jugperëndimor gjendet një linjë hekurudhore dhe ato në korridorin nr. VII, dhe është pjesë e vijës hekurudhore Shkup - Tetovë - Gostivar - Kërçovë (me gjatësi prej 20 km). Linja industriale hekurudhore Zajaz-Tajmishte është jashtë përdorimit.

Dendësia e rrjetit të hekurudhave në rajonin planor Jugperëndimor është 8,56 km në 1000 km^2 (27 km është mesatarja në Maqedoni), dhe gjatësia e hekurudhave për 100.000 banorë është 12,09 km (33,9 km është mesatarja në Maqedoni).

Rrjeti hekurudhor në rajonin planor Jugperëndimor ka dendësi shumë të vogël. Linja e vetme hekurudhore përfundon në rrugë të verbër. Rajoni me përjashtim të komunës së Kërçovës, aspak nuk është i mbuluar nga shërbimet hekurudhore.

Rrjeti hekurudhor në rajonin planor Jugperëndimor

Numri i udhëtarëve

viti	Kërçovë	Republika e Maqedonisë	%
2010	71.145	1.489.000	4,78%
2011	65.324	1.408.000	4,64%
2012	46.238	1.000.000	4,62%

Transporti i mallrave (tonelata)

viti	Kërçovë	Republika e Maqedonisë	%
2010	2.733	2.198.206	0,12%
2011	1.954	1.902.581	0,10%
2012	1.794	1.875.974	0,10%

Numri i udhëtarëve që udhëtojnë me tren është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme në periudhën 2010 - 2012. Reduktimi i numrit të udhëtarëve është 35% (reduktimi në nivel të Republikës së Maqedonisë është 32,84%), ndërsa transporti i mallrave ka shënuar rënie prej 34,35% (viti 2012 - 14,65% ulje në nivel të Republikës së Maqedonisë).

Trafiku ajror

Në rajonin planor Jugperëndimor është i vendosur Aeroporti Shën Pavli i cili gjendet në Komunën e Debërcës 9 km nga Ohri.

Në rajonin planor Jugperëndimor gjenden pesë kalime kufitare dhe atë katër me Shqipërinë (Bllata, Qafthanë, Shën Naum dhe Xhepçisht) dhe një në Aeroportin e Ohrit.

Infrastruktura energjetike

Infrastrukturat më të rëndësishme të energjisë që janë të vendosura në rajonin planor Jugperëndimor janë TEC Osllomej, HE Glloboçica dhe HE Shpilje.

Kombinati Miniero-energjetik Osllomej në Kërçovë ka kapacitet të instaluar prej 125 MW dhe neto prodhimin prej 700 GWh. Ky kombinat siguron rreth 10 për qind të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë. Ky termocentral si karburant primar përdor qymyrin me një vlerë mesatare kalorike prej 7600 kJ/kg, dhe konsumi i qymyrit është 1,5 kg/Wh, ndërsa konsumi i mazutit është 2,16 gr/Wh. Gërmimet vjetore janë mbi 3 milionë metra kub dhe mbi 600.000 tonë qymyr në vit.

HE Glloboçica gjendet në lumin Drin i Zi, rreth 30 km. në veri të Strugës dhe është me kapacitet të instaluar prej 42 MW dhe prodhim vjetor prej 191 GWh.

Hidroelektrana më e madhe akumuluese në rrjedhën e lumit Drini i Zi është HE Shpilje në afërsi të Dibrës. Hidrocentrali është i vendosur në bashkimin e lumenjve Drini i Zi dhe Radika. Hidroelektrana Shpilje është me kapacitet të instaluar prej 84 MW.

Infrastruktura energjetike në rajonin planor Jugperëndimor

Nga rrjeti i transmetimit dhe shpërndarjes në këtë rajon kalojnë linjat 110kV me një gjatësi të përgjithshme prej 86 km dhe linjat 35 kV me një gjatësi prej 106,5 km, ka katër 110 kV dhe nëntë 35 kV trafostacioneve, me një kapacitet total të instaluar prej 180 MVA gjegjësisht 54 MVA.

Kapaciteti i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike në rajonin planor Jugperëndimor

MW	Republika e Maqedonisë	Rajoni Jugperëndimor	%
2011	1849	257	17,85%
2012	1913	258	17,25%
2013	1938	263	17,08%

Sipas të dhënave nga Entit shtetëror të statistikave për periudhën nga vit 2011 deri në vitin 2013, konsumi i përgjithshëm mesatar vjetor i energjisë elektrike në industri në rajonin planor Jugperëndimor ishte 43,67 GWh ose rreth 1,81% të konsumit total në industri në Republikën e Maqedonisë

GWh	Republika e Maqedonisë	Rajoni Jugperëndimor	%
2011	2194	44	2,01%
2012	2693	45	1,67%
2013	2369	42	1,77%

Në rajon janë identifikuar potenciale për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme të energjisë, ndërsa në rajonin e Dibrës edhe potenciale të caktuara të ujit gjeotermal.

Janë identifikuar gjithsej 19 lokacione për mini hidroelektrane të vogla në rrjedhën e Drinit të Zi me prodhim të mundshëm total vjetor prej 38,8 GWh. Gjithashtu ekziston një mundësi për të ndërtuar katër hidrocentrale të vogla në lumenjtë Pesoçanka, Jabllanicë, Zbashka dhe Brajçinska me një prodhim total vjetor prej 52 GWh.

Mjedisi

Mbeturinat inerte

Menaxhimi me mbeturinat inerte në rajonin planor Jugperëndimor ka të bëjë me mbledhjen, transportimin dhe deponimin. Për menaxhimin me mbeturinat inerte përgjegjës janë ndërmarrjet komunale.

Sasia e mbeturinave të krijuara dhe të mbledhura

	Sasia e mbeturinave të krijuara (tonelatë)			Sasia e mbeturinave të mbledhura (tonelatë)			% e mbeturinave të mbledhura		
	2011	**2012**	**2013**	**2011**	**2012**	**2013**	**2011**	**2012**	**2013**
Republika e Maqedonisë	735.250	786.909	793.000	543.954	550.760	555.250	73,98%	69,99%	70,02%
Rajoni Jugperëndimor	88.254	87.415	97.129	47.226	49.421	55.341	53,51%	56,54%	56,98%
%	12,00%	11,11%	12,25%	8,68%	8,97%	9,97%	-20,47%	-13,45%	-13,04%

Hedhja e mbeturinave të ngurta, në këtë Rajon, bëhet në të ashtuquajturat deponi komunale, të cilat nuk i plotësojnë standardet themelore sanitare dhe teknike për mbledhje të sigurt të mbeturinave. Në këtë rajon janë shtatë deponi të regjistruara sipas planit kombëtar për menaxhimin me mbetjet, dhe sipas rrezikut të ndotjes së mjedisit klasifikohen si vijon:

Deponi me rrezik të lartë:

- „Deponia e qytetit” komuna e Kërçovës
- „Mesheishtë” komuna e Debërcës
- „Bukovë” komuna e Ohrit
- „Bellçishta” komuna Debërcës

Deponi me rrezik të mesëm

- „Vishnjë” komuna e Strugës

Deponi me rrezik të ulët:

- „Mali Vllaj” komuna e Strugës
- „Krivci” komuna e Dibrës



Lokacionet e deponive në rajonin planor Jugperëndimor

Mbulimi i popullsisë me shërbimin për deponim dhe mbledhje të mbeturinave tek popullsia urbane në komunat sillet nga 73% deri në 90%, ndërsa popullsia rurale në një vëllim shumë të vogël është i mbuluar me këtë lloj të shërbimit.

Riciklimi, përkatësisht zgjedhja e fraksioneve recikluese të mbeturinave komunale inerte bëhet në sasi të vogla dhe atë përmes selektimit të mbeturinave. Sektori joformal mbledh plastikën e hedhur, letrën dhe metalet direkt nga kontenierët për mbledhjen e mbeturinave.

Llojet e tjera të mbeturinave, të tilla si gomat, bateritë dhe akumulatorët, yndyrna nga mbeturinat dhe vajra, automjete të përdorura dhe mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike nuk selektohen dhe përfundojnë në deponi për mbeturina komunale.

Uji

Territori i rajonit Jugperëndimor përfshin pellgun e lumit Treska dhe Drinit të Zi.

Në strukturën e saj hidrografike Rajoni ka një numër të burimeve të ujit, një liqen natyror, dhe dy liqene akumuluese artificiale dhe numër të konsiderueshëm të liqeneve glaciale. Në Rajon ka shumë lumenj dhe pellgje të vegjël që i përkasin nën-pellgut të lumit Treska dhe Drinit të Zi.

Liqeni i Ohrit është liqeni më i madh dhe më i rëndësishëm natyror në Maqedoni. Liqeni përfshin një sipërfaqe prej 358,2 km² dhe shtrihet në gjatësi prej 30,8 km, dhe gjerësia e tij më e madhe është 14,8 km. Gjatësia e bregut është 87,5km. Thellësia e tij arrin deri në 289 m. Vëllimi total i liqenit është 58,6 km3. Liqeni është i vendosur në një luginë të thellë dhe të mbyllur, në lindje kufizohet me malin Galiçicë (1945 m), dhe në perëndim me Jabllanicën (2257 m). Ndodhet në lartësi mbidetare prej 695 metra. Pellgut të Liqenit të Ohrit i përkasin 40 lumenj, prej të cilat 23 në territorin e Shqipërisë dhe 17 në territorin e Maqedonisë. Më të njohura janë burimet e Ohrit tek Studençishta, të njohur si burimet e Biljanës, të vendosura në afërsi të qytetit, si dhe burimet e vendosura në afërsi të manastirit Shën Naumi, 29 km në jug nga Ohri.

Akumulacione të tashme

Akumulacione të planifikuara

Akumulacionet në rajonin planor Jugperëndimor

Liqeni i Trebenishtës

Gjendet në lindje të f.Trebenishtë rreth 1 km nga qendra e fshatit. Liqeni është natyror, është krijuar para rreth 50 vjet kur nga kodra Gaber u bë rrëshqitja e tokës dhe është mbyllur shtrati i lumit që ka rrjedhur nga Fusha e Epërme kah f.Trebenishtë dhe është derdhur në kanalin e lumit Sateska. Liqeni shtrihet në lindje-perëndim. Gjatësia është rreth 200m., ndërsa gjerësia rreth 80m. Thellësia maksimale është rreth 5m., akumulon rreth 30.000 m3 ujë. Në liqen derdhet një pellg që vjen nga Fusha e Epërme nga ana lindore, dhe prej liqenit derdhet një pellg që buron pranë rrjedhës ku edhe më herët para krijimit të liqenit rridhte pellgu, dhe derdhet në kanalin e lumit Sateska.

Liqenet pranë bregut dhe burimeve

Liqeni i Ostrovës ndodhet përgjatë bregut jugor të Liqenit të Ohrit në afërsi të manastirit Shën Naumi. Është e krijuar nga ulja e nivelit të Liqenit të Ohrit, me çka rrjedha e mëparshme nën ndikimin e valëve gradualisht është mbyllur me mur breg vijor rreth 10 metra të gjerë. Liqeni është i gjatë 220m, 140 metra i gjerë, dhe thellësia e saj maksimale është 3,5 m. Midis liqenit të Ostrovës dhe Liqenit të Ohrit ekziston rrjedhë e

vogël sipërfaqësore me gjatësi prej 12 m. Me ujë furnizohet nga burimet më të mëdha dhe të fuqishme dhe nga reshjet. Populllata lokale e konsideron si burim të lumit Drini i Zi. Liqeni i Ostrovës, në raport me Liqenin e Ohrit, konsiderohet si "kriptodepresion". Niveli i tij është më i lartë se niveli i Liqenit të Ohrit mesatarisht për 0,56 m, ndërsa shtrati është mesatarisht më i ulët për 2,94 m. nga niveli i ujit të Liqenit të Ohrit.

Akumulacionet

Liqeni i Kozjakut

Kozjak është liqeni më i madh artificial në Evropë, i gjatë 32 kilometra, me thellësi deri në 135 metra, ndërsa largësia maksimale nga njëri breg në tjetrin është 400 metra. Ndodhet në lartësi mbidetare prej rreth 470 metra dhe është i pasur me peshk. Baza e digës është 500 metra, ndërsa në majë 310 metra. Diga e cila ka lartësi prej 126,1m dhe me të cilën është ndarë rrjedha e lumit Treska, ka filluar me ndërtim në vitin 1994., ndërsa ka përfunduar dhe është lëshuar në përdorim në vitin 2004. Ndodhet rreth 25km përgjatë derdhjes së lumit Treska në lumin Vardar. Uji i akumuluar shfrytëzohet para së gjithash për qëllime hidro energjetike, si dhe për vaditjen e Fushës së Shkupit. Në akumulacionin Kozjak ekzistojnë 9 lloje peshqish.

Liqeni i Shpiljes

Është i ndërtuar në lumin Drini i Zi, dhe i mbush edhe ujërat e pjesës së poshtme të lumit Radika. Diga është argjinaturë-baltore, e ndërtuar në vitin 1969 dhe është e vendosur në afërsi të kufirit shqiptaro-maqedonas, 6 km në perëndim të Dibrës. Lartësia e digës është 101 m. E vendosur në një lartësi prej 587 metra mbi nivelin e detit, ka një gjatësi prej 330m dhe një gjerësi prej 10m. Gjatësia totale e liqenit është 22 km, gjerësia mesatare prej 0,6 km, ndërsa thellësia maksimale është 94 m. Ajo mbulon një sipërfaqe prej 13,2 km2 dhe akumulon 520 milion m3 ujë.

Liqeni i Gllobojçicës

Është vendosur në lumin Drini i Zi, rreth 20 km në veriperëndim të Strugës, dhe është ndërtuar në vitin 1965. Diga është nga guri dhe argjinatura me bazë argjirore dhe është e lartë 90 m. Gjatësia e saj në majë është 200 m dhe është e vendosur në një lartësi mbidetare prej 692 m. Liqeni është i gjatë 12 km, ka një sipërfaqe prej 2,7 km2 dhe akumulon 58 milion m3 ujë.

Liqeni i Sllatinës

Akumulimi Sllatina, ndodhet 1 km në veri-perëndim të fshatit Sllatinë, komuna e Debërcës. Liqeni është ndërtuar në vitin 1965 dhe qëllimi i tij kryesor është për të ujitur rreth 4,5 kilometra katror tokë për kultivim. I gjatë është rreth 1 km dhe gjerësia e tij më e madhe është rreth 600 m. Thellësia maksimale arrin deri në 9 metra. dhe akumulon deri në 1.000.000 metër kub ujë. Zona akumuluese e liqenit është 28,5 kilometra katrorë, ndërsa furnizues kryesor me ujë është Lumi Mramorec. Rrjedhja e ujit nga liqeni derdhet në Lumin e Sllatinës, e cila derdhet në lumin Sateska.

Liqeni i Shumit

Gjendet në fshatin Shum në afërsi të qytetit të Strugës, rreth 5 kilometra larg nga qendra e qytetit. E krijuar me ndërtim të një dige me gjatësi prej 65 metra në vet burimin e Shumit. Shumica e burimit të ujit është e kaptuar dhe përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm qytetin e Strugës dhe fshatrat përreth, dhe një sasi e ujit shkarkohet dhe me atë mbushet liqeni. Uji nga liqeni pastaj shfrytëzohet për shumimin e peshqive që rriten në ujërat e ftohta në “Shum”. Liqeni shtrihet në një lartësi mbidetare prej 702 m dhe ka një sipërfaqe totale prej afërsisht 2 hektarë. Gjatësia më e madhe është 180 m, gjatësia më e vogël është 65 m, dhe thellësia mesatare është rreth 2m.

Lumi Drini i Zi derdhet nga Liqeni i Ohrit në lartësi mbidetare prej 695 metra. Në territorin e Republikës së Maqedonisë, lumi Drini i Zi ka një gjatësi prej 56 kilometra. Pas fshatit Tashmarunishtë lumi formon akumulimin Gllboçicë, dhe para hyrjes së qytetit të Dibrës, lumi formon edhe një tjetër liqen – Liqenin e Dibrës.

Lumi Treska - Rajoni i Kërçovës mbulon rrjedhën e sipërme të lumit Treska. Ajo buron nga burim karstik që ndodhet në hendekun e depresionit dhe ka mbushje të vazhdueshme. Deri në luginën e Kërçovës lumi Treska është i njohur si Lumi i Madh. Në derdhjen e saj ka shumë burime dhe lumenj që e furnizojnë vazhdimisht, prandaj përfaqëson lumin me luhatjet më të mëdha të flukseve vjetore në Republikën e Maqedonisë. Gryka e lumit Treska është karstik dhe gjendet në afërsi të fshatit Izvor, në shpatin jugor të malit Bistra. Burimi është i vendosur 750 metra mbi nivelin e detit dhe rendimenti i saj është 1500 - 2000 l/sek.

Lumi Radika ngrihet 2200 metra mbi nivelin e detit nën Vracë. Nga burimi deri në grykën e Liqenit të Dibrës lumi është i gjatë 67 km. Në këtë rrugëtim ajo merr katër degë

dhe ato: Ribnicë, Lumin e Mavrovës, Zhirovnica dhe Lumin e Vogël. Radika ka një ujë të pastër, dhe të ftohtë me ngjyrë të gjelbër të errët që është shkaktuar nga karbonat kalciumi në të. Radika është i vetmi lum me degëzim në Maqedoni, që siguron ujë për të dy pellgjet, atë të Adriatikut dhe të Egjeut. Me kanale një pjesë e ujërave të Radikës dërgohen në Liqenin e Mavrovës dhe e mbushin me ujë, dhe nga aty me tunele nëntokësore në Vardar. Pas grykës, në Radikë derdhet dega e saj më e madhe nga ana e djathte, lumi Vallovicë, dhe pastaj rrjedhë përgjatë shpateve veriore të malit Stogovë. Pas kalimit në fshatrat Kosovrasti i Poshtëm, Milniçan i Poshtëm, Gorencë dhe Rajçicë, Radika derdhet në lumin Drini i Zi, në jug të qytetit të Dibrës. Gjegjësisht, pika më e ulët e lumit paraqet zonë përmbytjesh të Liqenit artificial të Dibrës, duke formuar kështu një gji liqeni.

Lumi Studençica - Lumi Studençica është një lum malor me një rënie të madhe. Shtrati i lumit Studençica ka një formë të zgjatur, shtrihet në shpatet juglindore të malit Bistra, dhe është 53 km2. Drejtimi i rrjedhjes është veriperëndimor- juglindor. Ajo shtrihet nga lartësia më e lartë 2.099 metra mbi nivelin e detit deri në 565 m lartësi mbi detare. Burimi kryesor është në lartësi prej 1780 metra m.n.d. Gjatësia e saj është 14,1 km. Shumica e zonës ujëmbledhëse është e mbuluar me pyje lisi dhe ahu dhe kullota. Ujërat e Studençicës shfrytëzohen për furnizimin me ujë të pijshëm vendbanimet e Kërçovës, Makedonski Brodit, Prilepit dhe Krushevës dhe vende të tjera më të vogla.

Lumi Sateska – buron në pjesën malore të Debërcës nën malet Pllaçenska dhe Ilinska. Duke rrjedhur në fushëgropën e Debërcës mbledh ujëra nga më shumë pellgje: lumi i Sllatinës, Mramorecit dhe të tjera, dhe pastaj duke kaluar nëpër Botun të hyjë në fushën e Strugës, ku rrjedh deri në derdhjen në Drinin e Zi, përkatësisht Liqenin e Ohrit. Sateska në mënyrë natyrore derdhet në Drinin e Zi ndërmjet fshatrave të Drasllajcës, Morovishtës dhe Vranishtës, dhe në mënyrë artificiale nga fundi i shekullit XX derdhet edhe në Liqenin e Ohrit jo larg fshatit të Misleshovës dhe vendbanimit turistik Vreshtat e Liqenit, përreth rrugës Ohër – Strugë. Lumi Sateska i përket pellgut të Adriatikut. Tek fshati Pesoçan lumit të Sateskës i është ndërtuar një digë me një hidrocentral të vogël. Në pjesën më të madhe uji nga lumi shfrytëzohet për vaditje në bujqësi në më shumë fshatra në pjesën lindore përreth fushëgropës së Ohrit dhe Strugës.

Ujëra nëntokësore

Shpërndarje më të madhe ka tipi karstik i zhvilluar në shkëmbinjtë karbonatik përgjatë lumit Treska, si dhe në malin Bistra. Drenimi i tij bëhet përmes një numri të madh të burimeve karstike nga të cilat më të njohura janë: Studençica, që ndodhet në anën juglindore të malit Bistra në kontaktin mes gurit argjiror dhe shistit argjiror. Ky burim është përshtatur për furnizim me ujë për Kërçovën, Makedonski Brodin, Krushevën, Prilepin dhe vendbanime tjera, dhe ka kapacitet prej 0,905 - 2,77 m3/sek. Përgjatë rrjedhës së lumit Studençica paraqiten edhe burime tjera më të vogla. Burime të tjera karstike janë: burimi i lumit Treska (0,283-5,5 m3/sek, mesatarja 1.396 m3/sek), Pitran (0,2-0,7 m3/sek), Popollzhani, burimet e Beliçës, Tajmishte, Belica (0,32-2,1 m3/sek), Peshna, burimet e Deviçës dhe të tjera. Të dhënat për kapacitetet e përgjithshme e të gjitha burimeve në këtë krahinë të menaxhimit të ujit nuk ekzistojnë, por ajo është vlerësuar në 12,0 m3/sek. Kjo paraqet shtrirjen më të madhe të ujërave nëntokësorë në kuadër të akuifereve karbonike- karstike të plasaritura.

Formacione kompakte, me nivel të lirë, është e zhvilluar në nivel lokal në sedimente Pl në fushëgropën e Kërçovës me një kapacitet të objekteve prej 1-3 l/sec. Në aluvionet e lumit Treska dhe lumenjve tjerë më të vegjël me trashësi deri në 10m me karakteristika të mira të infiltrimit dhe furnizim individual të objektit Q> 20 l/sec.

Formacione kompakte me nivel me presion janë të zhvilluara në rajonin thëngjillor të Osllomesë ku pasuria me ujë e objekteve lëviz nga 0,5-1 l/sec. Akuiferet e ngjeshura karstike përgjatë lumit Treska janë në lidhje hidraulike, kështu që bëhet fjalë për rezerva të veçanta të ujërave nëntokësor.

Përqindja e rezervave të ujërave nëntokësor (Strategjia e ujërave të R.Maqedonisë)

Krahina e ujitjes	Tipi	Trupi i ujit nëntokësor	Vlera e rezervave të ujërave nëntokësor	Eksploatimi (m^3/s)
			Statike ($h10^6m^3$)	
Treska	Kompakte	Aluvim i Lumit Treska	158	1,0
	Karstike	Bistra, Baba shac, Poreç		9,0
Gjithsej				10,0
Ohër-Strugë	Kompakte	Fushëgropa e Ohrit-Strugës (Quatemary)	161	0,5
		Fushëgropa e Ohrit-Strugës (Pliocene)	72	
	Karstike	Galiçica		5,0
		Jabllanica		
		Mali Ilinska		
Gjithsej				5,5

Infrastruktura e ujërave (Plani hapsinor i Republikës së Maqedonisë)

Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë dhe bartja e ujërave të zeza në të gjitha komunat kryhet nga ndërmarrjet e themeluara për atë qëllim.

Në të gjitha qendrat urbane në Rajon ekziston sistem urban për furnizim me ujë. Zonat rurale furnizohen me ujë për pije nga sisteme lokale ose puset.

Në qytetin e Ohrit bëhet furnizim me ujë për: qytetin e Ohrit, vendbanimet Orman, Raça, Shën Stefani, Konjsko e Poshtme, Lagadin, Peshtan dhe lokalitetet turistike përgjatë

bregut të liqenit. Nga ujësjellësit lokal furnizohen vendbanimet Vellgosht, Tërpejca, f.Ljubanisht dhe në f.Leskoec.

Në komunën e Strugës furnizimi me ujë bëhet duke bashkuar më shumë burime të vendosura në shpatet e malit Jabllanica. Këto burime kanë ujë të shëndetshëm dhe kualitativ për pije.

Në komunën e Dibrës, 80% e popullatës është e mbuluar me sistem për furnizim me ujë të pijshëm dhe atë kryesisht popullata urbane. Në pjesët rurale, kryesisht ka mungesë të sistemeve për furnizim me ujë, me çka banorët nevojën për ujë për pije e sigurojnë përmes zaptimit të burimeve. Edhe pse numri më i madh i banorëve janë të kyçur në sistemin e furnizimit me ujë, vlen të theksohet, se sistemet e tjera për furnizim me ujë janë në gjendje të keqe.

Pothuajse të gjitha fshatrat përballen me problemin e mungesës së ujit të pijshëm, që është pasojë e mesatares së lartë të konsumit për banorë, si dhe gjendjes së sistemeve për furnizim me ujë të cilat karakterizohen me humbje të larta të ujit (mesatarisht mbi 50%), së pari për shkak të vjetërsisë së tyre (kryesisht më të vjetër se 15 vjet), vëllimet e pamjaftueshme të rezervuarëve, stacioneve pastruese dhe objekteve të tjera.

Sistemet rajonale të ujësjellësve

Mungesa e ujit për pije që paraqitet në kohë të caktuara të vitit, në disa komuna të këtij Rajoni, mund të zbutet, dhe në disa komuna plotësisht të eliminohen me sanimin dhe rekonstruimin e rrjeteve ekzistuese, me çka do të ulen edhe humbjet teknike të ujërave në rrjetet shpërndarëse.

Furnizimi, shfrytëzimi dhe mbrojtja e ujërave nga ndotja nga industria dhe xehetaria

(në mijëra m3)	Republika e Maqedonisë			Rajoni Jugperëndimor			%		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Furnizimi me ujë	6.368.589	5.869.979	5.006.246	3.793.642	4.083.286	2.583.647	59,57%	69,56%	51,61%
Ujërat e shfrytëzuar për qëllime teknologjike	6.251.678	4.953.364	4.923.165	3.825.503	3.280.028	2.575.023	61,19%	66,22%	52,30%
Derdhja e ujërave të zeza	6.224.267	5.062.710	4.808.627	3.793.172	3.296.675	2.575.476	60,94%	65,12%	53,56%
Derdhja e ujërave të pastruara	20.131	77.573	92.492	30	13.077	21.848	0,15%	16,86%	23,62%
Derdhja e ujërave të zeza nga industria dhe xehetaria	1.435.562	820.679	1.045.121	847844	639.739	537.986	59,06%	77,95%	51,48%

Ujërat e zeza

Ndërmarrjet publike të cilat janë përgjegjëse për kullimin e ujërave të zeza, ujërat atmosferik dhe ujërat industrial menaxhojnë me 263,3 km të rrjetit urban të kolektorëve të cilat kryesisht janë të vendosura në qendrat urbane të komunave. Mbulimi i popullsisë me rrjetin e kanalizimit në qendrat urbane është nga 70% në Dibër deri në 100% në Strugë, ndërsa në zonat rurale mbulimi i popullsisë me sistemet për kullimin e ujërave të zeza është i vogël. Në numrin më të madh të vendbanimeve rurale nuk ekzistojnë sisteme të kanalizimit.

Në rajonin e Ohrit është ndërtuar rrjeti i kanalizimit sekondar me gjatësinë prej 108 km dhe atë në qytetin e Ohrit dhe në vendbanimet Konjsko e Poshtme dhe Llagadin. Është ndërtuar kanalizimi atmosferik në gjatësi prej 8629 m. Përqindja e kyçjes së shfrytëzueseve në sistemin e kanalizimit për qytetin e Ohrit është 92%.

Stacioni për trajtim të ujërave të zeza për qytetin e Ohrit dhe Strugës, si dhe vendbanimeve dhe objekteve turistike që janë të vendosura në breg vijën e Liqenit të Ohrit ndodhet rreth 4 km nga qyteti i Strugës (mes fshatrave Vranishta dhe Llozhan). Stacioni ofron trajtim mekanik dhe biologjike të ujërave të zeza. Për ujërat e zeza industriale është e obligueshme trajtimi i tyre para lëshimit të ujërave të zeza në kanalizim. Kapaciteti i impiantit të ndërtuar është për 120.000 popullsi ekuivalente, ndërsa uji i pastruar derdhet në lumin Drini i Zi.

Në qytetin e Dibrës ka sistem për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe ai i mbulon 70% të popullsisë urbane, ndërsa rreth 40% e vendbanimeve në komunë nuk janë të lidhura me të. Për të zgjidhur problemin e ujërave të zeza dhe fekalet në qytetin e Dibrës parashikohet ndërtimi i dy impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në lokacionin Çeshmica dhe Trapi i Dacit për cilat janë përgatitur dokumentacionet teknike.

Shkalla e mbulimit të popullsisë me impiante të trajtimit të ujërave të zeza në nivel rajonal (Rajoni Jugperëndimor) është jashtëzakonisht e lartë. Ai është 43,8% dhe është shumë larg mbi mesataren e Maqedonisë, e cila është 12,5%. Ajo është gjithashtu shumë e rëndësishme në aspektin e mbrojtjes së Liqenit të Ohrit dhe të gjithë lumenjve që derdhen në pellgun e Adriatikut – lumi Drini i Zi dhe derdhësi i saj i djathë, njëkohësisht më i madhi – lumi i Radiksë si dhe mbrojtjen e botës së gjallë nga efektet dëmtuese të ujërave të zeza urbane.

Cilësia e ujit

Cilësia e ujërave sipërfaqësore në rajonin planor Jugperëndimor është relativisht e mirë. Lumi Drini i Zi është kategorizuar në kategorinë e dytë. Gjatë periudhës verë-vjeshtë, në pikën e matjes në Strugë, herë pas here uji është i klasës së tretë për shkak të pranisë së ndotjeve organike dhe mikrobiologjike. Sipas Rregullores për klasifikimin e rrjedhjeve dhe liqeneve në Republikën e Maqedonisë, të gjithë lumenjtë e pellgut të Drinit të Zi janë kategorizuar si të kategorisë së II-të.

Cilësia e ujit në lumin Treska, në burim, nuk ka ndryshime të rëndësishme prej viteve të mëparshme. U përgjigjet të gjithave kritereve të cilësisë të kategorisë së parë. Në pikën e matjes nën Kërçovë – fsh. Bigor – Dolenci cilësia e ujit shpesh e kalon sasinë e lejuar të ndotjes organike dhe mikrobiologjike, si pasojë e ujërave të zeza nga qyteti i Kërçovës.

Ujërat e Studençicës në burim janë kategorizuar të klasës së I-rë, ujë i pastër oligotrofik. Kapaciteti prurës është shumë i mirë, vazhdimisht është i pasur me oksigjen dhe ka përmbajtje të ulët të vlerave ushqyese dhe baktereve, ka përmbajtje të ulët të ndotjes antropogjene me materie organike. Në disa kilometra nëpër rrjedhjen, ujërat e lumit Studeniçica, kalojnë në klasën e dytë.

Ujërat e Sateskës në burim janë kategorizuar si ujë i klasës së parë, ndërsa pas disa kilometrave gjatë rrjedhjes ujërat kalojnë në klasën e II-të.

Ujërat në Liqenin e Ohrit pas ndërtimit dhe vendosjes në funksion të sistemit për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, janë me cilësi të mirë, kryesisht ujërat janë të kategorisë së parë dhe të dytë. Në disa lokalitete paraqitet degradim kryesisht në lokalitetin e Shën Sofijës dhe rreth limanit.

Disa lumenj e ngarkojnë sistemin e liqenit të Ohrit dhe ato janë lumenjtë Çerava, i cili vjen nga pala shqiptare, dhe uji i së cilës është me cilësi shumë të keqe të klasës të 4 dhe të 5, si dhe lumenjtë Koselska, Vellgoshka dhe Sateska të cilët gjithashtu derdhen në liqen dhe e mbingarkojnë ekosistemin e tij. Lumi i Velgoshkës ka ndotjen e klasës së 4 dhe të 5, ndërsa Koselska dhe Sateska janë të klasës të 3 dhe të 4.

TE Oslomej është identifikuar si lokalitet industrial i kontaminuar - "vatër e nxehtë", i cili është ndotës potencial i ujërave.

Ujitja

Në rajonin planor Jugperëndim gjenden dy njësi për menaxhim të ujit dhe ato: njësia e Dibrës e cila ndodhet në pjesën perëndimore të Maqedonisë, përreth rrjedhjes të lumit Drini i Zi dhe Radikës. Qendra kryesore është Dibra. Furnizuesi kryesor i Lumit Drini i Zi nga ana e majtë është Modrishka, ndërsa furnizuesit të djathë janë Lumi Selaçka, Dolgaç dhe Radika. Furnizuesit kryesor të Radikës janë Mavrovica, Lumi i Vogël dhe Rambica.

Krahina e Ohër - Strugës e cila ndodhet në pjesën perëndimore të Maqedonisë përfshin luginën e Ohrit dhe Strugës dhe fund malet e Jabllanicës, Galiçicës, Karaormanit dhe të tjerë. Qendrat më të mëdha urbane janë Ohri dhe Struga. Recipientët kryesorë të ujit sipërfaqësor janë Liqeni i Ohrit dhe lumi Drini i Zi. Të rëndësishëm janë edhe lumenjtë Kosellska dhe Sateska të cilat derdhen në Liqenin e Ohrit.

Fusha e tretë ujitëse është sistemi i Treskës.



Njësit për menaxhimin me ujin në rajonin planor Jugperëndimor

Nga aspekti për tu mbrojtur nga përmbytjet në rajonin planor Jugperëndimor, gjendja me lumenjtë është si vijon:

Krahina e Ohrit – Strugës: Pjesa e lumit Drini i Zi është e rregulluar dhe pjesa tjetër e lumit është trajtuar për mbrojtjen nga përmbytjet (10,9 km në rrethin e Strugës) dhe janë ndërmarrë veprime të caktuara në lumin e Sateskës; Ekziston një numër i madh i lumenjve të vegjël me derdhje në Liqenin e Ohrit të cilët kanë karakter të përkohshëm; Disa dukuri të ujërave të larta të cilat mund të shkaktojnë përmbytje lokale janë vërejtur

në rrethin e Strugës; është e nevojshme të bëhet mirëmbajtja e përhershme dhe të bëhet pastrimi i sistemeve të kullimit për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga lumenjtë Drini i Zi dhe Sateskës dhe duhet të ndërmerren masa rehabilituese;

Në krahinën e Dibrës janë të vendosura një numër më i vogël i derdhjeve të cilat kanë kapacitet eroziv; ujërat të larta periodike të lumit Radika shkaktojnë dëmtime në rrugën Gostivar-Dibër; kanali i lumit Drin i Zi, është e domosdoshme të ketë mirëmbajtje të përhershme të kanaleve dhe shtratit me heqjen e vegjetacioneve në vend akumulimin Shpilje, heqjen e llumit dhe përforcimin e brigjeve.

Toka punuese

Prishja e kualitetit të tokës punuese në rajonin planor Jugperëndimor del nga:

- Përpunimi joadekuat në zonat bujqësore, dhe kultivimin e kulturave që kërkojnë pleh artificial intensiv dhe pesticide; Shkatërrimi i shtresave të tokës punuese, erozioni, shkatërrimi i pyjeve dhe kullotja e tepruar;

- Ndryshimi i strukturës fizike dhe kimike i tokës punuese nën ndikimin e objekteve ekzistuese industriale, si dhe depozitimi i sendimenteve nga ndotja e ajrit;

- Përdorimi i ujit të ndotur për ujitje;

- Menaxhim jo adekuat me ujërat dhe ujërat e zeza;

Ndotja industriale



Ndotja industrial në rajonin Planor Jugperënëdimor

Në rajonin planor Jugperëndimor është identifikuar një "vatër e nxehtë" me kontaminim industrial. T.E. Osllomej e cila përfshin sipërfaqe prej 280.000 m^2 dhe sasia e përgjithshme e mbeturinave është 2.000.000 m^3.**Erozioni**

Norma mesatare e erozionit për basenin e Ohrit është 3 sr = 0,19, me çka pozicionohet në zonën e V-të të kategorisë së shkatërrimit.

Degët e Liqenit të Ohrit kanë karakter të rrëmbyeshëm. Problem të veçantë paraqet lumi Sateskë që në shtratin e saj natyral është degë e djathë e lumit Drini i Zi. Ajo është mbartësja më e madhe e lymit (112.907 m3 në vit). Përveç ndotjes mekanike me lym, lumi i Sateskës shkakton ndotje kimike. Lumenj të tjerë të rrëmbyeshëm në pellgun e liqenit të Ohrit janë lumi i Kosellskës me degët Skrebatska, Vapillska, Sirullska dhe lumit Letniçka.

Pjesa më e madhe e pellgut (42%) është nën ndikim më të dobët të erozionit. Në kategorinë me erozion në formë më të rëndë (I dhe II) bien vetëm 6% e pellgut, por ata përfaqësojnë burim të madh të lymit.

Zona e pellgut të lumit Drini i Zi deri tek profili i digës së Globoçicës, e treguar në koeficient të erozionit është z=0,24, dhe i përket shkallës së IV të shkatërrimit.



Erozioni dhe hazartet natyrale – plani hapsinor i R. Maqedonisë

Intensiteti i erozionit në rajonin hapësinor Jugperëndimor është:

Rajoni	Rajoni kategorie I-III (km2)	Rajoni kategori IV-V (km2)	Kategoria e përgjithshme dhe koeficienti
Rrethi i Dibrës	328,24 (28,83%)	810,11 (71,17%)	IV z=0,38
Ohër-Strugë	339,52 (36.63%)	587,24 (63,37%)	IV z=0,24

Ajri

Cilësia e ajrit në rajonin planor Jugperëndimor ndiqet me stacion fiks për monitorimit dhe me pajisje për marrjen e mostrës së madhe, si pjesë e rrjetit Nacional për monitorim të cilësisë së ajrit e organizuar nga MAJPH, njëri stacion është i vendosur në Kërçovë. Stacionet e monitorimit fikse monitorojnë parametrat ekologjikë dhe meteorologjike: karbonit monoksidit CO (mg/m3), dioksid squfuri SO2 (g/m3), O3 ozonit (g/m3), grimca të pezulluara me madhësi grimce prej 10 mikronë (mg/m3), shpejtësinë dhe drejtimin e erës, temperaturën, presionin, lagështinë dhe parametra të tjerë.

Cilësia e ajrit në rajonin Jugperëndimor është relativisht e mirë me përjashtim të zonave të caktuara urbane, ku gjatë periudhës së dimrit ka disa rritje të elementeve ndotës të koncentruar edhe atë kryesisht grimca të RM. Të dhënat për cilësinë e ajrit janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Vendi matës	36të koncentrimi më i lartë mesatar ditor i PM10 (µg/m3)			Koncentrimi më i lartë mesatar vjetor i NO2 (µg/m3)			26ta Koncentrimi më i lartë mesatar 8-orësh ditor l O3 (µg/m3)			4ta koncentrimi më i lartë mesatar ditor i SO2 (µg/m3)		
Vlerat bazë	50 µg/ m3 nuk duhet të të tejkalohen më gjatë se 35 ditë në një vit kalendarik			40 µg/m3 vlera mesatare kufitare vjetore			120 µg/m3			125 µg/m3		
viti	2009	2010	2011	2009	2010	2011	2009	2010	2011	2009	2010	2011
Kërçovë	138	125	73	30,01	29	44	119	-	-	122	20	-

Natyra

Rajoni planor Jugperëndimor karakterizohet me natyrë shumë të bukur dhe i nënshtrohet mbrojtjeve të ndryshme. Në rajonin planor Jugperëndim shtrihen: Liqeni i Ohrit si zonë e mbrojtur, shumë lokalitete historike, parku nacional Galiçica, por edhe vende të reja të propozuara me rëndësi të lartë natyrore. Liqeni i Ohrit së bashku me parkun nacional Galiçica krijojnë një tërësi natyrore e cila është e lidhur me trashëgiminë kulturore, historike dhe natyrore.

Liqeni i Ohrit ka vlera të mëdha në drejtim të ruajtjes së biodiversitetit, gjeomorfologjisë, vlerave natyrore dhe ato hidrologjike. Kjo zonë i përfshin moçalet e Studençishës në Ohër dhe mbetjet e moçalit të Strugës mes fshatit Kalishtë dhe Ladorishtit dhe Strugës.

RAJONI PLANOR JUGPERËNDIMOR



LEGJENDA
Krahina reprezentative të mbrojtura
Krahina të propozuara për t'u mbrojtur
Krahina të reja të identifikuara për mbrojtje

Hapësira e propozuar paraqet tërësi integrale e cila në vetvete përfshin llojllojshmëri të madhe biologjike dhe vlera kulturore - historike. Liqeni i Ohrit përfaqëson një nga ekosistemet ujore më të rëndësishme evropiane dhe botërore sipas pasurisë së botës së gjallë dhe organizmave relikte që i posedon. Gjatë periudhës së dimrit është një nga vendqëndrimet më të rëndësishme të shpendëve ujor në rajon. Kënetat e përfshira janë pjesë e pandashme e ekosistemit të liqenit të Ohrit, por kanë nevojë për revitalizim. Zona është e regjistruar si zona Emerald dhe zonë e rëndësishme për rritjen e bimëve (ZMR Liqeni i Ohrit).

Parku nacional Galiçica i shtohet zonës së mbrojtur të Liqenin të Ohrit dhe si Park Nacional dhe është i një rëndësie të madhe biologjike dhe gjeomorfologjie.

Karakteristika më e rëndësishme e parkut nacional Galiçica është pozicioni që ka, në mes të dy liqeneve - Ohrit dhe Liqenit të Prespës, pastaj, orografin e llojllojshme, strukturat gjeomorfologjike interesante (lugina të thella, terrene akullnajore, cirqe, forma karstike dhe shpella), përbërje e larmishme e vegjetacionit dhe florë shumë të pasur (prania e shumë specieve endemike dhe relikte) dhe prania e shumë monumenteve të rëndësishme kulturore dhe historike, ku një vend të veçantë merr Manastiri i Shën

Naumit, i cili përfaqëson një vend të shenjtë të vjetër sllav i ndërtuar në shekullin e X. Zona ka kushte të mira për qëllime turistike me një spektër të gjerë të aktiviteteve turistike: turizmi veror liqenor, turizëm për fundjavë, turizëm transit, turizëm për peshkimi, turizëm malor, turizëm seminarik dhe afarist.

Në parkun nacional janë dy zona të ndara: rreptësisht të mbrojtura dhe meliorative. Zona rreptësisht e mbrojtur është zonë rreth majës Magaro (2.254 m), pjesët në perëndim prej tij dhe lokalitetet Livadhi i Ri dhe Tepeno me të dy cirqe. Kjo zonë mbulon një sipërfaqe prej 550 ha. Zona meliorative zë hapësirën e mbetur të parkut nacional. Në të ka rezervate të shumta natyrore dhe monumente të natyrës.

Në territorin e Rajonit planor Jugperëndimor, ndodhet edhe mali i Jabllanicës, i cili është propozuar për zonë e mbrojtur me status të Parkut Nacional i cili në vetvete përfshin disa njësi të vogla: burimet e Vevçanit, Gështenjës së butë – Belica e Epërme, Ella – Vevçan, lumi Drenaçka dhe Llukova. Propozimi për Park Nacional është propozuar për të mbrojtur biodiversitetin dhe llojllojshmërinë, rëndësinë gjeomorfologjive, mbrojtjen e peizazhit, mbrojtja e rrjedhjeve të ujit dhe rëndësinë hidrologjike.

Mali i Jablanicës është një nga 13 malet në vend që arrijnë lartësi 2,000 m mbi nivelin e detit. E veçanta e kësaj hapësire përbëhet nga reliefët fosil akullnajor dhe fosil para akullnajor dhe katër liqene akullnajore. Mbetjet më mbresëlënëse të relievit morfoplastike si shkak të kushteve akullnajore në Republikën e Maqedonisë vërehen pikërisht në malin e Jabllanicë. Në Jabllanicë janë regjistruar pesë cirqe klasike, si dhe disa cirqe më pak të ekspozuara. Në pjesët më të larta të malit të Jabllanicës me rëndësi të veçantë është prania e formave para akullnajore të mikro relievit dhe të mesme. Fizionomia kryesore e shpateve jugore të majës Strizhek (2,233 m) i japin lumenjtë shkëmbor. Mund të thuhet se në këtë drejtim Strizheku është një nga majat më mbresëlënëse në Gadishullit Ballkanik. Mali i Jabllanicës së bashku me malin Galiçicës dhe lumin Drini i Zi bien në zonën refugjiale. Në këtë zonë eksitojnë edhe disa bashkësi relikte, duke e përfshirë edhe Ericetum carneae të malit Jabllanica. Flora me bimë të larta është shumë e pasur në malin e Jablanicës. Numri i fierit dhe grupeve të ngjashme, bimët pa fara dhe bimët lulëzuese arrin në 1250 lloje. Ka rreth 35 lloje që janë të rëndësishme në aspektin e ruajtjes të llojllojshmërisë biologjike. Në Listën e Kuqe janë evidentuar 9 lloje të bimëve që rrezikohen IUCN(1998). Ka 4 lloje CORINE dhe 11 të tjera që i plotësojnë kriteret e CAF (Zonë me bimësi të rëndësishme) kategorive. Lista e

endemikëve lokal përfshin dy lloje. Ka shtatë lloje për të cilat Jabllancia është i vetmi vend i njohur në Maqedoni, dhe 20 specie tjera konsiderohet të jenë shumë të rralla në Maqedoni. Janë regjistrua 107 lloje të kërpudhave, prej të cilave 34 janë lignikole dhe 73 terikole. Më së shumti janë të llojit Basidimycota 88 të tilla, 7 janë Gasteromycetes dhe 12 të llojit Ascomycota. 86 lloje mund të përdoren për ushqim, ndërsa 22 janë helmuese.

Në malin e Jablanicës, amfibet janë të përfaqësuara me 13 specie. Grupi i zvarranikëve është i përfaqësuar me 27 lloje. Prej më herët është vërejtur shumimi i shqiponjës së artë (Aquila chrysaetos), dhe në një shënim të vitit 1985 edhe kërmë ngrënësja e llojit (Gypaetus barbatus). Gjitarët në malin e Jabllanicës janë të përfaqësuara me 40 lloje, që është gjysma e faunës së përgjithshme të gjitarëve në Maqedoni. Moli i Ballkanit është i vetmi nga tre speciet nën endemike në Maqedoni dhe ndodhet në Jabllanicë. Sidomos është e rëndësishme ekzistenca e gjitarëve të mëdhenj (thundrakët dhe egërsirat). Prezenca e mishngrënësve të mëdhenj (ariu, rrëqebulli dhe ujku) në Jabllanicë është me një rëndësi të veçantë për biodiversitetin. Në Jabllanicë ka dy lloje të kafshëve të rrezikuara që janë në Listën e Kuqe IUCN, dhe gjashtë janë në Direktivën e Habitatit të BE (92/43/EEC). Në malin e Jabllanicës janë gjetur gjithsej 124 lloj kafshë vrapuese. Prania, e llojeve termofile, dhe atyre të larta malore, Jabllanicës i jep një vlerë të veçantë. Përqindja e llojeve endemike është (21%) në malin e Jabllanicës dhe afrohet maleve perëndimore të Maqedonisë siç janë: Mali i Sharrit, Bistra, Pelisteri dhe Korabi. Ka edhe 6 specie të rralla dhe tre specie endemike të merimangave në Ballkan. Më shumë se 40 lloje të kërmijve terestrike janë gjetur në malin e Jabllanicës. Për 17 lloje të kërmijve terestrike konsiderohen të jenë endemike në Maqedoni ose edhe në Ballkan. Territori i PN Jabllanica të propozuar përfshin edhe më shumë zona të mbrojtura. Zona të propozuara për mbrojtje sipas Planit Hapësinor në Rajonin planor Jugperëndimor.



Jasen (Frashër), prej vitit 1958, ka statusin e rezervatit të mbrojtur natyror i cili në fillim e përfshinte pjesën e malit Karaxhica, ndërsa më vonë, në vitin 1960, është zgjeruar dhe me Gorën e Thatë. Rezervati përfshin sipërfaqe prej 24.000 ha, me të cilin është përfshirë i gjithë kanioni i lumit Treska. Pika më e lartë në rezervat është maja Karaxhica me 2.473 m. Baza gjeologjike është me shtresa të holla dolomiti prej liskuni. Në rezervat shtrihet edhe liqeni artificial i Kozjakut, i gjatë 32 kilometra, dhe në disa vende i thellë deri në 130 metra, por me rreze distance nga njëri breg në tjetrin deri në 400 m.

Nga bimët të cilat mund të shfrytëzohen përmenden: Sideritis scardica (çaji i malit të sharrit), Arctostaphyllos uva-ursi (veshi i ariut), Juniperus communis (dëllinjë e mavijosur), Thymus tosevii, Thumus longiden var. lanicaulus (shpirti i nënës), Achillea millefolium (bari i hajdutit) dhe Cornus mas (thana). Nga bota shtazore në Jasen ka dhi

të egra, arusha, rrëqebulla etj, prej shpendëve – (Tetrastes bonasia) kërmë ngrënësi kokëzbuluar (Gyps fulvus), huti (Bubo bubo) etj.

Përveç gjuetisë, Jaseni ardhmërinë e vet e shikon edhe në zhvillimin e resurseve natyrore të eko –turizmit. Atje çdo herë (varësisht nga sezoni) mund të shkohet për të ecur, për biçikletizëm malor, kampim rreth liqenit Matka dhe Kozjak, për parashutizëm, peshkim, spaleologji, alpinizëm.

Në territorin e rajonit jugperëndimor ka shpërndarje edhe vlera të tjera të rëndësishme natyrore:

• Shpella Jaorece- (Bellçista, OH), zoologjik, vlera gjeomorfologjie dhe paleontologjie
• Stogova Jugore - Monument Natyror, vlera gjeomorfologjie, biologjike
• Studençica - Monument Natyror, vlera hidrologjike
• Lumi Baçishka – Park Natyror, vlerë botanike
• Mali Ilinska - një park natyror, vlerë botanike
• Lisat moçalor - gjë e rrallë natyrore, vlerë dendrologjike
• Lisi Ploskaç - Prisovjani, Lisi Ploskaç Mislodezhda – Rrapi -Bixhovë dhe Rrapi - Veleshtë (Platanus orientalis) - gjë e rrallë natyrore, vlerë dendrologjike
• Dobovjani - gjë e rrallë natyrore, vlerë paleontologjie
• Burimi Popollzhani - gjë e rrallë natyrore, vlerë hidrologjike
• Lis moçali Lisiçan, gjë e rrallë natyrore
• Pitran - gjë e rrallë natyrore, vlerë hidrologjike
• etj

Kultura

Rajoni planor Jugperëndimor disponon me trashëgimi kulturore të patundshme të pasur, me vlera kulturore, historike dhe artistike, çka dëshmon ekzistencën dhe vazhdimësinë e civilizimit në këto hapësira ndër shekuj. Kërkimet arkeologjike janë dinamike, dhe gjithashtu, janë të regjistruara kisha dhe manastire me arkitekturë dhe fresko-përshkrime me vlerë të pa vlerësueshme.

Ansamblet ndërtimore kanë një rëndësi të veçantë në historinë e arkitekturës. Në rajon ndodhet një pasuri e madhe e kullave dhe kalave, përmendore dhe shënime përkujtimore, objekte nga arkitektura islame, çarshia dhe pjesë tjera historike dhe urbanistiko-arkitektonike, objekte afariste dhe patundshmëri. Gjithashtu, në rajon hasen

edhe institucionet kulturore dhe zhvillohen manifestime shumë të rëndësishme. Etnografia në pjesën më të madhe të rajonit ka karakteristika burimore.

Sipas Regjistrit Nacional për trashëgimin kulturore në rajonin planor Jugperëndimor janë regjistruar më shume se 350 objekte të famshme kulturore – historike. Qyteti i Ohrit, me natyrën e tij të rrallë dhe pasurinë kulturore, është i mbrojtur nga UNESKO.

Krahina e Ohrit dhe Strugës vlerësohet si më e pasura jo vetëm në nivelin e rajonit planor Jugperëndimor, por edhe në nivel shtetëror. Numri i monumenteve të paluajtshme të kulturës, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Maqedonisë, në Ohër është 69, ndërsa në Strugë 30. Monumentet e paluajtshme janë regjistruar edhe në komunat e tjera.

Në fushëgropën e Ohrit dhe Strugës ka edhe mbetje Neolite (Livadhet e kishës – në Vranishtë – në rrethin e Strugës dhe Goja – në Strugë dhe Gjiri i eshtrave – në rrethin e Ohrit – vendbanime neolite, Sredorçe e Epërme – Debërc dhe Tërno e Poshtme – Debërc).

Epoka e metaleve është e shënuar me lokalitete nga periudha e bakrit në Goja - Strugë, nga periudha e bronzit, gjithashtu, në Livadhet e Kishës – Vranishtë, ndërsa nga koha e hekurit në Trebenishtë – Komuna e Debërcës dhe Porta e Epërme – Ohër, Lozishte-Reçica – Ohër.

Nga koha para romake janë regjistruar këto lokalitete Lihnid – Ohër, Shën Erazmo – Ohër, Kalaja – Koxhaxhik – Komuna e Qendër Zhupës, Udovë –Komuna e Dibrës, Shën Ilija – Dollogozhdë – Komuna e Strugës dhe Kalaja e Ohrit.

Periudha romake len trashëgimi kulturore në lokalitetin Lihnid – Ohër.

Nga periudha parakrishtitit paraqiten lokalitetet: Plaoshnik, Shën Erazmo dhe Studençishta në Ohër, Ladorishta dhe Oktisi – Komuna e Strugës.

Nga kishat dhe manastiret më të rëndësishme mund të veçohen: Manastiri Shën Naumi dhe Shën Patelejmoni – Plaoshnik nga shekulli i IX, Shën Sofia shekulli XI, Shën Mërija Perivlepta XIII, Shën Jovani i Bekuar – Kaneo shekulli i XIII, Shën Erazmo shekulli XIV, Shën Stefani nga shekulli i mesëm, Shën Nikolla Bolniçki shekulli i XIV, Shën Mërija Bolniçka shekulli i XIV, Shën Vraçi i Vogël shekulli i XIV, Shën Konstantini dhe Elena XIV, Shën Dimitrija shekulli i XIV dhe Shën Mërija Çelnica shekulli i XIV në Ohër, Shën Mërija Zahumska shekulli i XIV, Shën Mërija Peshtanska shekulli i XIV, Shën Spase – Leskoec- rrethi i Ohrit, Shën Petka – Vellgosht, Shenjtërimi i Shën Mërisë shekulli XV Velestovë-rrethi i Ohrit, Shën Nikolla-Openica shekulli XIV, Shën Gjergji-Reçica- rrethi i

Ohrit dhe Shën Gjergji Vërbjani shekulli XIII, Manastiri Shën Si shekulli XV- Leshan, Shën Gjergji shekulli XV-Godivje dhe Shën Mërija-Vërbjan shekulli XV, të gjitha në komunën e Debërcës.

Në Komunën e Dibrës kisha më të njohura janë: Shën Petka shekulli i XII, Shën Varvara XVI – Rajçic, manastiri Shën Gjergji Fitimtari shekulli XIX. Në Komunën e Strugës më të rëndësishme janë kompleksi i manastirit Shën Mërija në Kalishtë me kishën në shpellë nga shekulli XV, kishat në shpellë Shën Arangjeli dhe Mihaili shekulli XIII- Radozhdë dhe Shën Spase -Vishnjë shekulli i XV dhe Shën Gjergji – Strugë shekulli i XVI në të cilën ndodhet edhe ikona Shën Gjergji nga vitit 1267. Në Vranishtë ndodhet bazilika e përkushtuar për Shën Mërin shekulli i XI. Në Komunën e Makedonski Brodit ndodhet manastiri i Shën Mërisë i shekullit XIV – Modrisht dhe kisha Shën Mëria Episkepsis shekulli i XIX, e ndërtuar në themelet e kishës së vjetër nga shekulli i XIII. Në Drugovë ndodhet manastiri Shën Mëria e Virgjër shekulli i XIV.

Në rajon janë të përfaqësuara edhe monumentet e kulturës të konfensionit islam. Nga më të rëndësishmet janë: Xhamia e Ajdar Pashës nga shekulli i XV dhe Xhami e Zejnel Abedin Pashës nga shekulli i XVII dhe Helvati Teqe në Ohër.

Kullat dhe qytetet e fortifikuara janë monumente të rëndësishme të kulturës në këtë rajon. Vend dominues zë kështjella e Ohrit, lokaliteti Gradishte dhe muret e Kiklopskit mbi Shën Erazmon në Ohër. Lokacionet të cilat meritojnë të trajtohen me valorizime të larta janë edhe Kalaja në Koxhaxhik – Komuna e Qendër Zhupës dhe Udova – Komuna e Dibrës. Një atraksion të veçantë kulturor përfaqëson edhe kështjella Kulla Devina – Deviç, si dhe qyteti Kalaja Stolovatec – Belicë në Komunën e Makedonski Brodit.

Në grupin e monumenteve kulturore si lloj i arkitekturës së vjetër qytetare dhe komplekset e vjetra qytetare dhe shtëpitë numërohet trashëgimia kulturore e ruajtur edhe pse nën ndikimin e madh nga presionet e urbanizimit modern dhe arhitekturës së re. Mes tyre më të rëndësishme janë komplekset e Varoshit në Ohër dhe shtëpitë e Robevcëve dhe Uranijës, dhe në Strugë pjesa e vjetër e qytetit.

Prej monumenteve dhe pllakave përkujtimore nga historia dhe kultura më e re me rëndësi janë Përmendorja e luftëtarëve të rënë në LNÇ në Ohër dhe Strugë.

Niveli i zhvillimit kulturor në rajonin planor Jugperëndimor shihet edhe nga përfaqësimi i institucioneve nga fusha e kulturës. Ndër më të rëndësishmet janë: Enti për mbrojtjen e monumenteve në Ohër i cili i përfshin Muzeun kombëtar, Muzeun e shkrimit slloven dhe Galeria e ikonave në kompleksin Shën Mërija Perivlepta dhe muzetë e tjera. Në Strugë më i rëndësishëm është Muzeu natyroro–shkencor Nikolla Nezllobinski, Shtëpia

përkujtimore e vëllezërve Miladinovci dhe Galeria e re e hapur e ikonave në Strugë dhe rrethinë.

Faktor për zhvillimin e kulturës përfaqësojnë edhe shtëpitë e kulturës ose qendrat kulturore të cilat ndodhen në Ohër, Strugë, Dibër, Kërçovë dhe Makedonski Brod dhe të cilat duhet të zhvillohen, dhe të ndërpritet tendenca e mbylljes së tyre.

Karakteristik është numri i vogël i bibliotekave, në veçanti në mjediset rurale. Zhvillimi rural duhet të bazohet edhe në këtë segment nga rritja e nivelit kulturor.

Në vitin e fundit regjistrues, në rajon, është regjistruar vetëm një teatër profesional, ndërsa teatro amatore janë të pranishme në Strugë, Dibër dhe Kërçovë.

Rajonit rëndësi të veçantë i japin edhe manifestimet më të rëndësishme me karakter ndërkombëtar dhe nacional. Ato janë festivali Vera e Ohrit, Mbrëmjet Strugane të poezisë, Festivali Ballkanik i këngëve dhe valleve popullore, Takimet e Përliçevit, Mbrëmjet poetike të Velestovës, Mbrëmjet Strugane të vjeshtës, Revyja e veshjeve popullore – Strugë, Festivali i këngëve dhe valleve popullore (Këngë Jeho) – Strugë, Ditët e kulturës – Dibër, Ditët e poezisë – Dibër, Festivali i teatrove – Dibër, Karnavali i Vevçanit, Ditët e Goces në Podgorcë, Kolonia e artit në Belçishtë – Debërc, Kolonia e artit në Kërçovë dhe në numër i madh i ekspozitave të artit.

Etnografia është frutë i traditës kulturore dhe multikulturore të gjatë. Ajo mund të shihet nga krijimtaria popullore e ndërtimit, aktivitetet afariste, ushqimi, veshja, traditat dhe këngët dhe vallet popullore.

Karakteristikat e rajonit në këndvështrimin e trashëgimisë kulturore është se një numër i madh i vlerave të vërejtura dhe lokaliteteve, gjegjësisht monumentet kulturore–historike ndodhen në zonat rurale në pjesët kodrinoro-malor, çka përfaqëson aktivitete për mbrojtjen dhe kultivimin e vlerave.

Planifikimi i zhvillimit rajonal

Vizioni

Rajoni planor Jugperëndimor është i zhvilluar në aspektin socio–ekonomik dhe infrastrukturor, me menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, respektimin e

dallimeve multikulturore, me mjedis jetësor të mbrojtur dhe me trashëgimi kulturore të njohur.

Qëllimet afatmesme

Procesi i identifikimit të qëllimeve dhe prioriteteve afatmesme

Bazuar në rezultatet e analizave sektoriale dhe rezultatet e marra prej punëtorive të organizuara gjatë përgatitjes së Programit, janë përcaktuar qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat për nxitjen e zhvillimit të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën vijuese pesëvjeçare. Gjatë përcaktimit të qëllimeve, prioriteteve dhe masave, janë marr parasysh parametrat zhvillimore dhe fushat me interes për zhvillimin e rajonit të përcaktuara më parë, si dhe qëllimet dhe prioritetet e strategjive kombëtare të fushave të analizuara, duke përfshirë edhe Strategjinë e rishikuar për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë.

Janë definuar këto qëllime afatmesme:

1. Ekonomi moderne rajonale e bazuar në teknologji të lartë dhe njohuri

2. Arsim i përshtatur me nevojat e zhvillimit ekonomik, kujdesit social efikas dhe shëndetësor të popullsisë në rajon dhe krijimi i kushteve për parandalimin e migracionit

3. Zhvillimi i turizmit i bazuar në trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

4. Ruajtja cilësore e ambientit jetësor

Në kuadër të çdo qëllimi afatmesëm, gjatë mbajtjes së punëtorive dhe rezultatet e analizave sektoriale, u definuan prioritetet që do të mundësojnë arritjen e qëllimeve.

Në vazhdim është dhënë një përshkrim i qëllimeve afatmesme dhe më poshtë vijojnë prioritetet për çdo qëllim afatmesëm dhe masat kryesore për secilin prioritet.

Qëllimi afatmesëm 1

Ekonomi moderne rajonale e bazuar në teknologji të lartë dhe njohuri

Rajoni planor Jugperëndimor ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim, sidomos duke pasur parasysh burimet natyrore, strukturën e larmishme të popullatës dhe mundësitë për turizëm. Por viteve të fundit rajoni dështoi për të vërtetuar valorizimin e këtyre avantazheve, gjatë së cilës shumë nga sektorët e ndryshëm/aktivitete pësuan stagnim. Ky trend vlen edhe për lëvizjen e prodhimit të brendshëm bruto që e bën rajonin planor Jugperëndimor një nga më të pazhvilluarit në vend.

Në periudhën e ardhshme, nga ana e qeverisë qendrore janë planifikuar investime në infrastrukturën rrugore të cilat së bashku me avantazhet që disponon Rajoni mundet të jenë një bazë e shkëlqyer për zhvillim dhe ta bëjnë rajonin planor Jugperëndimin një nga rajonet me rritje më të shpejtë në vend.

Përveç burimeve natyrore, rajoni ka vendosje të mirë infrastrukturore dhe qasje në tregje të cilat mund të rrisin nivelin e tregtisë së jashtme dhe zhvillimin e bizneseve të vogla nëpërmjet shfrytëzimit optimal të potencialeve turistike.

Nr.	Treguesit	Treguesi viti bazë	Treguesi 2019
1	PBB, në milionë denarë	34805	**37241 (+7%)**
2.	Niveli i papunësisë	42.3 %	**24 %**
3.	Bruto-vlerë e shtuar në milionë denarë	30002	**32102 (+7%)**
4	**Gjithsej prodhim bujqësor në tonelata**	**85.500**	**+12%**

Prioritetet për arritjen e qëllimit afatmesëm:

Prioritet 1.1

Rritja e konkurrencës në ekonominë rajonale

Rajoni planor Jugperëndimore ka një bazë të shkëlqyer për ndërtimin e kapitalit njerëzor cilësor. Numri i institucioneve arsimore është rritur dukshëm në vitet e fundit, me çka në fokus kryesor u vendos kuadri me produktivitet të lartë të cilët mund ta ndihmojnë sektorit privat në gjenerimin më të lartë të vlerës së shtuar. Tani ka ardhur një kohë kur

duhet të shfrytëzohen të mirat e këtyre investimeve në arsim dhe të orientohen në mënyrë efektive për rritjen ekonomike në rajon.

Me qëllim rritjen e konkurrencës në ekonominë rajonale, fokusi do të jetë i vendosur në sektorin e TIK dhe në brendimin e produkteve të mirë njohur për Rajonin.

Rezultate dalëse	Treguesit
Analiza e përgatitura për nevojave që ka sektori privat për kapitalin njerëzore në rajonin planor Jugperëndimor **Aktivitetet e realizuara për të përshtatur aktivitetet në institucionet arsimore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit privat** **Numri i studentëve dhe nxënësve që ndjekin punën praktike** **Numri i kompanive me nevoja të kapitalit njerëzor të analizuara** **Numri i trajnimeve të realizuara, punëtori** **Materiale të përgatitura për promovim dhe informim** **Numri i produkteve të brenduara** **Numri i kompanive në sektorin e TIK** **Përgatitje e paket materialeve promovuese për përfitimet e firmave nëse investojnë në TIK**	**Shuma e përgjithshme e fondeve të shfrytëzuara nga burime të brendshme dhe të jashtme financuese** **Shuma totale e investimeve në sektorin e TIK** **Prodhimi dhe eksporti i industrive kryesore në Rajon** **Numri i të punësuarve në sektorin e TIK**

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin këto masa themelore si në vijim:

Masa 1.1.1

Lidhje e institucioneve arsimore – shkencore dhe institucionet kërkimore në Rajon me biznesin

Kjo masë i referohet të dy anëve të tregut të punës dhe lidhjen e tyre me qëllim përputhshmërinë e ofertës dhe kërkesës. Numri i rritur i institucioneve arsimore në rajon është një bazë e mirë për krijimin e kapitalit njerëzor cilësor dhe vetëm me komunikim të rregullt me sektorin privat mund të sigurohet shfrytëzimi optimal i këtij potencialit njerëzor dhe nivel të lartë të produktivitetit.

Zbatimi i kësaj mase do të jetë i orientuar kah:

- Identifikimin e kompanive të cilat do të angazhohen në komunikim të rregullt me institucionet arsimore dhe do të fillojnë bashkëpunimin për të përputhur kërkesat dhe ofertat për tregun e punës

- Organizimi i evenimenteve për të rritur informimin për nevojat që i ka sektori privat

- Përshtatja e aktiviteteve në sektorit e arsimit në përputhje me nevojat e kompanive dhe tregut të punës

- Krijimi i një procesi konsultativ me sektorin privat gjatë përgatitjes të programeve arsimore

Aktivitetet treguese
Hulumtimi për nevojat kapitale njerëzore në sektorin privat
Përgatitja e analizës sektoriale për nevojat e tregut të punës
Rritja e komunikimit në mes të sektorit privat dhe institucioneve arsimore nëpërmjet organizimit të takimeve, punëtorive, forumeve dhe ngjarje të tjera publike
Përfshirjen e sektorit privat në evenimente për rritjen e kapaciteteve
Organizimi i punës praktike
Marrja e regjistrit të kompanive që ofrojnë punë praktike
Bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë për masat / mbështetja që ua ofrojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Masa 1.1.2

Rritja e kapaciteteve inovative të ndërmarrjeve nga Rajoni

Kapaciteti inovativ i kompanive është çelësi për të fituar avantazhin e tyre konkurrues. Inkurajimi i kreativitetit dhe kapacitetit për inovacion të kompanive do të mundësojë rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punën e tyre. Kjo nënkupton rritjen e njohurive për kuptimin dhe analizimin e tregut, konsumatorëve, aktivitetet e mundshme që mund të aplikohen dhe kështu me radhë. Kjo masë do të jetë e orientuar kah zgjidhjet e teknologjisë moderne që mund të aplikohen për të përmirësuar proceset e biznesit.

Aktivitetet treguese
Organizimi i trajnimeve
Përgatitja e materialeve promovuese për përfitimet nga posedimi i kapacitetit për inovacion
Prezantimi i studimeve të projekteve të suksesshme
Organizimi i evenimenteve publike për inkurajimin e frymës inovative (mirënjohjet publike, çmime, etj).
Organizimi i konkurseve
Vizita studimore
Bashkëpunimi me fondin inovativ dhe për zhvillim teknologjik për promovime të përbashkëta para kompanive
Bashkëpunim me Ministrinë e ekonomisë dhe prezantimi i masave për mbështetjen e aktiviteteve

inovative

Masa 1.1.3

Rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara për qasje deri tek fondet përkatëse në nivel shtetëror dhe BE

Me avancimin në procesin e integrimit kah BE, do të hapen më shumë programe dhe fonde për financim ku Maqedonia do të ketë të drejtë për të aplikuar. Kjo vlen për të gjitha palët e interesuara, si për organizatat fitimprurëse ashtu edhe për ato jo-fitimprurëse, pushteti vendor dhe kështu me radhë. Situata aktuale është e tillë çka shfrytëzimi i programeve aktuale për financim është në nivel të pa lakmueshëm. Për shumë organizata kjo mënyrë e sigurimit të mjeteve është një gjë e re, kështu që ato kanë nevojë për të rritur informimin dhe njohuritë. Nga ana tjetër, ka organizata që kanë njohuri të mira për programet aktuale, por duke marrë parasysh rezultatet në aspektin e burimeve të siguruara, është e qartë se ka vend për përmirësime tek të gjitha palët e interesuara.

Aktivitetet treguese
Identifikimi i burimeve të financimit
Informim i rregullt për thirrjet e hapura për informim
Ndarja e përvojave të suksesshme për projekte të realizuara
Organizimi i sesioneve informative
Trajnime dhe punëtori
Përgatitja e një listë të partnerëve të mundshëm nga vendet e tjera prej fushave të ndryshme
Përgatitja e aplikacioneve të përbashkëta
Përgatitja e letrave mbështetëse

Masa 1.1.4

Përfitimet e veçanta për investitorët që investojnë në teknologji të lartë, robotikë dhe TIK

Vendosja e TIK si një nga sektorët kyç strategjike është e rregulluar plotësisht në pajtueshmëri si nivel rajonal ashtu edhe kombëtar. Gjegjësisht, nga njëra anë është e ditur se qeveria qendrore është veçanërisht e fokusuar në zhvillimin e këtij sektori dhe nga ana tjetër rajoni planor Jugperëndimor disponon me kapacitet të shkëlqyera arsimore për zhvillimin e TIK. Në përputhje me këtë, mundësitë për efektet sinergjike ekzistojnë, me çka kjo masë do të jetë e orientuar kah analizimi i mundësive për investime në sektorin e TIK, zbatimi i masave stimuluese dhe promovimi i përfitimeve.

Aktivitetet treguese
Analiza e mundësive për të investuar në TIK
Analiza e tregut të fuqisë punës dhe zbatimin e masave për rritjen e kapitalit njerëzor
Komunikimi me institucionet e nivelit qendror për të siguruar informacione në lidhje për përfitimet nëse investohet në TIK
Bashkëpunimi me institucionet të nivelit lokal për analiza dhe zbatimin e masave për stimulimin e investimeve në sektorin e TIK
Udhëzues për të investuar në TIK në rajonin planor Jugperëndimor
Sesione informative
Përgatitja e materialeve promovuese
Prezantime

Masa 1.1.5

Brendimi i Rajonit dhe produkteve kryesore

Rajoni planor Jugperëndimor ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e produkteve të veçanta. Këto produkte janë një mundësi e shkëlqyer për të promovuar Rajonin dhe trashëgiminë e tij kulturore dhe natyrore. Grupet kyçe janë bizneset lokale, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, artizanatet etj, të cilat me ofertën e tyre kontribuojnë në ndërtimin e një identiteti rajonal.

Zbatimi i kësaj mase nënkupton përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të interesuar në nivel rajonal, si njësit e vetëqeverisjes lokale, sektorit privat, OJQ-të, etj. Do të jetë e nevojshme dhe vendosja e komunikim të rregullt dhe bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe me përgjegjësi në këtë fushë.

Në përgjithësi, me këtë masë, fokus i veçantë do ti jepet industrive bartëse për të cilat rajoni planor Jugperëndimor ka treguar potencial të veçantë.

Aktivitetet treguese
Analiza sektoriale për industritë bartëse në rajonin planor Jugperëndimor
Organizimi i evenimenteve për të rritur shkëmbimin tregtar
Organizimi i sesioneve informative me institucione shtetërore relevante përgjegjëse për brendimin
Organizimi i punëtorive në temën e brendimit rajonal
Mapimi i brendeve rajonale
Organizimi i evenimenteve për promovimin e brendeve rajonale
Komunikimi me sektorin privat për përputhshmërinë e ofertës të standardizuar të brendeve rajonale
Mbështetja e bizneseve lokale për tu brenduar

Prioriteti 1.2

Tërheqjen e investimeve në Rajon

Rajoni planor Jugperëndimor ka përparësi të caktuara që mund të jenë veçanërisht tërheqëse për investitorët. Rajoni ka strukturë të ndryshme etnike të popullatës së bashku me numrin e madh të mërgimtarëve mund të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në sigurimin e qasjes në tregje, mbajtjen e aktiviteteve promovuese, tërheqjen e investitorëve dhe kështu me radhë. Për më tepër, një faktor shtesë pozitiv është infrastruktura e pranishme (në afërsi ka aeroport) dhe investimet e paralajmëruara në infrastrukturën rrugore. Rajoni planor Jugperëndimor është gjithashtu një nga rajonet më të njohurit në Ballkanin Perëndimor, çka e bën atë tërheqës për investitorët.

Të përmbledhura, nga njëra anë rajoni planor Jugperëndimor ka potenciale të madh për tërheqjen e investimeve, dhe nga ana tjetër ka mundësi të konsiderueshme për promovim para një sërë aktorë relevant të interesuar. Kjo e vë rajonin në një gjendje jashtëzakonisht të favorshme e cila duhet të shfrytëzohen në mënyrën e duhur.

Rezultatet dalëse	Treguesit

Udhëzues për investime **Analiza e potencialeve për investime në rajonin planor Jugperëndim** **Numri i rajoneve të binjakëzuar** **Numri i aktiviteteve të realizuara me rajonet e binjakëzuar** **Numri i evenimenteve promovuese** **Numri i vizitave studimore** **Materiale promovuese**	**Niveli i investimeve në mjete themelore** **Bruto vlera e shtuar** **Fluksi i investimeve të huaja**

Realizimi i këtij prioriteti përfshin këto hapat themelore si në vijim:

Masa 1.2.1

Mapimi i potencialeve të Rajonit për investime

Rajoni planor Jugperëndimor disponon me potenciale të jashtëzakonshme për investim në karaktere të ndryshme:

• Burimet natyrore mund të jenë veçanërisht interesante për shumë investitorë (burimet e energjisë të rinovueshme, turizëm, etj);

• Zonat e Planifikuara (ZZHTI, industriale, turistike) – më shumë zona për zhvillim teknologjik – industrial janë planifikuar dhe të njëjtat mund të shfrytëzohen në funksion të zhvillimit të Rajonit. Qeveria qendrore kryen promovime intensive të këtyre instrumenteve për zhvillim ekonomik të cilat nëse realizohen në nivelin lokal dhe rajonal mund të japin rezultate shumë të mira;

• Reduktimi i kapaciteteve të (të mëparshme) caktuara industriale hapin mundësi për investime Brownfield;

• prania e njohurive për industritë të cilat hyjnë në sektorët prioritare të qeverisë qendrore (p.sh. industria e automobilave)

Aktivitetet treguese

Analizë gjithëpërfshirëse të potencialeve të rajonit (ZZHTI, Brownfield, zonat industriale, mundësitë potenciale për koncesione, biznes klima, fuqia punëtore, komunikimit, etj).
Bashkëpunimi me Drejtorinë e Zonave të Zhvillimit industriale teknologjike për të promovuar potencialet
Mapimi i lokacioneve për Brownfild në bashkëpunim me Agjencionin për investimet e huaja dhe promovimi i eksportit dhe përmirësimi i bazës ekzistuese të informacionit
Identifikimi i potencialeve për koncesionet dhe promovim
Analiza e fuqisë punëtore dhe profilet të cilat ofrohen
Marrja e iniciativave dhe aktiviteteve për të përmirësuar biznes klimën

Masa 1.2.2

Promovimi i potencialit ekonomik të Rajonit

Pas përcaktimit të saktë të potencialeve të Rajonit është e nevojshme qasje e koordinuar për promovim. Përpjekje të mëdha për promovimin po bëhen në nivele të ndryshme nga ana e qeverisë dhe për këtë qëllim, është e nevojshme përputhshmëria dhe lidhshmëria me qëllim për të arritur rezultate të mira. Zbatimi i kësaj mase është i orientuar kah:

- Bashkëpunimi me Agjencinë për investime të huaja dhe promovim të eksportit
- rritja e bashkëpunimit në mes ekonomisë lokale dhe investimeve të huaja
- promovimi i përcaktuar kah palët e interesuara relevante
- Rrjetëzimi me qëllim për të rritur shkëmbimin tregtar, gjegjësisht rritja e aktiviteteve ekonomike në Rajon
- ndërtimi i partneriteteve për të promovuar Rajonin

Aktivitetet treguese

Promovimi i potencialeve ekonomike të rajonit përmes binjakëzimit me rajonet e zhvilluara
Vizita studimore
Nxitja e takimeve të përbashkëta dhe evenimenteve për rrjetëzim
Vizitimi i rajoneve të tjera në funksion të promovimit të potencialeve për investime dhe krijimi i partneriteteve me ndërmarrjet nga rajonet e tjera
Promovimi i rajonit si një vend tërheqës për të investuar
Udhëzues për Investitorët
Materiale promovuese
Fushatë përmes internetit
Shfrytëzimi i promotorëve ekonomike jashtë vendit
Forcimin e bashkëpunimit me Agjencinë për investime të huaja dhe promovim të eksportit
Promovim i mundësive për investime në Rajon para mërgimtarëve jashtë vendit
Organizimi i evenimenteve lokale për të promovuar para mërgimtarëve
Lidhje me shoqatat e mërgimtarëve
Lidhja e ekonomisë lokale dhe investimet e huaja me industritë bartëse

Prioriteti 1.3

Fuqizimi i sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Rajon

Pak më shumë se 10% prej numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë të vendosura në rajonin planor Jugperëndim. Është interesante të theksohet se në Rajon ka ndryshime të mëdha në numrin e ndërmarrjeve, gjegjësisht numërohet në mesin e rajoneve me një numër më të madh të bizneseve të reja të sa po hapura (10,63% të numrit të përgjithshëm të subjekteve të sapo krijuara) por edhe për numrin e ndërmarrjeve të mbyllura (10,86% e numrit të përgjithshëm të subjekteve të mbyllura) . Kjo tregon shpirtin sipërmarrës që mbretëron në rajon dhe me qasje të duhur kjo situatë mund të shfrytëzohet në mënyrë sa më të volitshme.

Rezultatet dalëse	Treguesit

Numri i klasterëve të mbështetura **Numri i biznes inkubatorëve të mbështetura (ekzistuese dhe sapo të krijuara)** **Numri i kompanive të mbështetura në biznes inkubatorët** **Numri i NVM të mbështetura** **Numri i evenimenteve të mbajtura për mundësitë e financimit për NVM** **Numri i kompanive pjesëmarrëse në evenimente për prezantimin e mundësive për financim të NVM.** **Shfrytëzimi i programeve për financim** **Numri i artizanateve të mbështetura** **Pikat e përcaktuara për shitjen e produkteve tradicionale** **Numri i firmave të informuar në lidhje me programet e ndryshme për financimit** **Numri i firmave që kanë aplikuar për program të ndryshme për financim**	**Numri i të punësuarve në kompanitë e vendosura në biznes inkubatorët të mbështetur** **Rritja e të ardhurave dhe fitimit të kompanive të cilat janë vendosura në biznes inkubatorët e mbështetur** **Numri i të punësuarve të rinjve tek NVM e mbështetura** **Rritja në të ardhurat dhe fitimin tek NVM-a e mbështetura** **Numri i kompanive që kanë siguruar fonde prej programe të ndryshme** **Shitjet e realizuara të produkteve tradicionale**

Realizimi i këtij prioriteti përfshin këto hapa bazë si në vijim:

Masa 1.3.1

Forcimi i kapaciteteve menaxhuese tek sipërmarrësit ekzistues dhe potencial prej biznesin të vogël

Kapaciteti i menaxherëve të bizneseve është kyç për zhvillimin e ndërmarrjeve, dhe me këtë edhe të zhvillimit të rajonit. Në ekonominë moderne, bizneset po përballen me një sërë sfidash të tilla siç janë nevoja për kapacitete inovative, konkurrenca globale, vlerat të lidhura efektive etj. Për ti kuptuar dhe zgjidhur të gjitha këto pyetje nevojiten kapacitete adekuate të menaxherëve. Pa kapacitetet adekuate të menaxherëve, mbijetesa dhe progresi i ndërmarrjeve të vogla mund të jetë në rrezik.

Aktivitetet treguese
Trajnime
Studimet e rasteve
Vizita studimore
Punëtori
Udhëzues për Menaxherët
Vizita në kompanitë jashtë vendit
Bashkëpunimi me Agjencionin për programe kombëtare dhe mobilizim për organizimin e punës praktike në kompani jashtë vendi për menaxherët e rinj

Masa 1.3.2

Mbështetje për Start-up bizneset

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistika, popullsia në rajonin planor Jugperëndimor ka një qëndrim pozitiv ndaj fillimit të biznesit. Popullsia tregon dëshirë për hapjen dhe drejtimin e bizneseve të tyre dhe me mbështetje dhe motivimin e duhur, kjo mund të jetë një instrument i rëndësishëm për rritjen ekonomike. Në këtë drejtim, në të ardhmen duhet punuar në futjen e formave të ndryshme të mbështetjes për të filluar start - up biznese me çka do të zvogëlohej numri i bizneseve të mbyllura dhe do të stimulohet zhvillimi i bizneseve të vogla.

Aktivitetet treguese
Mapimi dhe sigurimi i lokacioneve për hapjen e biznes inkubatorëve
Identifikimi i formave për mbështetje të biznes inkubatorëve
Qendrat për këshillim
Parqet industriale
Përshpejtues për biznesin e vogël
Mbështetje për resurset njerëzore
Mbështetje financiare
Realizimi i sesioneve informuese për të paraqitur konceptin e 'Science based business' qendrave
Inkurajim i kompanive dhe prezantimi i mundësive për beneficionet nga 'science basen business' qendrat
Përgatitja e materialeve promovuese

Masa 1.3.3

Shfrytëzimi i programeve për financim në sektorin NVM

Shfrytëzimi i programeve për financimin në sektorit e NVM-me nuk është i kënaqshëm. Kjo nuk vlen vetëm për rajonin planor Jugperëndimor, por për të gjithë vendin. Arsyet për këtë mund të jenë si niveli i ulët i informimit për ekzistimit të këtyre programeve, metodat e aplikimit, proceset e aplikimit etj.

Prandaj, është e nevojshme për të përmirësuar marrëdhëniet në mes të atyre që administrojnë këto programe dhe aplikuesve potencial. Rritja e nivelit të informimit dhe njohurive tek aplikuesit do të çojë në shfrytëzimin më të mirë të mjeteve, dhe më në fund do të ketë progres më të madh në sektorit e NVM.

Aktivitetet treguese

Identifikimi i burimeve të mundshme të financimit dhe dërgimi i informacioneve deri tek palët e interesuara
Prezantimi i projekt aplikacioneve të cilët kanë qenë të suksesshëm
Bashkëpunimi me Bankën Maqedonase për mbështetjen dhe zhvillim e programeve për NVM-me.
Bashkëpunimi me Fondin për inovacione dhe zhvillim teknologjik për programet e tyre për mbështetjen e NVM
Fondi i Bashkëpunimit për inovacione për programet e tyre për të mbështetur NVM-të
Organizimi i sesioneve informative për programet dhe fondet për financim
Mbështetje gjatë procesit të aplikimit
Përgatitja e materialeve promovuese
Sesione informative
Takimet me odat

Masa 1.3.4

Lehtësimi i punës të zanateve tradicionale

Artizanati është veçanërisht i rëndësishëm për rajonin planor Jugperëndimor duke marrë parasysh trashëgiminë historike, kulturore dhe natyrore të rajonit. Potencialet janë të mëdha, tradita ekziston por janë të nevojshme masa stimuluese që do të parandalohet shuarja e artizanateve të vjetra.

Mbështetja e artizanateve mund të jetë në dobi të madhe për promovimin e turizmit, promovimin e mikro- bizneseve, parandalimin e shpërnguljeve nga zonat rurale dhe në ndërtimin e një identiteti rajonal.

Aktivitetet treguese
Organizimi i evenimenteve për promovimin e masave për mbështetjen e artizanateve
Organizimi i evenimenteve publike, manifestime
Përgatitja e materialeve promovuese
Organizimi i zanatçinjve në rajon
Mbështetje për qasje deri në financa
Zhvillimi i aftësive
Lehtësimin e qasjeve deri tek tregjet
Këshillime

Masa 1.3.5

Mbështetje për përfaqësim të përbashkët të kompanive

Kompanitë në rajonin planor Jugperëndim, po edhe në mbarë Republikën e Maqedonisë janë shumë të vogël që të mund mendojnë për një prezantim individual në tregun global. Niveli i konkurrencës globale është jashtëzakonisht i lartë dhe vetëm më të mirët mbijetojnë. Për këtë shkak, është e nevojshme të krijohet shoqatë e kompanive për përfaqësimin e tyre të përbashkët. Bashkimi i kompanive me veprimtari të ngjashme do t'u mundësoj ndarjen e resurseve, infrastrukturën, zvogëlimin e shpenzimeve, përgjigje e përbashkët për porosit të cilat janë përtej mundësive të tyre individuale etj. Ky lloj bashkëpunimi do të japë efekte sinergjike midis kompanive të cilat mund ti përdorin për përfitimin e tyre.

Aktivitetet treguese
Hapja e shitoreve të përbashkëta për prodhime tradicionale
Shitje e përbashkët e produkteve tradicionale në vende strategjike
Organizimi i evenimenteve publike
Bashkëpunimi mes kompanive të ngjashme
Paraqitje e përbashkët në tregjet e huaja
Mbështetje të klasterave
Vizita nëpër panaire

Prioriteti 1.4

Qëndrueshmëria e bujqësisë dhe zhvillimi rural

Qëndrueshmëria e bujqësisë dhe zhvillimi rural është i mundur vetëm përmes zhvillimit të një sektori modern të prodhimit bujqësor primar dhe zhvillimin e industrisë përpunuese.

Koncept i qëndrueshëm i zhvillimit të bujqësisë përfshin masa përmes të cilave përmirësohet gjendja në aspektin e rregullimit të tokës bujqësore, cilësinë e saj, si dhe cilësinë e produkteve bujqësore, por edhe prodhimtarinë e përgjithshme bujqësore. Sigurisht Koncepti i qëndrueshëm për zhvillim të bujqësisë parimisht është i orientuar kah ruajta e ambientit jetësor. Rritja e vlerës të produkteve bujqësore, dhe me këtë edhe prodhimin i përgjithshëm bujqësor është imperativ për arritjen e qëndrueshmërisë në bujqësi. Prodhimi i ushqimit organik i cili në vitet e fundit është në rritje, është një mundësi e mirë për zhvillimin e produkteve cilësore të cilat kanë vlerë më të madhe në krahasim me produktet të përftuara me bujqësi konvencionale. Të gjitha masat e

parashikuara nën këtë prioritet drejtpërdrejt ose tërthorazi kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale në Rajon.

Rezultatet dalëse	Treguesit
Numri i studimeve të përgatitura	Sasitë e kimikateve të përdorura
Numri i fushatave dhe takime informuese	Mbulimi i sistemeve bujqësore me sistem të ujitjes
Numri i promovime të organizuara për investime në kapacitetet përpunuese	Numri i shfrytëzuesve të sistemit për ujitje
Numri i takimeve promovuese për fondin e garantuar nacional	Sipërfaqja e tokës bujqësore e riemërtuar
Numri i projekteve për objektet e nevojshme për popullatën më të re dhe më të vjetër	Numri i kapaciteteve për aktivitetet pas-vjeljes
Përgatitja e baza për të dhënat për infrastrukturën rrugore	Shuma e fondeve të shfrytëzuara
Gjatësia e rrugëve lokale të rekonstruktuara dhe të ndërtuara	Shuma e parave të shpenzuara nga fondi
Numri i projekteve për infrastrukturën komunale në fshatra	Numri i objekteve të reja të ndërtuara nga zhvillimi social (kopshte, klube për pensionist)
Numri i evenimenteve për promovimin e veprimtarisë ekonomike rurale	Shuma e investimeve në akuakultur, bujqësi, pylltari, gjueti, artizanate
	Vlera e shtuar bruto në bujqësi, pylltari dhe peshkim
	Pjesëmarrja e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit në PBB

Masa 1.4.1

Përmirësimi i cilësisë dhe ofertës për produktet bujqësore

Të gjithë palët e interesuara që janë përfshirë në zinxhirin e ushqimit, janë të ballafaquar me një numër më të madh të mundësive për hyrje në tregje, por edhe kërcënimeve që janë krijuar me miratimin e standardeve të përbashkëta dhe rregullave të tregut. Konkurrenca e rritur detyron prodhuesit e ushqimit në rajon për të filluar aplikimin e metodave moderne për të përmirësuar prodhimin bujqësor përmes aplikimit të inovacioneve teknike në këtë fushë.

Transferimi i njohurive është një faktor i rëndësishëm i cili kontribuon në adaptimin e suksesshëm të bujqësisë. Prodhimi i integruar kontribuon kah përmirësimi i menaxhimit të fermave për krijimin e metodave të qëndrueshme bujqësore. Nëpërmjet kësaj mënyre të prodhimit ndikohet në uljen e fenomenit të shpërndarjes dhe përdorimit të tepruar dhe masive të kimikateve në bujqësi, të cilat mund të kenë një ndikim negativ mbi ujin, tokën, ajrin dhe biodiversitetin.

Plasmani i produkteve bujqësore në tregjet lokale kontribuon në zhvillimin më të madh të bujqësisë dhe rrit konkurrencën e saj. Sektori hotelerik i cili është relativisht i zhvilluar në

Rajonin planor Jugperëndimor është një konsumator i rëndësishëm i produkteve bujqësore dhe prej aty del nevoja e krijimit të rrjetit mes të dy sektorëve. Me zbatimin e kësaj masë do të kontribuohet në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve bujqësore me çka në mënyrë të drejt për drejtë do të kontribuojnë në rritjen e të ardhurave në zonat rurale dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Aktivitetet treguese
- Organizimi i punëtorive për edukimin dhe promovimin e produkteve bujqësore vendore në aspektin e prodhimit organik
- Përgatitja e materialeve promovuese për produktet bujqësore tradicionale nga Rajoni
- Përgatitja e një studimi për të vlerësuar nevojën për ekzistencën e qendrës blerëse për produktet bujqësore
- Brendimi i produkteve tipike lokale bujqësore
-Mapimi i produkteve vendore, dhe plasmani i organizuar në hotelet dhe restorantet
- Projekte për të lidhur prodhuesit e produkteve bujqësore vendore me hotelerinë
- Përmirësimi i kapaciteteve prodhuese dhe zhvillimin e sistemit këshillues për bujqit

Masa 1.4.2

Krijimi i kushteve për zhvillimin rural

Në rajon ka shumë fshatra dhe vendbanime që kanë veprimtari të ngjashme ekonomike dhe shumë interesa të përbashkëta në zhvillim, por mes veti nuk kanë një infrastrukturë të mirë lidhëse. Komunikimi i tyre i çfarëdo lloji do të kontribuojë në kombinimin e potencialit të tyre për zhvillimin më të shpejtë ekonomik dhe social. Shfrytëzimi i burimeve natyrore në rajon do të kontribuojë për zhvillim më intensiv rural. Zbatimi i masës përfshin aktivitete që rrisin kapacitetin e popullatës lokale për të përdorur potencialin për bujqësi, pylltari, peshkim, gjueti dhe veprimtari të tjera tipike për rajonin. Masa do të zbatohet përmes:

• Zhvillimit të infrastrukturës rurale

• Nxitjen e veprimtarive divergjente në zonat rurale

Aktivitetet treguese

- **Formimi i GLV-se**

- **Përgatitja e bazës së të dhënave për gjendjen e rrugëve ekzistuese rurale dhe prioritetet për rekonstruktimin të të njëjtave dhe nevojën për të ndërtuar rrugë të reja**

- **Përgatitja e dokumentacionit projektues për infrastrukturën rurale**

- **Ndërtimi i rrugëve lokale**

- **Përgatitja e dokumentacionit bazik për sistemin e kanalizimeve , ujitjes dhe furnizimi me ujë**

- **Përgatitja e elaboratit për mundësit e partneriteti publiko - privat për zhvillimin dhe shfrytëzimin e shtëpive malore**

- **Organizimi i evenimenteve për veprimtari divergjente (bujqësore, artizanate etj).**

- **Promovimi i produkteve nga aktivitetet e shumëllojshme përmes materialeve promovuese**

- **Organizimi i trajnimeve për investim në bizneset e vogla në zonat rurale**

- **Promovimi i aktiviteteve të lidhura me peshkimin dhe akuakulturën**

- **Promovimi i Fondit Nacional të Krediteve Garantuese për zhvillim rural**

- **Përgatitja dhe implementimi i projekteve për turizmin rural**

- **Realizimi i projektit – Përgatitja e mapës për mbledhjen e frutave të pyllit**

- **Organizimi i trajnimeve për mbledhësit e frutave të pyllit**

- **Aktivitete promovuese në fushën e gjuetisë dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave**

Prioriteti 1.5

Zhvillimi i infrastrukturës transportuese dhe i komunikimit dhe përmirësimi i hapësirave

Rezultate dalëse	Treguesit
Gjatësi e rrugëve A dhe rajonale të rekonstruktuara Gjatësia e rrugëve A dhe rajonale të ndërtuar Numri i dokumentacioneve teknike të përgatitura Gjatësia e rrugëve lokale të rekonstruktuara; Numri i trajnimeve; Numri i stafit TIK në komuna; Numri i projekteve për e-shërbime; Numri i aplikacioneve të përgatitura; Numri i evenimenteve promovuese;	Trafiku mesatar ditor në rrugët A dhe rajonale Numri i udhëtarëve në komunikacionin rrugor; Numri i pasagjerëve në trafikun hekurudhore; Transporti i mallrave në transport hekurudhor Numri i aplikacioneve të realizuara; Numri i e-shërbimeve të reja të cilat i ofron komuna; Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve

	elektronike;

Realizimi i këtij prioriteti përfshin këto hapat themelore si në vijim:

Masa 1.5.1

Ndërtimi, rekonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Rrjeti rrugor në rajonin planor Jugperëndimor është relativisht mirë i zhvilluar. Cilësia e këtij rrjeti është shume larg prej nivelit të dëshiruar. Edhe pse ekziston një lidhje e mirë me qendrat e komunave, por në disa rrugë të caktuara qarkullimi është mjaft i ngadaltë për shkak të karakteristikave të tyre teknike, si dhe për shkak të cilësisë të dobët të rrjetit të rrugëve në disa rrugë.

Një pjesë e rrjetit rrugor rajonal nuk është përfunduar, gjegjësisht ekzistojnë rrugë rajonale të cilat nuk janë ndërtuar. Me përjashtim të qytetit të Dibrës, qasja e të gjithë rajonit deri tek rrugët kryesore magjistrale në vend është e mirë. Aktualisht po bëhen investime të rëndësishme në infrastrukturën transportuese të cilat do të kontribuojnë në sigurimin e infrastrukturës moderne rrugore. Cilësia e rrjetit të rrugëve lokale është e ulët dhe në rajon ka disa vendbanime të vogla rurale ku rrugët lokale nuk janë të asfaltuara. Zbatimi i masës do të kontribuoj kah përmirësimi i cilësisë së rrjetit rrugor dhe do të përmirësoj edhe kushtet për zhvillimin e qarkullimit. Zbatimi i këtij prioriteti do të mundësojë përmirësimin e kualitetit në rrjetit rrugor rajon. Kjo masë do të fokusohet në:

- Rrejt rrugor A dhe rrjet të rrugëve rajonale
- Rrugë lokale
- Lidhshmëri mes vendbanimeve rurale
- Sinjalizim rrugor - vertikale dhe horizontale
- Ndërtimi i rrugëve deri në vendet atraktive turistike
- Rritja e sigurisë në komunikacion

Aktivitetet treguese
Ndërtimi i “A2” Kërçovë –Ohër dhe Trebenishtë – Strugë dhe “A3” Ohër - Peshtanë
Modernizimi i rrugëve rajonale ekzistuese “P1202 lidhje me A4 (Novo Sellë) – Mavrovë – Zhirovnicë-Dibër,
Ndërtimi i rrugëve të reja rajonale : P 2246 Ura e Garit – Izvor, Kërçovë
Rekonstruktimi i rrjetit rrugor lokal
Lidhja e vendbanimeve rurale me rrjetin rrugor lokale : f. Plasnicë – f. Preglovo, f. Plasnicë – f. Dvorci – f. Lisiçani dhe f. Vevçan – f. Podgorcë
Vendosja e sinjalistikës rrugore
Rritja e sigurisë para institucioneve arsimore
Projektimi i rrugëve për biçikleta dhe këmbësor
Ndërtim i rrugëve pyjore në funksion të zhvillimit të turizmit
Vendosja e sistemit për mirëmbajtjen e rrugëve lokale / rurale në periudhën e dimrit dhe verës
Sigurimi i makinerisë për pastrimin e borës në të gjithë vendbanimet me lartësi mbidetare mbi 700 m
Revidimi i metodologjisë aktuale për mirëmbajtën e rrugëve lokale
Zhvillimi i sistemit për financimin e zhvillimit urban në vendbanimet rurale në nivel të strukturës urbane të qytetit

Masa 1.5.2

Aplikimi i teknologjisë informatike – komunikuese

Sot nuk është e mundur që të realizohet zhvillimi i qëndrueshëm i një rajoni pa përdorimin intensiv të teknologjisë informatike –komunikuese, shkalla e shfrytëzimi të këtyre teknologjive nuk është në nivelin e dëshiruar. Në rajonin planor Jugperëndimor, si dhe pothuajse në të gjithë rajonet një nga arsyet është njohurit e dobëta për teknologjinë informatike – komunikuese. Zbatimi i kësaj mase do të kontribuoj kah informimi më i mirë për përfitimet që i sjell shfrytëzimi i TIK dhe e njëjtat do të jetë e orientuar kah:

- Fuqizimi i kapaciteteve të resurseve njerëzore për përdorimin e TIK
- Përforcimi me kapacitete tekniko–teknologjik në TIK

Aktivitetet treguese

Mbajtja e trajnime të vazhdueshme falas për përdorimin e TIK në nivelin e strukturave rurale
Krijimi i zonave WiFi
Pika për shërbime informatike falas
Organizimi i trajnimit - "Zëvendësimi i informaticientit në mjedisin rural"

Qëllimi afatmesëm 2

Arsim i përshtatur për nevojat e zhvillimit ekonomik, mbrojtja sociale dhe shëndetësore, për popullsinë në rajon dhe krijimi i kushteve për parandalimin e migracionit

Arsimi i cili është i përshtatur për nevojat e zhvillimit ekonomik dhe të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, si dhe për nevojat e popullsisë është i një rëndësie të madhe për një rajon që përballet me stagnim ekonomik dhe proces të migracionit që është i nivelit më të lartë në shtet. Ky qëllim afatmesëm i kushtohet zvogëlimit të migracionit përmes krijimit të kushteve për mbajtjen e kuadrit profesional i cili duhet të jetë bartës i zhvillimit. Ky kuadër duhet të jetë i përgatitur për t'u angazhuar në procesin e prodhimit, si dhe i aftë për të marrë iniciativa për të rritur dhe zhvilluar biznesin e tyre. Një zhvillim i tillë është i mundur vetëm me përfshirjen e gjithë popullsisë, duke përfshirë edhe gratë që në këtë rajon paraqitet në një përqindje të ulët në tregun e punës, si për shkaqe tradicionale dhe kulturore, por edhe për shkak të kuadrove jo të arsimuara personelit të pamjaftueshëm të trajnuar si dhe mungesa e kushteve adekuate për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve në familje.

Nr. Ren.	Treguesit	Treguesi viti bazë	Treguesi 2019
1	Pjesëmarrja e rajonit në numrin e përgjithshëm të popullsisë në shtet	10,66%	10,80%
2.	Shkalla e papunësisë	36,7%	27%
3.	Shkalla e papunësisë tek gratë	40,5%	30 %
4.	Fëmijë të moshës nga 0 deri në 5 vjet në çerdhet e fëmijëve (%)	12.9%	22%
5.	Amvisëri – shfrytëzues të ndihmës sociale në 000 banorë	17.8	21.1
6.	Nxënës në shkollat e mesme	9 319	9400
7.	Numri i studentëve të diplomuar	844	1000

Prioritetet për realizimin e këtij qëllimi afatmesëm janë:

Prioriteti 2.1

Arsim cilësor, i përshtatur për nevojat e biznesit, strukturimi i arsimit të mesëm, sipas kërkesave të tregut të punës.

Rezultatet dalëse	Treguesit
Numri i programeve arsimore të përshtatura me biznesin Numri i shkollave të pajisura me laboratorë dhe punëtori për trajnim praktik Numri i arsimtarëve/profesorëve me kualifikime të duhura; Numri i takimeve me biznes sektorin gjatë përgatitjes së programeve arsimore; Numri i marrëveshjeve të nënshkruara për bashkëpunim të institucioneve arsimore me biznes sektorin Numri i bizneseve të reja të hapura për prodhimtari dhe shërbime Numri i bursave, bursa nga sektori privat	Programe arsimore të përshtatura me nevojat e tregut të punës Numri i objekteve arsimore të pajisura me laboratorë dhe pajisje për realizimin e mësimit praktik të nevojshëm për biznesin. Numri i kuadrove kualitativ dhe profesional që punojnë në shkollat rurale. Pjesëmarrja e biznes sektorit në përgatitje e programeve arsimore. Numri i biznesmenëve të interesuar për lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunim me institucionet arsimore të mesme/ të larta Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të interesuara për punësimin e kuadrove profesionale. Rritja e interesit për hapjen e bizneseve private të bazuara në prodhimtari dhe shërbime

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin masat në vijim:

Masa 2.1.1

Promovimi i përparësive të arsimit të mesëm/lartë profesional;

Rajoni Jugperëndimor është i veçantë nga ajo se ka pak degë të ekonomisë, të cilat në disa komuna janë më të theksuara, ndërsa në komunat tjera janë krejtësisht të ndryshme nevojat për kuadrin profesional. Kështu, komunat e Ohrit dhe Strugës kryesisht janë komuna turistike, Kërçova është një qytet minierash, ndërsa Dibra posedon ujëra termale të cilat mund të zhvillojnë lloje të ndryshme të turizmit. Komunat më të vogla rurale kanë mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla familjare që janë të lidhura me blegtorinë, pemëtarinë, por dhe aktivitete të tjera artizanale që do t'i përshtaten burimeve natyrore që ata zotërojnë. Nga kjo, është e nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për profesionalizimin si një përparësi krahasuese në një ekonomi të hapur, që siguron të ardhura dhe që ka një mundësi më të mirë të punësimit. Masa duhet të drejtohet drejt:

- Njohja e të rinjve me përparësitë që jep arsimi profesional për hapjen e biznesit privat,
- Njohja me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë në botë përshtatja e njohurive me teknologjitë e reja,
- Promovimi i përparësive në gjetjen e punës,
- Çmimi i profesionalizmit në tregun e punës,

Aktivitete treguese
Organizimi i kampanjave publike për përparësitë e përgatitjes profesionale;
Prezantimi i teknologjive të reja ku fuqia punëtore fizike zëvendësohet me aparatura të mençura, për përdorimin e të cilave është e nevojshme profesionalizmi;
Prezantimi i shembujve të suksesshëm të biznesmenëve që kanë fituar pasuri përmes punës profesionale;
Organizimi i vizitave në panaire të teknikës dhe teknologjisë në vend dhe jashtë ku mund të shihen përparësitë e kuadrove arsimore profesionale;
Vizita në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ku përgatitja profesionale ka qenë vendimtare për suksesin
Organizimi i ligjëratave dhe demonstrimi i përparësive para nxënësve para se të përcaktohen për transformim,
Prezantimi i shembujve të suksesshëm të bizneseve në mjediset e vogla dhe rurale të bazuara në veprimtari profesionale dhe artizanale;
Numri i nxënësve dhe studentëve të cilët janë mbështetur nga subjektet ekonomike gjatë shkollimit,

Masa 2.1.2

Krijimi i kushteve për hapjen e paraleleve për arsim profesional dhe institucioneve të arsimit të lartë në pajtim me nevojat e tregut të punës në të gjithë rajonin

Rajoni Jugperëndimor dallohet nga ajo se ka tre veprimtari të ndryshme ekonomike që mund të jenë faktor kryesor i zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të varfërisë, dhe migracionit. Të gjithë këta faktorë janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me rajonet dhe komunat e caktuara. Duke marrë parasysh këto karakteristikat e pjesëve të caktuara të rajonit është e domosdoshme që rrjeti arsimor dhe lloji i arsimit të zhvillohen në bazë të karakteristikave të rajonit. Realizimi i kësaj mase do të realizohet përmes:

- Analiza e nevojave të ekonomisë dhe tregut të punës,

- Krijimi i para kushteve për zhvillimin e mësimit në pajtim me nevojat e profileve përkatëse,

- Zhvillimi dhe kultivimi i kuadrit të kualifikuar për çdo lloj të arsimit dhe mbajtjen e kuadrit ekzistues në rajon dhe në zonat rurale.

Aktivitetet treguese
Analiza e nevojave të tregut të punës dhe ekonomisë për profilin e kuadrit që mungon,
Strategjia për zhvillimin e arsimit në nivel të rajonit në pajtim me planet zhvillimore, përmes ndërtimit të shkollave të reja rekonstruksionin e ekzistuesve ose përshtatjen e objekteve publike që plotësojnë kushtet për zhvillimin e sistemit arsimor në të gjitha nivelet,
Zhvillimi i PPP për fusha të caktuara të arsimit ku ka interes në të gjitha nivelet e arsimit,
Regjistrimi i kuadrit profesional ekzistues që plotëson nevojat e arsimit në rajon dhe alternativat e mundshme për të kompensuar kuadrot që mungojnë,
Zhvillimi i një strategjie dhe plani për mbajtjen e kuadrit profesional përmes mbështetjes me mjete financiare, zhvillim në karrierë, shpërblime dhe marrja e bonuseve për progresin në shërbim dhe në karrierë,
Zhvillimi i instrumenteve për shpërblim, për nderim dhe garantim të arsimit dhe punës për fëmijët e tyre apo të familjes së ngushtë

Masa 2.1.3

Promovimi i biznesmenëve të suksesshëm të cilët kanë mbaruar arsim të mesëm profesional ose fakultet.

Mënyra më e mirë për të rritur interesin për arsim dhe punë në një fushë të caktuar është prezantimi dhe promovimi i shembujve të suksesshëm. Kjo mund të kontribuojë në uljen e interesit tek të rinjtë për ta lënë rajonin dhe zhvillimin e biznesit të tyre, dhe me atë zvogëlimin e papunësisë dhe rritjen e standardit të jetesës. Në botë ka një numër të madh shembujsh ku përmes promovimit të suksesshëm të njerëzve të suksesshëm, të rinjtë stimulohen për të zhvilluar kreativitet dhe ide për zhvillimin e biznesit me iniciativën e tyre. Masa duhet të përfshijë:

• Promovimi i individëve të suksesshëm dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga vendi dhe jashtë, veçanërisht në mjediset e vogla rurale,

• Të ndihmojë dhe të mbështesë idetë e të rinjve nga mosha e hershme dhe gjatë gjithë procesit të edukimit.

Aktivitetet treguese
Numri i ngjarjeve ku promovohen biznesmenët e suksesshëm,
Numri i sipërmarrësve të suksesshëm nga vendi dhe jashtë vendit që kanë prezantuar dhe kanë mbajt ligjërata,
Numri i individëve të shpërblyer dhe të mbështetur, dhe ndërmarrje të shpërblyera për sukses,
Numri i mësuesve dhe profesorëve të suksesshëm dhe të shpërblyer që janë shpërblyer për kontributin në zhvillimin e kreativitetit dhe shpirtit sipërmarrës në mesin e nxënësve dhe studentëve,
Numri i shkollave dhe fakulteteve të cilët janë shpërblyer për punë të suksesshme në zhvillimin e arsimit në nivel rajonal,
Numri i iniciativave të mbështetura, dhe pjesëmarrja në konkurse brenda dhe jashtë vendit për nxënësit dhe studentët e rinj,
Numri i bursave të dhëna dhe mbështetje të tjera të dhëna në arsim për nxënësit dhe studentët që do të mbesin në rajon,
Numri i vizitave të organizuara në panaire, konferenca dhe trajnime tjera në vend dhe jashtë vendit për biznesmenët e suksesshëm të rinj.

Prioriteti 2.2

Parandalimi i largimit të kuadrit profesional nga veprimtaritë terciare duke promovuar barazi më të madhe gjinore dhe mundësi për kyçje në tregun e punës të qytetarëve nga grupet e rrezikuara.

Një nga problemet më të mëdha në rajonin planor Jugperëndimor është migrimi, qoftë si largim i popullsisë jashtë shtetit, qoftë si zhvendosja e brendshme. Sot është dominues

fenomeni i emigrimi të popullsisë, dhe me atë edhe emigrimi kuadrove profesionale dhe të arsimuara. Ky fenomen ka pasoja që prekin disa fusha. Kryesisht, shpërngulja e këtyre kuadrove është në të vërtetë humbje e madhe financiare të investuara në edukimin e tyre, së dyti reduktimi i potencialit zhvillues të Rajonit duke marrë parasysh se forca kryesore e zhvillimit është njohuria dhe profesionalizmi, dhe e treta, depopulimi i Rajonit, përkatësisht shfrytëzimi jo i mirë i potencialeve të shtetit. Me qëllim të reduktimit të këtij fenomeni negativ, është e nevojshme të merren masa, që së pari do të kontribuojnë të parandalojnë këtë prirje, dhe më vonë edhe në krijimin e kushteve për rikthimin e të shpërngulurve nga Rajoni. Masa duhet të orientohet kryesisht tek:

- Krijimi i kushteve për të mbajtur kuadrin ekzistues në Rajon,

- Afirmimi për përparësitë e jetesës në komunitete të vogla,

- Krijimi i kushteve për përfshirje më të madhe të grave në tregun e punës,

- Krijimi i kushteve për kthimin e të shpërngulurve.

Rezultatet e arritura	Treguesit
Numri i bizneseve të hapura nga të rinjtë,	**Numri i përgjithshëm i qytetarëve të imigruar dhe emigruar të Republikës së Maqedonisë në rajonin planor Jugperëndimore**
Numri i projekteve të cilat përmirësojnë jetën kulturore dhe sportive në zonat rurale dhe vendbanimet e vogla,	**Numri i qytetarëve të zhvendosur sipas nivelit arsimor në komunat që janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimore**
Numri i projekteve që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetës dhe punës në komunat me karakteristika emigruese dhe zonat rurale,	**Numri i qytetarëve të emigruar sipas nivelit arsimor në komunat që janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimor**
Numri i aktiviteteve promovuese në zonat e vogla rurale,	**Numri i qytetarëve të zhvendosur sipas aktiviteteve në komunat që janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimor**
Numri i projekteve për të mbështetur prodhimin në zonat rurale nëpërmjet krijimit të komunikimit të lehtë me qendrat e zhvillimit,	**Numri i qytetarëve të emigruar sipas aktivitetit në komunat që janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimor**
Numri i projekteve për mbështetjen e aktiviteteve që do të pasurojnë jetën sportive rekreative dhe jetën kulturore në zonat rurale dhe më të vogla,	**Qytetarët e emigruar-zhvendosur dhe bilanci i migrimit sipas gjinisë në komuna që janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimore**
Numri i projekteve për të mbështetur krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe shoqatave bujqësore.	**Shkalla e papunësisë**
Numri i projekteve për të mbështetur të kthyerit nga jashtë vendit dhe promovimi i tyre.	**Përqindja e popullsisë femërore në tregun e punës**
Numri i infrastrukturës sociale të ndërtuar për të mbështetur fëmijët dhe të moshuarit në zonat rurale dhe të vogla,	**Përqindja e grave të punësuara**
Numri i projekteve për të krijuar kushtet për përfshirjen e grave dhe njerëzve të kategorive të rrezikuara në tregun e punës	**Numri i personave nga grupet e rrezikuara të cilët janë të përfshirë në tregun e punës**

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin masat në vijim:

Masa 2.2.1

Promovimi dhe mbështetja e iniciativave për të krijuar kushte më të mira pune dhe përparim në komunitetet e vogla dhe rurale

Reduktimi ose plotësisht ndalimi i migrimit dhe mbajtja e "ikjes së trurit" nuk mund të paramendohet pa krijimin e kushteve për ata që janë të interesuar të qëndrojnë dhe jetojnë në mjedise të tilla. Nuk është e mjaftueshme për t'u lidhur me vendlindjen dhe patriotizmin, qoftë lokal apo shtetëror. Një njeri racional dhe modern në epokën e komunikimit dhe të globalizimit, në radhë të parë e vendon, jetesën e mirë, sigurinë e tij dhe familjes, si dhe mundësinë për të gëzuar përfitimet e një jete cilësore. Për të arritur rezultate në drejtim të reduktimit të migrimit, së pari duhet që masat të synojnë rritjen e interesit të individit për të qëndruar. Për këtë qëllim janë të nevojshëm aktivitete konkrete. Zbatimi i kësaj mase do të ketë për synim:

• Promovimi i avantazheve për të qëndruar dhe jetuar në vendin e vet,

• Promovimi i avantazheve për të jetuar dhe punuar në Rajonin e vet dhe në zonat e vogla rurale,

• Përmirësimi i perspektivave për zhvillim për vete dhe familjen,

• Rritja e sigurisë, tani dhe në të ardhmen

Aktivitetet treguese
Përgatitja e fushatave publike për të promovuar përparësitë e punës dhe perspektivës në zonat e vogla dhe rurale në Rajon,
Promovimi i avantazheve krahasuese të mjedisit tuaj,
Mbështetje për iniciativat individuale për zhvillimin e biznesit në mjedisin e tij,
Sigurimi i kushteve për arsim cilësor dhe arsim gjatë gjithë jetës,
Krijimi i kushteve për zhvillimin në karrierë,
Zhvillimi i infrastruktures, lidhje me qendrat e zhvillimit,
Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme dhe ri kualifikimi,
Njoftimi me përvoja tjera dhe shembuj të mire të individëve të suksesshëm që kanë punuar dhe vepruar në mjedise të ngjashme,
Vizita e panaireve dhe organizimi i trajnimeve me ekspertë nga brenda dhe jashtë vendit,
Informimi i vazhdueshëm për arritjen në fushat të cilat janë të zhvilluara në Rajon.

Masa 2.2.2

Përfshirja e kuadrit lokal të arsimuar dhe profesional në planifikimin dhe krijimin e perspektivave të zhvillimit në Rajonin dhe mjedisin e tyre

Secila strategji dhe plan zhvillimi i përgatitur në një rreth të mbyllur prej ekspertëve pa konsultim me ata të cilëve u kushtohet dokumenti është vështirë i realizueshëm. Prandaj, është e nevojshme në procesin e krijimit dhe miratimit të atyre dokumenteve të përfshihen banorët lokal dhe palët e interesuara. Nëpërmjet këtij procesi do të arrihen disa efekte. Së pari, informim më i mirë për banorët dhe kuadrit profesional për perspektivat dhe planet zhvillimore. Një ndjenjë pronësie në mesin e qytetarëve për dokumentin, por edhe një ndjenjë e përgjegjësisë në zbatimin e tij. Praktika tregon se rruga më e mirë në të cilën duhet të shkohet është rruga që qytetarët e hapin vet , dhe jo ai që hapet nga buldozerë, ose ajo që planifikohet në ndonjë zyrë. Domethënë, buldozerët duhet vetëm ta zgjerojnë dhe rregullojnë atë rrugë. Prandaj masa duhet të orientohet drejt krjimit të:

• Ndjenjë të krijimit të fatit personal,

• Ndjenjë se zgjidhja është këtu midis nesh, dhe jo shumë larg prej nesh,

• Një ndjenjë pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë.

Aktivitetet treguese
Paraqitjet publike dhe debate gjatë krijimit të planeve dhe programeve zhvillimore
Organizimi i debateve mbi dokumentat,
Promovimi i dokumenteve të shpërndara në të gjithë popullsinë,
Perceptimi i matur i adaptimit nga qytetarët,
Numri i sugjerimeve dhe komenteve të pranuara mbi dokumentat,
Numri i qytetarëve që kanë kërkuar informata shtesë mbi dokumentat,
Numri i aktiviteteve të ndërmarra në përputhje me programin nga ana e qytetarëve,
Numri i veprimtarive në kundërshtim me dokumentet e projektuara,
Numri i dokumenteve dhe vendimeve të përbashkëta të marra në lidhje me zhvillimin e Rajonit, komunave dhe vendbanimeve,
Numri i aktiviteteve të realizuara të parashikuara me dokumentin në zonat rurale

Masa 2.2.3

Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për t'u kyçur në tregun e punës e gruas dhe grupeve nga kategoritë e rrezikuara

Rajoni planor Jugperëndimor ka një karakteristikë që e bën atë më specifik sesa rajonet e tjera. Shumë i madh është dallimi i të paraqiturve në tregun e punës, si dhe të punësuarve në raport me popullatën e gjinisë femërore. Arsyet për këtë janë të shumta dhe fillojnë me mos informimin, kushtet joadekuate të jetesës dhe të punës e madje për arsye kulturore, tradicionale dhe fetare. Këta të fundit sipas të dhënave kanë ndikim të madh. Kjo nga ana tjetër, (për shkak të pamundësisë që me një të punësuar në familje të përmbushen nevojat bazë të jetës) kontribuon në shkallën e lartë të migracionit, qoftë individuale qoftë kolektive si familje. Standardi i ulët, dhe nga ana tjetër, familje e ndarë ose jo e kompletuar prodhon një tjetër zinxhir të problemeve sociale dhe familjare. Për të parandaluar procesin e migracionit, ndarje e familjeve dhe largimi i kuadrove, është e nevojshme përfshirja më të madhe e grave në proceset e prodhimit. Kjo masë duhet të përfshijë edhe kategoritë e tjera të rrezikuara, të cilat janë jashtë procesit të prodhimit dhe të veprimtarive shërbyese. Me këtë masë do të kontribuohet në përfshirjen më të madhe të kategorive të rrezikuara në ekonomi, e cila do të kontribuojë në rritjen e të ardhurave në familje. Masa duhet të realizohet përmes aktiviteteve të fokusuara në:

• Përforcimi i ndërgjegjes për nevojën e përfshirjes në procesin e punës të grave dhe personave të tjerë nga kategoritë e rrezikuara,

• Krijimi i kushteve për përfshirje të tillë,

• Promovimi i rasteve të suksesshme,

• Mbështetje për nismat individuale ose në grup, dhe

• Transferimi i njohurive dhe përdorimi i shembujve të suksesshme nga vend dhe jashtë vendit.

Aktivitetet treguese
Fushata për rritjen e ndërgjegjes për barazi gjinore gjatë punësimit
Promovimi i parimeve të barazisë gjinore
Projektet për të mbështetur iniciativa individuale dhe grupore për hapjen e vendeve të punës për gratë dhe kategoritë e tjera të rrezikuara

Ngjarje për të promovuar shembuj të suksesshëm, **Organizimi i vizitave në panaire dhe ekspozita ku promovohet puna në ambiente shtëpiake** **Fushata për ngritjen e vetëdijes për nevojën e përfshirjes sociale të njerëzve nga grupet e rrezikuara** **Krijimi i kategorive nga personat në marrëdhënie pune në veprimtari të përshtatshme për ta,** **Fushata për reduktimin e paragjykimeve dhe traditave për të cilat nuk ka vend në botën moderne.**

Prioriteti 2.3

Përmirësimi i përfshirjes së familjeve me nevoja për programe sociale, mbulimin më të madh të fëmijëve parashkollor nga zonat rurale në kopshte, si dhe përshtatja e programeve për mbrojtjen e të moshuarve

Mbrojtja sociale është e plotë vetëm nëse ajo mbulon të gjitha kategoritë. Ajo është gjithëpërfshirëse dhe fillon me kujdesin social për familjet, fëmijët dhe përfshirja e tyre parashkollore, veçanërisht në zonat rurale, dhe deri te mbrojtja e pleqve dhe personave të pafuqishëm. Në rajonin planor Jugperëndimor ekziston një pabarazi e madhe ndërmjet zonave rurale dhe urbane në lidhje me përfshirjen e fëmijëve të moshave parashkollore nëpër kopshte, por edhe në vetë Rajonin si tërësi dhe mesatares shtetërore. Situata nuk është më e mirë as në mbrojtjen e njerëzve të moshuar dhe të pafuqishëm. Masa duhet të përfshijë të paktën tre aspekte dhe atë:

• Mbrojtja e familjeve dhe fëmijëve që janë në nevojë,

• Përfshirja e fëmijëve të moshave parashkollore në kopshte veçanërisht në zonat rurale dhe,

• Mbrojtje e të moshuarve në pajtim me strategjinë shtetërore për atë.

Rezultatet e arritura	Treguesit
Numri i objekteve të ndërtuara dhe përshtatura për kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore **Numri i objekteve dhe institucioneve të kujdesit për të moshuarit sipas karakteristikave demografike të Rajonit** **Numri i objekteve të ndërtuara ose të**	**Numri i familjeve me ndihmë sociale** **Numri i personave me ndihmë sociale** **Përqindja e përfshirjes së fëmijëve të moshave parashkollore me mbrojtje fëmijërore, veçanërisht në zonat rurale dhe vendbanimet e vogla** **Numri i të moshuarve nën kujdes në bazë të**

rindërtuara të infrastrukturës sociale **Numri i fushatave dhe aktiviteteve promocionale**	**karakteristikave demografike të Rajonit**

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin këto masa:

Masa 2.3.1

Rritja e përfshirjes së familjeve dhe individëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje sociale

Rajoni planor Jugperëndimor karakterizohet nga një fenomen i jashtëzakonshëm. Nga njëra anë, kemi zvogëlim të numrit të punësuarve ose të paktën stagnim, dhe në anën tjetër kemi një numër të zvogëluar të familjeve dhe individëve që janë të mbështetur nga një lloj ndihme sociale. Asnjë parametër tjetër, siç është produkti i brendshëm bruto, investimeve për kokë banori ose rritje të produktivitetit, nuk kanë ndryshuar që të iniciojnë një ndryshim që do të kontribuojë në zvogëlimin e numrit të familjeve dhe individëve të cilët kanë nevojë për ndihmë sociale. Kjo tregon në atë se ka nevojë për rishikimin e kriteriumeve, evidentimin ose mënyrën e shpërndarjes së ndihmës sociale dhe atë përmes:

- Rishikimi i regjistrimeve të individëve dhe familjeve që marrin ndihmë sociale,
- Rishikimi i kritereve për ndarjen e ndihmës sociale,
- Shqyrtimi i dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe marrjen e ndihmës sociale për familjet dhe individët me qëllim të harmonizimit të indikatorëve për zhvillim me nevojat për dhënien e asaj ndihme.

Aktivitetet treguese
Azhurnimi i listës të familjeve dhe individëve që marrin ndihmë sociale,
Rishikimi i kritereve për dhënien e ndihmës sociale për familjet dhe individët,
Rishikimi i dokumenteve të nevojshme për marrjen e ndihmës së tillë,
Ndjekja e vazhdueshme e situatës me shfrytëzuesit e ndihmës sociale,
Korrigjimi i kritereve sipas parametrave që masin zhvillimin e një Rajoni,
Organizimi i ndihmës ligjore falas për personat që kanë nevojë,
Organizimi i ekipeve mobile për të monitoruar në vazhdimësi situatën në terren në fushën e ndihmës sociale.

Masa 2.3.2

Përmirësimi i përfshirjes së fëmijëve të moshës parashkollore në kopshte, veçanërisht në zonat rurale

Në pjesën e përfshirjes së fëmijëve të moshës parashkollore në kopshte, rajoni planor Jugperëndimor është mbas mesatares në nivel shtetëror. Ky dallim është më i madh në zonat rurale dhe vendbanimet e vogla. Me qëllim të përmirësimit të përfshirjes, janë të nevojshme më shumë aktivitete. Masa duhet të përfshijë aktivitete në pjesën e:

• Ngritja e vetëdijes publike për përparësitë e përfshirjes së fëmijëve të moshave parashkollore në kopshte, veçanërisht në zonat rurale,

• Krijimi i kushteve për përfshirje më të madhe përmes ndërtimit të objekteve dhe duke i përshtatur ekzistueset, në pajtim me karakteristikat demografike të Rajonit,

• Zhvillimi i formave alternative të pranimit dhe dorëzimit të fëmijëve nga vendbanimet rurale dhe të largëta deri te kopshtet.

Aktivitetet treguese
Organizimi i debateve, trajnime dhe lloje të tjera të informimit për përparësitë që fëmijët të moshave parashkollore të përfshihen në kopshte.
Projektet për ndërtimin, rikonstruktimin ose përshtatjen e kopshteve veçanërisht në zonat rurale dhe vendbanimet e vogla.
Krijimi i kushteve për motivimin e kuadrit profesional për punë me fëmijët nga mosha parashkollore në zona rurale dhe të vogla.
Zhvillimi i formave alternative të pranimit dhe dorëzimit të fëmijëve deri te kopshtet (ekipe mobile për fëmijët nga vendbanimet e largëta dhe të vogla).
Zhvillimi i formave alternative të kujdesit për fëmijët të moshave parashkollore, PPP.
Inicimi i ndryshimeve të vendimeve të caktuara ligjore që i kushtohen kujdesit të fëmijëve në zonat rurale dhe të vogla.
Zhvillimi i një sistemi për mbikëqyrje të vazhdueshme zhvillimit të fëmijëve dhe informimi në kohë i prindërve për gjendjen e fëmijëve të cilët mbikëqyren.
Vlerësimi i kënaqësisë së prindërve nga shërbimet që i ofrojnë shtëpitë e përkujdesit të fëmijëve të moshave parashkollore.

Masa 2.3.3

Përshtatja e programeve për mbrojtjen e personave të moshuar në Rajon dhe zhvillimi i rrjetit të mbrojtjes shëndetësore në pajtim me karakteristikat demografike të Rajonit.

Në rajonin planor Jugperëndimor pothuajse nuk ekziston rrjet i shtëpive për përkujdesje të personave të moshuar sipas karakteristikave demografike. Këto shtëpi kryesisht janë të lokalizuara në qendrat urbane, çka tregon neglizhencën e nevojave të personave të moshuar në zonat rurale dhe atyre që jetojnë në zonat e largëta. Për të siguruar kujdes për të gjithë sipas nevojave, ndërsa qytetarët të marrin shërbime të duhura me të njëjtën kosto, janë të nevojshme disa aktivitete. Masa duhet së pari të sigurojë:

• Përshtatja e programeve për mbrojtje të personave të moshuar me Strategjinë e Republikës së Maqedonisë,

• Riorganizimi i qendrave sipas karakteristikave demografike të rajonit,

• Zhvillimi i një rrjeti të mbrojtjes shëndetësore, sipas nevojave dhe karakteristikave demografike të rajonit,

• Krijimi i kushteve për kujdes shëndetësor dhe social në kushte shtëpie,

• Krijimi i kushteve për zhvillim të PPP për kujdesjen e të moshuarve në Rajon.

Aktivitetet treguese
Krijimi i planeve aksionare në pajtim me strategjinë për kujdesin e personave të moshuar në R. Maqedonisë.
Riorganizimi i rrjetit ekzistues sipas karakteristikave demografike të Rajonit
Ndërtimi i objekteve të reja, rinovimin apo përshtatja e atyre ekzistuese për kujdesin e të moshuarve,
Zhvillimi i zgjidhjeve alternative, ekipet mobile, vizita në shtëpi, etj,
Mbështetje për OJQ-të që merren me këtë çështje,
Nxitja e PPP-ve në qytete dhe vende të tjera që kanë interes për kujdesin e personave të moshuar,
Zhvillimi i qendrave për pranimin e të pastrehëve,
Sigurimi i vizitave shtëpiake të personelit mjekësor dhe punëtorët shëndetësor,
Promovimi i projekteve për përfshirjen e personave të moshuar,
Promovimi dhe mbështetja e iniciativave për përkujdesje familjare të personave të moshuar,
Organizimi i garave kolektive argëtuese dhe sportive,
Projekte për zhvillimin e mbrojtjes shëndetësore nga shëndetësia primare, maternitet dhe ordinancave stomatologjike në pajtim me karakteristikat demografike dhe nevojat e Rajonit,
Zhvillimi i ekipeve të urgjencës në qendrat shëndetësore në zonat e vogla dhe rurale.

Qëllimi afatmesëm 3

Zhvillimi i turizmit i ndërlidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore në rajonin planor Jugperëndimor e mbulon pjesën e largët jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë. Sipas vlerësimeve për vitin 2013, në të jetojnë 10,7% nga numri i përgjithshëm i

popullsisë në Republikën e Maqedonisë. Ky rajon shtrihet në 13,4% të sipërfaqes së përgjithshme të shtetit, me një dendësi të popullsisë prej 66,0 banorë për km2.

Trendet e turizmit paraqesin ndryshime në tërësitë e ndryshme planore rajonale. Në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor, i cili paraqet rajonin më të zhvilluar turistik në territorin e Republikës së Maqedonisë me zhvillimin turistik dhe atë pothuajse në të gjitha parametrat në të cilat ajo është e përcaktuar, trendet turistike mund të përcaktohen përmes përcaktimit të numrit të turistëve, numrit mesatar të bujtjeve të realizuara, konsumit mesatar ditor (pansional dhe jopansionale) dhe numrit të njësive akomoduese që disponon Rajoni.

Nr.ren.	Treguesit	Treguesi viti bazë	Treguesi 2019
1	Numri i përgjithshëm i turistëve në Rajon	264.826	280.000
2.	Numri mesatar i bujtjeve të realizuara në Rajon	4,35	5,35
3.	Harxhimet ditore në total (viti bazë 2011) në USD	27,04 $	40$
4.	Numri i shtretërve	41.411	42.000

Në periudhën e ardhshme pritet të rritet numri i përgjithshëm i turistëve për rreth 5% në krahasim me vitin bazë, që do të thotë se shifra e përgjithshme do të jetë rreth 280.000. Ky vlerësim është bërë në bazë të numrit të rritur të vendeve të subvencionuara, si dhe rritjes së destinacioneve me fluturime me kosto të ulët. Rritja e numrit duhet të jetë rezultat i realizimit të qëllimit afatmesëm dhe prioriteteve të përcaktuara.

Rritja e vlerësuar e treguesit të dytë është bazuar në subvencionet e paraqitura për qëndrime më të gjata të turistëve nga vendet fqinje, me çka do të rritet numri i tyre, por edhe do të rrisë kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre. Ky vlerësim supozohet se numri i turistëve vendas të cilët vijnë për pushime nuk do të ulet në mënyrë drastike. Nga këtu, vlerësimi është se qëndrimi do të rritet me 1 ditë dhe gjithsej do të jetë 5,35.

Presim rritje të ndjeshme të konsumit ditor bazuar në fluksin e shtuar të turistëve të huaj nga vendet fqinje, si dhe rritjen e numrit të ditëve që do të shpenzonin në rajonin planor Jugperëndimor. Tek kjo duhet të ndërlidhet oferta e larmishme e projektuar të shërbimeve jopansionale të karakterit të ndryshëm të paraparë me masat dhe projektet.

Në raport me rritjen dinamike të kapaciteteve akomoduese në RPJP mendojmë se kjo do të jetë me koeficient të qëndrueshëm, supozojmë se nuk do të ketë rritje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm. Këto rezultate i bazojmë tek perceptimi i zvogëlimit të padukshëm të njësive akomoduese në raport me periudhën pesë vjeçare të kaluar me çka numri në vitin 2019 do të kthehet në kuantumin e kapaciteteve akomoduese nga viti 2009. Kjo rritje në krahasim me vitin bazë 2013 është si arsye e investimeve të lajmëruara në objektet e reja hoteliere.

Prioritetet për realizimin e këtij qëllimi afatmesëm janë:

Prioriteti 3.1

Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i gjendjes së atraksioneve natyrore dhe kulturore për qëllime turistike

Rezultatet e arritura	Treguesit
Numri i planeve urbanistike- arkitekturore ë miratuara **Numri i rrugëve me vlera natyrore dhe kulturore turistike të përfshira** **Numri i atraksioneve të transportit të rindërtuara dhe revitalizuara** **Numri i kalave të vjetra të revitalizuara dhe të përshtatura në zonat rurale** **Rrugët e rindërtuara dhe të asfaltuara** **Numri i linjave të reja të trafikut që lidhin dy ose më shumë destinacione turistike në rajon** **Numri i info qendrave të ndërtuara dhe info pikave** **Numri i etno muzeve të hapura** **Shtëpitë malore të ndërtuara dhe të rikonstruktuara** **Kampet e ndërtuara dhe revitalizuara** **Numri i hosteleve në Rajon**	Numri dhe kohëzgjatja e shtigjeve në zonat rurale që përfshijnë vlera natyrore dhe kulturore turistike në km Atraksione transportuese të pajisura dhe të rregulluara për turistët Etno muze të vendosura në funksion Shtëpitë malore të vendosura në funksion Shuma e fondeve investuese në infrastrukturën e rinovuar

Realizimi i këtij prioritetit i përfshin masat në vijim:

Masa 3.1.1

Përgatitja e dokumentacionit urbanistiko-planor

Për të siguruar kushtet për zhvillimin e turizmit së pari duhet të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemit me dokumentacionin planor-urbanistik për atraksionet turistike në rajon. Masa do të realizohet nëpërmjet:

• Përgatitja e elaborateve në përputhje me rregullat ligjore

• Ekzekutimi i kategorizimit të duhur të objekteve turistike

Aktivitetet treguese
Përgatitja e planeve urbanistike-arkitektonike, dokumente
Realizimi i kategorizimit të objekteve turistike
Përgatitja e propozimeve për rregullimin e nivelit të mbrojtjes së vlerave natyrore dhe kulturore
Përgatitja e elaborateve për kapacitetin e mjedisit rrethues të objekteve turistike
Përgatitja dhe miratimi i dokumentacionit hapësinor-planor për info-pikat dhe info qendrat
Përgatitja e zgjidhjeve arkitektonike për revitalizimin e shtëpive të vjetra në kapacitete strehimi dhe hoteliere

Masa 3.1.2

Përgatitja e rrugëve malore dhe rrjetëzimin e rrugëve malore në rajon

Rajoni posedon burime të mira për zhvillimin e aktiviteteve turistiko-malore. Duhet vetëm të shënohen dhe përcaktohen rrugët si për këmbësorë, ashtu edhe për biçiklizëm malor. Klientela turiste e huaj kërkon rrugë të standardizuara dhe cilësore për aktivitete të tilla. Masa do të realizohet nëpërmjet:

• Përgatitja e studimeve dhe mapimi i rrugëve,

• Rregullimi i infrastrukturës së rrugëve malore,

• Punimi i studimit për rrjetëzimin e rrugëve me rajonet fqinje,

• Aktivitete promovuese për aktivitetet turistike-malore

Aktivitetet treguese
Formimi i rrugëve në zonat rurale deri te aktivitetet turistike
Shënimet GIS
Studimi për rrugët malore
Rrugë për këmbësorët dhe biçikletat me infrastrukturë të rregulluar
Përpunimi i broshurave me karakteristikat e rrugëve
Përgatitja e materialeve promovuese dhe të marketingut
Organizimi i ngjarjeve promovuese
Sigurimi i tablove informuese për parametrat themelore të rrugëve

Masa 3.1.3

Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre

Në çdo destinacion turistik që të mund të vizitohen atraksionet turistike që përfaqësojnë arsyen kryesore për ardhjen e vizitorëve dhe turistëve, ato duhet të jenë të rregulluara dhe të jenë të arritshme. Kjo do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës adekuate si dhe furnizimit me pajisje për një qëndrim të këndshëm të turistëve. Masa do të realizohet nëpërmjet:

• Rekonstruktimi i rrugëve deri tek lokalitetet

• Pajisja e hapësirës me pajisje si: tavolina, tualete, vende strehuese dhe pajisje tjera

• Revitalizimi i atraksioneve të vjetra transportuese

Aktivitetet treguese
Rregullimi dhe pajisja e hapësirës për aktivitetet turistike
Revitalizimi i atraksioneve të vjetra transportuese (hekurudha e vjetër – Osllomej, rruga antike Vajtos - Via Egnatia, restaurimi i hekurudhës përmes Debarcë - Kiro)
Konservimin, restaurimin dhe revitalizimin e kështjellave të vjetra në zonat rurale (Kalaja Kitino, Koxhaxhik, Devin Kulla, Kalaja Dibër, kodra e Gabavit)
Rregullimi i burimeve ujore dhe vënien në funksion të zhvillimit të turizmit (liqene, ujëvara, burime)
Përmirësimi i mjeteve të transportit, vendosja e linjës së transportit të rregullt dhe më frekuento në kuadër të rajonit (Psh. Ohër - Vevçan)
Lidhje me rajonet fqinje, veçanërisht në zonat rurale
Ndërtimi i një rruge të re Ohër - Sh. Naum
Rindërtimi i infrastrukturës rrugore Struga- Qafë Thanë
Qasje deri te banjat e Dibrës dhe rehabilitimi i rrugës Strugë - Dibër
Përmirësimi i infrastrukturës në Vevçan – Guri i Jankos (Via Egnatia), Vevçan – Belica e Epërme, Vevçan - Shën Spase, Vishnje – Belicë e Epërme
Përmirësimi i infrastrukturës qasëse deri në Korab
Rregullimi i infrastrukturës në vendbanimet që posedojnë komplekse me arkitekturë të vjetër

Masa 3.1.4

Sigurimi i informacioneve, sinjalizimit dhe vizualizimit të atraksioneve turistike

Informacionet cilësore janë thelbësore për të siguruar numër frekuentues të vizitave në një destinacion turistik. Ajo më së miri mund të realizohet nëpërmjet ndërtimit të info pikave dhe info qendrave në rajon. Aktiviteti prioritet i info-pikave dhe info-qendrave paraqet informimin dhe promovimin e potencialeve turistike, si dhe për ofruesit individual të shërbimeve të pranishëm në rajon. Përmbajtjet informative duhet t'i kushtohen potencialeve turistike natyrore dhe kulturore, vendndodhjen e tyre, orari i punës, mënyra e arritjes, mundësitë për aktivitete plotësuese dhe përcjellëse turistike. Është mirë që në vetë lokalitetet me resurse turistike të disponojnë me informata të përgjithshme të caktuara për turistët në info-tabelat. Lëvizja e turistëve në hapësirat imponon sinjalizime të qarta dhe shumë gjuhësh nëpër destinacionet. Atraksionet turistike të karakterit natyror dhe kulturor do të kishin mbetur të panjohura nëse nuk dihet vendndodhja e tyre e saktë. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e imazhit të rajonit si një destinacion turistik si dhe cilësia e përvojës së turistëve. Kjo vlen veçanërisht për turistët individual.

Realizimi kësaj mase do të fokusohet në:

• Krijimi i një rrjeti të pikave të informimit dhe info-qendrat

• Sinjalizimi dhe sinjalistika e lokaliteteve turistike

• Mapimi dhe përcaktimi i prioriteteve të resurseve turistike

• Vizualizimi i atraksioneve më të rëndësishme

Aktivitetet treguese
Përgatitja e planit dhe zbatimit i info-pikave,qendrave në rajon
Përmirësimi i komunikimeve ekzistuese dhe ndërtimi i të rejave dhe sinjalizimi i tyre
Tabela elektronike informative në të gjithë rajonin
Integrimi i softuerëve ne info-pikat me informacione mbi atraksionet turistike në të gjithë rajonin
Zhvillimi i aplikacioneve (programe) për prezantimin e atraksioneve të rëndësishme kulturore në rajon (Teatri i lashtë, Fortesa Samuelit, Shtëpia e vëllezërve Milladinovci, kishat shpellë në rajon, ...)

Masa 3.1.5

Revitalizimi i shtëpive të vjetra dhe ndërtimin e objekteve të akomodimit në zonat rurale, objekteve hotelierike dhe objekteve tregtare të lidhura me trashëgiminë etnografike

Rajoni disponon me zona rurale të cilët kanë potenciale turistike të konsiderueshme. Megjithatë duhen aktivitete për të përshtatur shtëpitë dhe objektet në këto zona për qëndrim turistik. Atje ku ka mungesë të objekteve akomoduese mund të ndërtohen edhe të reja që do t'i respektojnë karakteristikat e mjedisit ku ato ndërtohen. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Revitalizimi i shtëpive të vjetra dhe ndërtimi i objekteve

• Revitalizimi i trashëgimisë etnografike në funksion të zhvillimit të turizmit (mullinj në tërë rajonin dhe hidroelektrana e vjetër në Vevçan)

• Promovimi i përfitimeve nga turizmi rural në mënyrë që të rrisë interesin për të investuar në zonat rurale

• Shënimi i objekteve më të përshtatshme për revitalizim dhe adaptim në objekte turistiko-hotelierike

Aktivitetet treguese
Shfrytëzimi i fondeve investuese për revitalizimin, konservimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
Revitalizimi i shtëpive të vjetra (shtëpi në Gari dhe Lazaropole) në objekte akomodimi dhe hotelieri
Revitalizimi i objekteve tregtare dhe ringjallja e zanateve të vjetra
Vënia në funksionim e mullinjve në rajon
Ripërtëritja e prodhimit tradicional të ushqimit dhe produkteve ushqimore
Fushata për të investuar në zonat rurale
Projekte të përpunuara arkitektonike për revitalizimin e objekteve të vjetra

Masa 3.1.6

Ndërtimi dhe rehabilitimi i shtëpive malore në rajon

Pasuria e jashtëzakonshme e resurseve turistiko-malore në rajon nuk korrespondon me numrin e duhur të shtëpive malore. Ata do të ishin në funksion të aktiviteteve turistike-rekreative, si dhe për qëllime edukative dhe të shpëtimit. Me atë do të përmirësohet turizmi malor në rajonin planor Jugperëndimor. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Rikonstruksioni dhe adaptim i shtëpive ekzistuese malore

• Ndërtimi i shtëpive të reja malore

• Pasurimi dhe rregullimi i vendeve të ofertës me lloje tjera të akomodimit

Aktivitetet treguese
Projektet për rindërtimin e shtëpive ekzistuese (Galiçica, Vevçani, shkollës së vjetër në Debërc)
Ndërtimi i shtëpive të reja malore (komuna e Dibrës, komuna e Strugës)
Projekte për zhvillimin e llojeve alternative të akomodimit si kampet luksoze, kampet në male, shtëpi në dru ...

Prioriteti 3.2

Forcimi i kapaciteteve për zhvillimin e turizmit me qëllim të shpërndarjes së barabartë të qarkullimit turistik në kuadër të rajonit

Rezultatet dalëse	Indikatorët
Numri i sektorëve / departamenteve të turizmit në rajon	Sektorët/departamentet në funksionim për turizëm
Numri i zyrave turistike	Zyrat turistike në funksionim
Numri i takimeve dhe mbledhjeve të organizuara të aktorëve që lidhen me turizmin	Numri i kandidatëve të trajnuar në qendrat e trajnimit dhe certifikatat e lëshuara
Numri i kontratave të lidhura në sferën e turizmit	Pjesëmarrja në përqindje e aktorëve turistik në klaster
Komitetet e themeluar në rajon	Qendrat arsimore të vënë në funksion
Qendrat e themeluar formale dhe joformale të arsimit	
Numri i punëtorive dhe trajnimeve të mbajtura	
Numri i aktiviteteve promovuese	
Numri i mbledhjeve dhe anëtarëve në klaster	
Numri i certifikatave të lëshuara për standardizimin dhe cilësinë e shërbimeve	

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin masat në vijim:

Masa 3.2.1

Krijimi i sistemit të organizimit turistik në rajon

Duke pasur parasysh se ky rajon është rajoni më i zhvilluar turistik në Republikën e Maqedonisë dhe ka nevojë për një organizim më të mirë dhe strukturë të mirë organizative, me qëllim të përcaktimit të detyrimeve dhe përgjegjësive të gjithë aktorëve. Ajo nënkupton veprim të sinkronizuar me qëllime strategjike të përcaktuara bashkërisht. Zbatimi i kësaj mase do të realizohet përmes:

• Bashkëpunimi midis sektorëve/departamenteve ZHEL

• Krijimi i një sistemi të zyrave turistike

• Forcimi i kapaciteteve në aspektin e rëndësisë së turizmit në rajon

Aktivitetet treguese
Formimi i sektorëve/departamenteve të turizmit në të gjitha komunat e rajonit
Formimi i komitetit për zhvillimin e turizmit në rajonin planor Jugperëndimor
Themelimi i zyrave turistike komunale
Rrjetëzimi i zyrave turistike në rajon
Organizimi i takimeve me aktorët e turizmit në rajon në interval ciklik

Masa 3.2.2

Organizimi i sistemit të trajnimeve për ngritjen e kompetencave të aktorëve në turizëm

Zhvillimi i turizmit në shprehje më të plotë varet nga aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e njerëzve të përfshirë në turizëm. Turizmi si aktivitet punues-intensiv nuk mund të mbijetojë nëse nuk ngrihen vetë burimet njerëzore në përputhje me trendet. Njerëzit e përfshirë në aktivitetet e turizmit nga aspekte të ndryshme duhet të kenë arsimin e lartë dhe të kenë dijeni të gjerë. Kjo masë do të mund të realizohet me:

• Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të rinj

• Zbatimi i programeve për mësim gjatë tërë jetës për të punësuarit aktual

• Transferimi i njohurive dhe marrja e përvojave nga jashtë

Aktivitetet treguese
Përforcimi i rolit të qendrave formale dhe joformale të arsimit
Trajnime për ofruesit e shërbimeve në mjediset rurale
Themelimi i trajnim-qendrave për arsimim joformal
Organizimi i udhëtimeve edukative jashtë vendit
Aplikimi i teknologjive moderne për shkëmbim të përvojave

Masa 3.2.3

Përmirësimi i punës së klasterëve dhe llojeve tjera të grupimit

Puna bashkëkohore në sektorin e turizmit kërkon që destinacionet turistike të bashkojnë forcat e të gjithë ofruesve individual të shërbimeve turistike përmes krijimit të produkteve të përbashkëta turistike. Konkurrueshmëria në tregun botëror mund të mbahet vetëm duke krijuar një markë të njohur. Kjo mund të arrihet përmes bashkëpunimit të gjithë aktorëve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë në sferën e turizmit në klasterë turistik të përbashkët. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Përforcimi i kapaciteteve të klasterëve të turizmit dhe mbështetje e punës së tyre

• Mbajtja e takimeve ciklike

• Krijimi i strukturës organizative të llojeve të ndryshme të organizatave dhe rritja e kapaciteteve të tyre

Aktivitetet treguese
Promovimi i përfitimeve nga klasterët dhe llojet e tjera të shoqatave
Organizimi i takimeve të rregullta të anëtarëve të klasterit
Promovimi i punës së klasterëve
Formimi i strukturës organizative të klasterit
Lidhja me agjencitë turistike dhe biznes sektorin
Rrjetëzimi i të gjithë palëve

Masa 3.2.4

Vendosja e një sistemi kompleks për evidencën e turistëve

Në rajonin planor Jugperëndimor tashmë ka një sistem të regjistrimit të turistëve, por si rajon më i zhvilluar turistik ka nevojë që më shumë t'i plotësojë nevojat e numrit të madh të turistëve. Për këtë qëllim është mirë të vendoset një sistem i ri më kompleks për evidencën e turistëve, ku përveç të dhënave themelore për turistët të cilat tashmë mblidhen do të dihen kërkesat e tyre, përse ata e kanë vizituar këtë rajon, kënaqësia nga vizita e tyre, a do të vijnë përsëri dhe etj. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Përcaktimi i metodologjive dhe metodave për regjistrimin e turistëve sipas bazave të ndryshme

• Mbështetja e bashkëpunimit në mes biznes sektorit, administratat komunale, ekspertë në krijimin e mjeteve dhe metodave për hulumtim

• Rrjetëzimi i institucioneve që i mbledhin të dhënat me të gjitha palët e interesuara në sferën e turizmit

Aktivitete treguese
Përpunimi dhe prezantimi i të dhënave nga sektorët/departamentet e turizmit nëpër komuna
Futja e një sistemi kompleks për evidencën e turistëve (anketa në të gjitha kapacitetet akomoduese ku do të ketë pyetje të tilla si: Pse? Si? Çfarë? Ku? Sa?)
Nxitja e sistemit elektronik për evidentimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në turizëm
Iniciativë për të ndryshuar legjislacionin që do të ishte në përputhje me gjendjen aktuale në tregun e turizmit
Përgatitja dhe shpërndarja e pyetësorëve të standardizuar

Masa 3.2.5

Krijimi i klimës për partneritet publiko - privat

Për realizimin e projekteve të rëndësishme në aspektin e turizmit është e nevojshme bashkëpunimi në mes aktorëve të ndryshëm nga rajoni. Gjegjësisht atraksionet më të rëndësishme turistike natyrore dhe kulturore janë të mira publike dhe i takojnë organizatave të ndryshme për kah pronësia. Nga ana tjetër është biznesi turistik që i përdor këto atraksione, dhe për këtë arsye ekzistojnë edhe modele të shumta për zbatimin e suksesshëm sipas objektivave dhe prioriteteve të caktuara në program. Një nga modelet më të rëndësishme tek ne paraqet partneriteti publiko-privat përmes të cilit do të harmonizohen interesat e sektorit publik dhe privat. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- Promovimi i përfitimeve nga partneriteti publiko-privat

- Informimi dhe trajnimi për kontraktimin për partneritet publiko-privat

Aktivitetet treguese
Krijimi i procedurave për partneritetet publiko-privat dhe koncesione si një mundësi për ofertë turistike
Organizimi i trajnimeve për të interesuarit për PPP
Nën kontraktimi i PPP
Krijimi i organeve të përbashkëta për menaxhim me atraksionet me modelin e PPP

Masa 3.2.6

Zhvillimi i një sistemi për menaxhimin e destinacioneve dhe atraksioneve kryesore turistike

Destinacionet turistike si entitete të ndara hapësinore të cilat ofrojnë produkte të specializuara turistike për segmente të tregut të përcaktuara duhet të gjitha burimet e mundshme t'i koordinojnë, t'i shpërndajnë dhe shfrytëzojnë në mënyrë të qëndrueshme. Ajo nënkupton zhvillimin e modeleve të menaxhimit të destinacioneve që do të ketë funksion për të planifikuar, të koordinuar, menaxhuar dhe kontrolluar të gjithë aktorët e ofertës turistike. Kjo mund të arrihet nëpërmjet:

- Përcaktimi i strukturës organizative të trupit që do të kryejë aktivitetet e menaxhimit në destinacion
- Promovimi i modeleve të menaxhimit të destinacionit dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Aktivitetet treguese
Vendosja e një sistemi për të kontrolluar cilësinë e ofruesve të shërbimeve turistike
Përzgjedhja e njësive hapësinore ku do të aplikojnë për menaxhimin e destinacionit
Zbatimi i strukturës organizative të menaxhimit të destinacionit
Vendosja e një sistemi të përgjegjësisë në menaxhimin e destinacionit
Mbledhja e përvojës së huaj për menaxhimin e destinacionit

Prioriteti 3.3

Krijimi i një ofertë turistike rajonale, në mënyrë për të thyer karakterin sezonal të turizmit dhe shfrytëzimin e balancuar të kapaciteteve gjatë gjithë vitit

Rezultatet dalëse	Treguesit
Numri i hartave interaktive **Numri i pjesëmarrësve në panaire** **Përgatitja e Strategjisë së marketingut** **Numri i etno restoranteve** **Numri i objekteve të përshtatura dhe restauruara për akomodim dhe hotelieri** **Numri i trajnimeve të organizuara për turizëm rural, malor, banjore dhe spaleologjik** **Numri i paketave sociale dhe të tjera për periudhën jashtë sezoni** **Projektet të punuara bashkërisht nga ana e strukturës organizative dhe biznes sektorit të turizmit** **Bashkëpunimi i realizuar në mes të rajonit me një rajon tjetër fqinj** **Programet e udhëtimit të përgatitura (produkte)** **Numri i aranzhmaneve turistike të shitura**	Vënia në funksion e Strategjisë së marketingut të rajoni Numri i certifikatave të lëshuara për restorantet nacionale Numri i objekteve funksionale të përshtatura dhe restauruara për akomodim dhe hotelieri Shuma e fondeve të shfrytëzuara për zhvillim rural Ueb-faqe funksionale në rajon Rritja e numrit të turistëve Shtimi i qëndrimit turistik Rritja e konsumit jo pansional

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin masat në vijim:

Masa 3.3.1

Azhurnimi i Hartave turistike

Si rajon më i zhvilluar në kuptimin turistik ai është i vizituar nga shumë turistë. Për të siguruar zhvillimin e barabartë dhe përfshirjen e objekteve dhe lokaliteteve më pak të vizituara duhet të azhurnohen hartat turistike. Me atë turistët do të jetë në gjendje për të zgjedhur vetë rrugët e lëvizjes së tyre dhe të kanë më shumë zgjedhje në ofertë. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- Azhurnimi i inventarizimit dhe vlerësimit të resurseve turistike dhe shënimi i tyre
- Lidhje tematike dhe programore të atraksioneve
- GIS lokalizimi i atraksioneve më të rëndësishme

Aktivitetet treguese
Modernizimi i hartave interaktive me paketa të reja programore
Futja e përmbajtjeve nga i gjithë rajoni në harta
Rivlerësimi turistik i vlerave turistike dhe plane për shfrytëzimin e tyre të qëndrueshëm

Masa 3.3.2

Brendimi i rajonit për turizëm

Edhe pse është rajoni më i zhvilluar turistik, rajoni Jugperëndimor ende nuk e ka qartë të përcaktuar ofertën turistike që do t'i kushtohej segmenteve të veçanta të konsumatorëve të turizmit. Me qëllim që të specializohet oferta duhet zhvilluar një brend të njohur për tërë rajonin. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Hulumtimi i potencialit dhe propozime për brend turistik për rajonin

• Promovimi i destinacionit për turizmin e caktuar,

• Lidhja me destinacione të ngjashme në mbarë botën

Aktivitetet treguese
Përgatitja e studimeve për bendim të rajonit
Organizimi i takimeve të vazhdueshme të ofruesve të ndryshëm të shërbimeve turistike
Promovimi i destinacionit në aspekt të theksimit të vlerave natyrore dhe kulturore botërore dhe mbrojtjen e UNESCO-s
Rrjetëzim në asociacionet ndërkombëtare tematike (Shoqata Evropiane e rrugëve kulturore, Shoqata evropiane të qyteteve me fortesa ...)
Pjesëmarrje në panaire të specializuara për format selektive të turizmit
Përgatitja e strategjisë së marketingut të rajonit
Përgatitja e materialeve promovuese dhe organizimi i ngjarjeve promovuese

Masa 3.3.3

Formimi i programeve/produkteve të përbashkëta të turizmit rural, malor, banjore dhe turizmit spaleologjik me turizmin kulturor dhe mbështetjen e agjencive turistike për të promovuar rajonin

Rajoni planor Jugperëndimor ka kapacitete për të zhvilluar disa forma selektive të turizmit. Rajoni si një destinacion i veçantë i cili synon për të zhvilluar brend të turizmit duhet të ofrojë programe të përbashkëta që do të përfshijë të gjitha komunat nga rajoni. Me këtë të ardhurat turistike do të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe do të rrisin ofertën e përgjithshme që është në dispozicion për turistin. Burimet më të përfaqësuara

turistike në Rajon janë atë kulturore. Për të mundësuar ofertë të larmishme dhe komplementare turistike duhet të kombinohen llojet alternative të turizmit (rural, malor, banjor dhe turizmit spaleologjik) me turizmin kulturor. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Organizimi i takimeve në mes agjencive turistike me ofruesit e tjerë të shërbimeve turistike në të gjithë rajonin

• Zbatimi i propozim ideve më të mira për programet turistike dhe promovim

• Përgatitja e aranzhmaneve turistike të cilat i përfshijnë llojet selektive të turizmit dhe atij kulturor

• Përzgjedhja dhe prioritizimi i burimeve kulturore në rajon për t'u përfshirë në llojet e tjera të turizmit

Aktivitetet treguese
Marrëveshje për bashkëpunim në ofrimin e shërbimeve turistike
Sigurimi i dukjes së potencialeve për turizmin në të gjithë rajonin
Rrjetëzimi i manifestimeve më të rëndësishme në rajon
Përpunimi i strukturës organizative për manifestimet
Zhvillimi i turizmit rural, turizmit shëndetësor, turizmit sportiv, turizmit spaleologjik
Trajnime për aplikime për turizëm rural, malor, banjor dhe spaleologjik
Krijimi i një politike subvencioni për të investuar në zonat rurale

Masa 3.3.4

Zhvillimi i ofertës gastronomike dhe promovimin e gastronomisë si pjesë e kulturës në rajon

Rajoni planor Jugperëndimor ka produkte gastronomike autentike dhe tradicionale që duhet të vendohen në funksion të ofertës turistike. Fillimisht që ajo të mund të realizohet duhet që banorët vendas t'i ushqejë këto tradita dhe t'i pranojnë përfitimet e përfshirjes së tyre në turizëm. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Zhvillimi i programeve edukative për popullsinë vendase për rëndësinë e ofertës gastronomike

• Shkëmbimi i përvojave për përgatitjen e pjatave tradicionale

• Organizimi i panaireve dhe manifestimeve për ushqim tradicional në rajon

Aktivitetet treguese
Zhvillimi i ofertës gastronomike (hapja e etno restoranteve me theks të traditave të Maqedonisë)
Krijimi i menyve të reja dhe rrjetëzimi i etno restoranteve në rajon
Certifikimi i restoranteve nacionale
Promovimi i vlerave gastronomike të rajonit
Marrja ushqim tradicional - suvenire në rajon
Punëtori të organizuara për përgatitjen e pjatave tradicionale
Lidhja e gastronomisë me prodhimin tradicional të ushqimit dhe produkteve ushqimore

Masa 3.3.5

Zhvillimi i produkteve nga turizmi kulturor në zonat rurale

Zonat rurale në rajon disponojnë me atraksione turistike të karakterit kulturor. Në mënyrë që të pasurohet oferta në këto zona është i nevojshme rigjallërimi i burimeve kulturore që ata mund të përfshihen në aktivitetet turistike të ofertës. Që të promovohen dhe më lehtë të përfshihen në ofertën turistike njëra nga mënyrat më të mira për të arritur këtë është krijimi i një sistemi të etno fshatrave. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

• Organizimi i programeve për trajnimin e banorëve lokal në zonat rurale për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe turizmit

• Mbështetje financiare për ruajtjen e vlerave tradicionale kulturore

• Krijimi i aranzhmaneve nga turizmi kulturor në zonat rurale

• Transferimi i njohurive dhe përdorimi i përvojave nga brenda dhe jashtë vendit

• Përzgjedhja e lokacioneve për zbatimin e këtij sistemi

Aktivitetet treguese
Banorë lokalë të trajnuar për t'u angazhuar në turizëm
Fuqi punëtore në dispozicion për aktivitete të tilla në rajon
Projekte të realizuara vendore dhe ndërkombëtare për rigjallërimin e vlerave tradicionale kulturore
Lidhja e marrëveshjeve me agjencitë turistike dhe aktorët e tjerë
Rigjallërimi i zonave rurale
Krijimi i sistemit të etno fshatrave

Masa 3.3.6

Rritja e konkurrencës së rajonit

Puna bashkëkohore në fushën e turizmit do të thotë shfaqje e konkurrencës së fortë në ofertën turistike. Rrethina e rajonit planor Jugperëndimor, por edhe e Republikës së Maqedonisë përfshin ofertë turistike cilësore me përmbajtje të njëjtë që paraqitet si konkurrencë. Për atë shkak ekziston nevoja për të përcaktuar me saktësi përmbajtjen e rajoneve konkurruese dhe vendeve si dhe të përmirësojë përmbajtjen e tyre në mënyrë që të përgjigjet në mënyrë adekuate ndaj tyre. Kjo masë do të zbatohet nëpërmjet:

• Krijimi i një biznes klime më të mirë në turizëm

• Eksplorimi i ndryshimeve të kërkesave të segmenteve të ndryshme të tregut

• Politika e çmimeve, standardizimi dhe përmirësimi i cilësisë së ofertës

Aktivitetet treguese
Analiza e rajoneve dhe vendeve konkurruese
Analiza e pjesëmarrjes së shpenzimeve turistike në rajon në konsumin total turistik në Maqedoni
Rritja konsumit jo pansional
Organizimi i fushatave për rregullimin e çmimeve sipas kriterit sezonal
Paketat sociale dhe të tjera për periudhën jashtë sezonale
Lidhja e strukturës organizative me biznes sektorin për turizëm
Përzgjedhja e vizitave tematike (5 deri në 6) të cilat më së miri do të prezantojnë rajonin

Masa 3.3.7

Promovimi i vlerave turistike të karakterit jashtë sezonal

Oferta turistike në rajonin planor Jugperëndimor karakterizohet me karakter sezonal. Kjo do të thotë një kohëzgjatje relativisht të shkurtër të sezonit turistik, si dhe politikë pamjaftueshëm të përshtatur të çmimeve të kësaj situate. Mund të thuhet se rajoni disponon me vlera të pasura turistike nga të cilat një numër i madh nuk janë shfrytëzuar për turizëm. Për atë shkak duhet të përforcohen aktivitetet promovuese për ato vlera që nuk varen nga natyra sezonale e turizmit dhe që mund të kontribuojnë në vazhdimin e sezonit. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- Përzgjedhja e vlerave turistike të karakterit jashtë sezonal
- Përzgjedhja e mjeteve më të mira promocionale dhe metodave të parapara për segmenteve të caktuara të tregut

Aktivitetet treguese
Promovimi i potencialeve dhe rrjetëzimi
Organizimi i ditëve promovuese të turizmit
Ueb faqja e rajonit (përgatitje dhe azhurnim)

Qëllimi afatmesëm 4

Mbrojtja e kualitetit të ambientit jetësor

Ruajtja e cilësisë së ambientit jetësor është në interes të të gjithë neve. Ambienti jetësor na prek të gjithëve, sepse ajo është e lidhur me të gjitha aspektet e jetës sonë. Një numër i madh i kushteve thelbësore të jetesës janë të lidhura me ambientin. Një nga tre shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të cilin e synon rajoni planor Jugperëndimor është ambienti jetësor, përkatësisht e mbrojtja e tij. Rajoni Jugperëndimor ka trashëgimi të pasur natyrore e cila duhet të ruhet për gjeneratat e ardhshme. Pjesa më e madhe e popullsisë tashmë zotëron një vendosmëri të fortë, njohuri të mjaftueshme dhe praktika të mira që mundësojnë ballafaqimin me numrin më të madh të kërcënimeve ndaj ambientit jetësor. Në këtë drejtim realizimi i këtij qëllimi afatmesëm do të kontribuojë në arritjen e vizionit të përcaktuar, përmes krijimit të ambientit jetësor më të shëndetshëm dhe më të pastër nëpërmjet zbatimit të parimeve të

zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmes zbatimit të gjithë politikave për mbrojtjen e ambientit jetësor. Rritja e vetëdijes për lidhje të pa ndashme mes rritjes ekonomike, kohezionit social dhe mbrojtjes së ambientit jetësor do të kontribuojë për të reduktuar presionet mbi ambientin jetësor.

Nr.Ren.	Treguesit	Treguesit Viti bazë	Treguesi 2019
1.	Përqindja e mbeturinave komunale të mbledhura	56,70%	80 %
2.	Përqindja e lëshimit të ujërave të pa pastruara në industri dhe xehetari	99,68%	70%
3.	Pyjet në hektarë	188.293	+10%
4.	Numri i krahinave të mbrojtura në rajonin planor Jugperëndimor	/	2 të emëruara të reja

Prioritetet për realizimin e këtij qëllimi afatmesëm janë:

Prioriteti 4.1

Ndërtimi, rekonstruimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale

Rezultatet e arritura	Treguesit
Numri i dokumentacionit teknik të përgatitur; **Numri i analizave dhe hulumtimeve;** **Numri i aktiviteteve të realizuara për të vendosur selektimin dhe riciklimin e mbeturinave;** **Numri i projekteve të realizuara për zvogëlimin e humbjeve teknike të ujit;** **Ndërmarrje publike rajonale e themeluar për menaxhim me mbeturinat;** **Plan rajonal i përgatitur për menaxhim me mbeturinat dhe studim fizibiliteti;** **Gjatësia e sistemeve të reja të ndërtuara për furnizim me ujë;** **Kapaciteti i përgjithshëm i stacioneve pastruese;** **Gjatësia e sistemeve të reja të ndërtuara për ujërat e zeza;**	**Fillimi i zbatimit të menaxhimit rajonal me mbeturina;** **Përqindja e mbeturinave të ricikluara;** **Përqindja e mbeturinave të grumbulluara;** **Sasia e mbeturinave organike që përfundojnë në deponi;** **Mbulimi i popullatës me sistem për mbledhjen e mbeturinave;** **Përqindja e humbjeve teknike të ujit në sistemet;** **Përqindja e popullsisë rurale e përfshirë me sistemin e furnizimit me ujë;** **Cilësia e ujit për pije;** **Përfshirja e popullatës me stacione pastruese;** **Përqendrimi i BOD5 në lumenjtë;**

Realizimi i këtij prioriteti i përfshin masat në vijim:

Masa 4.1.1

Rekonstruimi i sistemeve për furnizim me ujë dhe ndërtimi i sistemeve të reja të furnizimit me ujë

E drejtë themelore e njeriut është furnizimi me ujë të pastër për pije. Mbulimi i popullatës në vendbanimet rurale është ende i ulët. Në të njëjtën kohë sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë janë të vjetra dhe humbjet teknike të ujit në sisteme janë relativisht të larta 40-60%. Mungesa e ujit të pijshëm që paraqitet sidomos gjatë muajve të verës mund të reduktohet duke ulur humbjet teknike të ujit. Menaxhimi i sistemeve ekzistuese të furnizimit me ujë në vendbanimet rurale nuk është institucionalizuar. Zbatimi i masës do të kontribuojë në reduktimin e humbjeve teknike të ujit dhe sigurimin e ujit të pastër për pije në vendet ku nuk ka sisteme për furnizim me ujë. Kjo masë do të zbatohet nëpërmjet:

• Përmirësimi i sistemeve ekzistuese të furnizimit me ujë;

• Forcimi i kapaciteteve të NPK;

• Rritja e mbulimit të popullsisë rurale me sisteme për furnizim me ujë;

• Institucionalizimi me menaxhimin e sistemeve të ujit dhe ujërave të zeza në zonat e fshatit/rurale;

Aktivitetet treguese
Projekte për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm/ mbrojtjen e kaptazheve, mirëmbajtjen dhe instalimin e filtrave të ujit;
Organizimi i trajnimeve për NPK dhe furnizimi me pajisje;
Projekte për ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë;
Përfshirja e sistemeve të furnizimit me ujë nga zonat rurale nën NPK;
Projekte për të zvogëluar humbjet teknike të ujit;
Parandalimi i lidhjeve të paligjshme;
Ndërtimi i stacioneve filtruese;

Masa 4.1.2

Vendosja e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturinat e ngurta

Qëndrueshmëria e sistemit aktual të menaxhimit me mbeturinat e ngurta komunale është e diskutueshme, sidomos për periudhat afatgjate. Sot çdo komunë është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve brenda territorit të saj dhe shërbimi i mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave e ofrojnë Ndërmarrjet publike komunale lokale.

Nga procedurat ekzistuese të menaxhimit modern të mbeturinave sot në territorin e rajonit Jugperëndimor kemi vetëm grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave në deponitë lokale të cilat as pak nuk i plotësojnë standardet për deponim të sigurt të mbeturinave të ngurta komunale. Menaxhimi i integruar i mbetjeve rajonale, e cila përfshin të gjitha procedurat moderne të trajtimit të mbeturinave, është e vetmja mënyrë e menaxhimit të mbeturinave që është i qëndrueshëm dhe i cili në aspektin e mbrojtjes së mjedisit është më i pranueshëm. Me masën do të përmirësohet menaxhimi me mbeturinat në rajonin Jugperëndimor dhe do të fillojë procesi i vendosjes së menaxhimit rajonal me mbeturinat. Masa do të përfshijë elementet e mëposhtme:

- Përzgjedhja e materialeve të riciklueshme dhe riciklimi
- Përmirësimi i mbledhjes së mbeturinave
- Ndërmarrje rajonale komunale dhe përforcimi i kapaciteteve të saja
- Rritja e përfshirjes së shërbimit të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave

Aktivitetet treguese
Organizimin i fushatave publike dhe ngjarjeve promovuese;
Organizimi i trajnimeve dhe ngjarjeve edukative;
Blerja e pajisjeve;
Përgatitja e planit rajonal për menaxhim me mbeturinat inerte komunale;
Përgatitja e studimit të fizibilitetit;
Përgatitja e studimeve përcjellëse (analizat socio-ekonomike, të studiohet mundësia e pagesës, etj);
Përgatitja e dokumentacionit teknik për deponinë/të rajonale për mbeturinat inerte;
Projekte për të reduktuar prodhimin e mbeturinave;
Selektimi primar i mbeturinave;
Rikultivimi dhe rehabilitimi i deponive ekzistuese;
Zgjerimi i shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave në zonat rurale;

Masa 4.1.3

Sistemet e bartjes së ujërave të zeza komunale dhe stacionet e pastrimit

Rajoni Jugperëndimor në aspektin e mbulimit të popullsisë me stacione pastrimi për ujërat e zeza është shumë më lart se mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Megjithatë sistemi i kolektor për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit nuk është përfunduar ende, dhe sistemet ekzistuese të kanalizimit janë të vendosura kryesisht në zonat urbane dhe janë mjaft të vjetra. Mjediset rurale në një numër të vogël të vendbanimeve kanë sisteme të grumbullimit të ujërave të zeza komunale. Njëkohësisht sistemet për grumbullimin dhe bartjen e ujërave atmosferik nuk janë të ndërtuara apo janë ndërtuar në përqindje shumë të vogël në zonat më të mëdha urbane. Me masën do të përmirësohet bartja e ujërave të zeza dhe do të rritet mbulimi i popullsisë me sistemet e mbledhjes dhe bartjes së ujërave të zeza veçanërisht në zonat rurale.

- Rekonstruktimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit të vjetërsuara;
- Kanalizimi atmosferik;
- Sistemet e kanalizimit në vendbanimet rurale;
- Stacionet pastruese;

Aktivitetet treguese
Projekte për rehabilitimin dhe rindërtimin e sistemeve të kanalizimit;
Projektet për kanalizim atmosferik;
Blerja e pajisjeve;
Projekte për ndërtimin e sistemeve të kanalizimit;
Projekte për të rritur kapacitetin e Stacionit pastrues në Strugë;

Prioriteti 4.2

Përmirësimi i mbrojtjes së biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës

Rezultatet e arritura	Treguesit
Plani i përgatitur për menaxhim me	Përqendrimi i BOD5 në lumenjtë;

ujërat; Numri i trajnimeve,punëtorive të mbajtura; Numri i pikave të matjes për matjen e cilësisë së ujit; Numri i studimeve dhe analizave të përgatitura; Numri i dokumentacionit teknik të përgatitur; Numri i hidro centraleve të vogla të ndërtuara; Numri i fushatave publike të organizuara; Numri i materialit informativ të përgatitur dhe shpërndarë; Numri i aktiviteteve edukative në sistemin arsimor;	Pjesëmarrja e BRE në bilancin total të energjisë; Kapaciteti i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike; Centrale fotovoltaike të energjisë; Kapaciteti i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike; Numri i projekteve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë; Konsumi i energjisë sipas sektorëve; Numri i zonave të mbrojtura në rajon; Sipërfaqet e zonave të mbrojtura të shpallura; Numri i llojeve të ndryshme të kafshëve të gjuetisë; Numri i llojeve të peshkut; Zonat pyjore; Emetimet e gazrave të dëmshëm;

Realizimin e këtij prioriteti përfshin masat themelore në vijim:

Masa 4.2.1

Mbrojtja e biodiversitetit

Biodiversiteti si segment më dinamik i ambientit jetësor është i ekspozuar vazhdimisht ndaj ndikimit të aktiviteteve të përditshme të njeriut, si dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike. Çdo të 20-tën minutë zhduket një lloj i specieve bimore ose shtazore. Biodiversiteti i rajonit planor Jugperëndimor është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të pasurisë së tij dhe nivelit endemik. Pasuria e pyjeve që disponon rajoni duhet të ruhen për gjeneratat e ardhshme. Është e nevojshme të integrohen vlerat ekonomike dhe ekologjike të pyllit, vlera e saj si dru dhe si një vendbanim. Pjesa më e madhe e popullsisë nuk ka njohuri për rëndësinë e biodiversitetit dhe nevojës për të ruajtur të ardhmen e saj. Masa zbatohet me qëllim: zhvillimi i ndjenjës së pronësisë dhe përgjegjësisë ndaj biodiversitetit si një burim natyror, rritja e nivelit të ndërgjegjësimit politik dhe publik për llojshmërinë biologjike përmes organizimit të ngjarjeve të ndryshme në nivel rajonal, si dhe realizimit të projekteve konkrete për mbrojtjen e biodiversitetit.

- Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik
- Zbatimi i dokumenteve strategjike në nivel komunal nga ambienti jetësor
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i bimëve, pyjeve dhe rezervave të peshkut
- Koordinim për vendimet për koncesionim në mes të pushtetit qendror dhe lokal
- Zhvillimi i një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore

- Parqe të reja nacionale dhe zona të mbrojtura

Aktivitetet treguese
Organizim i punëtorive, aktiviteteve promovuese edukative;
Përgatitja e materialeve promovuese dhe edukative;
Organizimi i fushatave publike;
Iniciativa për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura;
Projekte për të mbrojtur biodiversitetin në zonat e mbrojtura;
Projektet për pyllëzim me lloje autoktone të pemëve;
Projektet për të rritur numrin e llojeve autoktone të kafshëve dhe peshkut;

Masa 4.2.2

Cilësia e ajrit

Mjedisi i shëndetshëm dhe i pastër është një kërkesë themelore për një jetë cilësore. Nga ndotja e ajrit jemi të gjithë të prekur. Ndërsa në jetë kemi zgjidhje për atë se çfarë uji do të pimë, me ajrin nuk kemi mundësi të tillë. Ne jemi dëshmitarë vitet e fundit se kemi ndotje të madhe të ajrit në disa qendra urbane, sidomos gjatë periudhës së dimrit. Sektorët Energjia, Industria dhe Transporti janë burimet më të rëndësishme të emisioneve të substancave ndotëse.

Emisionet e substancave ndotëse nga burimet e ndotjes si trafiku, industria, bujqësia transmetohen në distanca të mëdha dhe ndikojnë dukshëm në cilësinë e ajrit, dhe ashtu mbi vegjetacionin, kafshët dhe njerëzit. Prandaj është e nevojshme të kontrollohen emetimet e tyre dhe të zvogëlohen sasitë e shkarkuara në ajër. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut, emisionet e gazrave ndotës janë edhe shkaktari i drejtpërdrejtë i ndryshimeve klimaterike. Me këtë masë do të kontribuohet në reduktimin e ndotjes së ajrit. Kjo masë do të përfshijnë:

- Rritja e ndërgjegjësimit
- Prodhimi i energjisë ngrohëse - mënyra të reja të ngrohjes të amvisërive dhe të objekteve publike
- Subvencionimin e zëvendësimit të lëndëve djegëse ekzistuese me eko
- Efikasitet energjetik

- Shfrytëzimi i BRE
- Monitorimi i cilësisë së ajrit - zgjerimin e rrjetit të monitorimit

Aktivitetet treguese
Instalimi i stacioneve monitoruese për cilësinë e ajrit;
Projektet për të reduktuar emetimet e gazrave të dëmshëm;
Organizimin e fushatave publike, punëtori edukative dhe fushatave promovuese;
Përgatitja e një plani rajonal për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
Ngritja e plantacioneve të reja pyjore;
Përgatitja e studimeve për mundësitë – analiza dhe kërkime;
Përgatitja e dokumentacionit teknik për sisteme kogjenerative;
Përgatitja e projekteve për shfrytëzimin e BRE;
Projekte për shfrytëzimin e energjisë diellore;
Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla (deri në 1 MW)
Analiza e humbjeve të nxehtësisë në objektet publike;
Përgatitja e dokumentacionit teknik për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
Projekte për vendosjen e llambave kursyese në objektet publike;
Realizimi i projekteve për përmirësimin e efikasitetit energjetik në objektet publike;

Masa 4.2.3

Mbrojtja e ujit dhe tokës

Rajoni jugperëndimor është rajoni më i pasur me burime ujore në Republikën e Maqedonisë. Jetesa moderne në kushtet e urbanizimit të madh, industrializimit, zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit, kërkon konsumim më të madhe të ujit. Kjo ndikon në rritjen e presionit mbi burimet ujore dhe rritjen e ndotjes së burimeve. Ndotës më të shpeshtë të ujit janë mbeturinat komunale veçanërisht në aspektin e lokacioneve të deponive ekzistuese, mbeturinat industriale, mbeturinat bujqësore dhe veçanërisht ujërat e zeza komunale dhe industriale. Zhvillimi intensiv i qendrave urbane, prodhimit industrial dhe bujqësor dhe shkëmbimit tregtar, si dhe rritja e standardit të jetesës së njerëzve, e ndjek edhe prodhimtaria më e madhe e materieve të ngurta, të lëngëta dhe të gazta të cilat kryesisht derdhen të pa pastruara në rrjedhat ujore sipërfaqësore. Mbeturinat e lëngshme shkarkohen në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përveç ujërave sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore janë nënshtruar ndikimit negativ të veprimit të njeriut dhe ekziston rreziku i vërtetë i ndotjes së ujërave nëntokësore. Një

hapësirë rezervuari e ndotur nëntokë mbetet shumë gjatë, ose parë në aspektin e jetës njerëzore, e shkatërruar përgjithmonë. Edhe pse paraqitja e formave më të vështira të erozionit janë identifikuar në relativisht pjesë të vogla të rrjedhave të lumenjve, ato përsëri përfaqësojnë burime të mëdha të sedimenteve.

- Sistem monitorimi i ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor
- Menaxhim me ujërat në nivele të një pellgu
- Ujërat e zeza
- Toka

Aktivitetet treguese
Instalimi i stacioneve të monitorimit për të ndjekur cilësinë e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor; Organizimi i kampanjave publike dhe ngjarjeve promovuese; Plan për menaxhimin e shtretërve të lumenjve; Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e ujërave; Iniciativa për shpalljen e zonave të mbrojtura rreth burimeve ujore; Ndërtimi i depozitave dhe objekteve tjera për reduktimin e sedimenteve të lumenjve; Rekultivimi i tokave të ndotura; Pastrimi i lumenjve, lumenjve të thatë, kanaleve dhe degëve të lumenjve nga mbeturinat.

Financimi i zbatimit të Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

Realizimi i Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor kërkon burime të konsiderueshme financiare. Në ligjin për zhvillim të barabartë rajonal, si burime të financimit të zhvillimit rajonal janë të shënuara:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë,
- Buxhetet e njësive të vetë qeverisjes lokale,
- Fondet e disponueshme të BE-së,

- Burime të tjera ndërkombëtare,
- Donacione dhe sponsorizime nga personat fizik dhe juridik dhe
- Mjete tjera të përcaktuara me ligj.

Përveç burimeve lartë përmendura për financim të zhvillimit rajonal, Ligji i përcakton edhe instrumentet në vijim për nxitjen e zhvillimit rajonal: depozitat kapitale; grantet e pakthyeshme; financimi dhe bashkë-financimin i përgatitjes së analizave, studimeve, dokumentet planore dhe planet aksionare; financimi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale për zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë, si dhe ndihmë shtetërore në formën e kredive me kushte të favorshme, garancive të huave, sigurimeve të kreditit, lehtësimet tatimore, subvencione dhe instrumente të tjera.

Zbatimi i Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor do të realizohet duke shfrytëzuar mekanizmat ekonomik dhe financiare në dispozicion për të mbështetur zhvillimin rajonal. Projektet që do të realizohen në kuadër të masave dhe prioriteteve të parashikuara duhet të përcaktohen sipas efektit të planifikuar nga realizimi i projektit, përkatësisht të realizohen projekte që do të kenë ndikim pozitiv më të madh në krahasim me mjetet e investuara për realizim.

Vetëm shfrytëzimi i më shumë burimeve të financimit në zbatimin e Programit do të mundësojë një shkallë më të madhe të realizimit të masave të planifikuara dhe të arrihet ndikim më i madh. Megjithatë burimi kryesor i financimit do të jetë Buxheti i Republikës së Maqedonisë përmes mbështetjes së projekteve me komponentin e zhvillimit rajonal që janë planifikuar në programe të veçanta dhe nën-programe në ministri të ndryshme, të cilat zbatohen në pajtim me politikat e tyre për mbështetjen e zhvillimit. Në pajtim me Politikën fiskale të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2017, si dhe parashikimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vitin 2014 pritet rritje e PBB-së prej 4%, për vitin 2016 rritja pritet të jetë 4.2% dhe në vitin 2016 rritje prej 4.5%.

Ministria e vetëqeverisjes lokale dhe Byroja për zhvillim rajonal, në kuadër të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë çdo vit drejtpërdrejtë e mbështet zhvillimin rajonal përmes programit të zhvillimit rajonal, përkatësisht përmes sigurimit të mjeteve financiare për mbështetjen e projekteve që kanë komponentë të zhvillimit rajonal dhe janë të destinuara për arritjen e zhvillimit rajonal.

Shpërndarja e mjeteve nga buxhetet e ministrive lineare që janë projektuar për të mbështetur zhvillimin rajonal kryhet në përputhje me programet e atyre institucioneve.

Burime tjera të mundshme të financimit

Burime të tjera të mundshme të financimit për zbatimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor janë:

Programet e BE-së të tilla si IPA, Horizon 2020, Programet transnacionale për bashkëpunim dhe tjera.

Programet e donatorëve të tjerë të huaj dhe organizatat ndërkombëtare të tilla si GIZ, SDC, USAID, UNDP, Banka Botërore dhe të tjerë.

Republika e Maqedonisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim zhvillimor me shumë vende dhe organizata ndërkombëtare. Kornizat, buxhetet dhe prioritetet e secilit prej programeve janë negociuar në nivele bilaterale. Programet financohen nga buxhetet e vendeve donatore. Shuma e buxhetit dhe kohëzgjatjen e tij e përcakton çdo vend në veçanti.